



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji”  
ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut” në  
Tiranë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc.Dr. Artemisi Shehu/ Dono

2. Dr. Eris Dhamo/Greca

Dhjetor 2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Psikologji” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York” në Tiranë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Psikologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 209, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	11 PAE/ 5 PAK (viti akademik 2022-2023)
18	Numri i studentëve:	2020- 2021: 8 studentë 2021- 2022: 10 studentë 2022- 2023: 11 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i “New York-ut” në Tiranë (UNYT), institucion jopublik i arsimit të lartë ka filluar veprimtarinë e tij mbështetur në Vendimin Nr. 397, Datë 15.08.2002 të Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>. Ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “New York University-Tirana” është riorganizuar dhe ka ndryshuar statusin dhe emërtimin sipas VKM Nr.448, datë 11.07.2012<sup>2</sup> për ndryshimin e emrit të UNYT. Universiteti i “New York-ut” në Tiranë është akredituar për herë të parë nga Bordi i Akreditimit me vendim Nr. 102, datë 10.11.2017 “Për Akreditimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i New York-ut në Tiranë”<sup>3</sup>. Riakreditimi i dytë bazohet në Vendimin e BA-së, Nr. 61, datë 18.12.2020 “Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i New York-ut në Tiranë”<sup>4</sup>, me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite. Universiteti i “New York-ut” në Tiranë përbëhet nga 3 Fakultete: “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore”; “Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës”; “Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit” si dhe “Institutin e Studimeve Europiane dhe Ballkanike”. Njësia bazë që e ofron programin Bachelor në “Psikologji” është Departamenti i Psikologjisë që është pjesë e Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Programi është licensuar me Urdhër Nr. 274, datë 28.08.2020<sup>5</sup> të Ministrisë së Arsimit, Rinisë së Sportit. Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” realizohet me 180 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 3 vite akademike, në gjuhën angleze. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është punimi i temës së diplomës.

---

<sup>1</sup> Vendim për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike “New York University-Tirana”

<sup>2</sup> Vendim për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të emërtimit të institucionit privat të arsimit të lartë “New York University-Tirana”

<sup>3</sup> Vendimi për akreditimin periodik të Institucionit të arsimit të lartë Universiteti i New York-ut Tiranë.

<sup>4</sup> Vendimi për akreditimin periodik të Institucionit të arsimit të lartë Universiteti New York Tiranë.

<sup>5</sup> Urdhër Nr.274, datë 2020- 08-28. Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë, Universiteti i New York-ut në Tiranë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, aplikuar nga Universiteti Jo Publik i “New York-ut” në Tiranë. Grupi i vlerësimin të jashtëm i përbërë nga Dr. Eris Dhamo/Greca, Prof. Asoc. Dr. Artemisi Shehu/Dono, Msc. Aviola Bardhi (koordinator teknik i ASCAL) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin e “New York-ut” në Tiranë, MAS, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në ‘Psikologji’ mbi përmbushjen e standardeve. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale të studentëve.

Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit Bachelor në Psikologji; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit Bachelor në Psikologji; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit Bachelor në Psikologji. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta, të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”.

Më datë 07.11.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 118/64 Prot., datë 07.11.2023 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr 86/2 Prot., datë 13.11.2023, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 15.11.2023.

## **GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:**

Lidhur me komentin që bëhet për nevojat për rishikime kurrikulare të programit 3-vjeçar në funksion të rregullimeve kontemporane e nevojave imediate të tregut gjykojmë se fjalia duhet konsideruar brenda kontekstit, në të cilin është dhënë duke u bashkëshoqëruar në vijim edhe me të dhënat të tjera që e shtjellojnë këtë informacion në mënyrë përmbledhëse lidhur me nevojën reale për përditësim të kurrikulës dhe përshtatje të saj lidhur jo vetëm me unifikimin e afrimin e kurrikulës me kurrikulat e tjera simotra (për lehtësi kjo të mobilitetit të studentëve), por edhe të detyrimit për t'i dhënë studentëve njohuritë e nevojshme të përgjithshme për t'i përgatitur ata për vijimësinë e studimeve si dhe përgatitjen për tregun e punës. Gjykojmë se Departamenti ka të gjitha asetet për t'i mundësuar në të ardhmen të gjitha rregullimet e përditësimet e nevojshme të kësaj natyre, por kjo është një detyrë që sugjerohet të zhvillohet e përmbushet në të ardhmen prej tij. Duke vlerësuar përpjekjet e diskutimeve në departament për realizimin e këtij ndryshimi e përmirësimit i mbetemi gjykimit tonë të parë për këtë përmirësim.

Lidhur me komentin e vështirësive të rekrutimit të stafit akademik të profesionalizuar dhe profilizuar në këtë program studimit gjykojmë se edhe pse një vështirësi të tillë mund të ekzistojë, kjo mbetet një nga detyrimet e nevojshme dhe të domosdoshme për të çuar përpara Ciklin e studimit Bachelor në Psikologji si dhe një nga Standardet më themelore për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe produktit të psikologëve të ardhshëm në treg. Ndaj vijojmë të gjykojmë se kjo pikë duhet me dosmosdoshmëri të përmbushet në përputhje me nevojat për cilësi të hartuara nga Ligji i Arsimit të Lartë.

Lidhur me komentet e tjera gjykojmë se GVJ ka realizuar vlerësimin e tij për këtë Cikël Studimi Bachelor në Psikologji bazuar në dokumentet e pasura në dispozicion deri në momentin e hartimit të Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm ndaj nuk kemi komente të tjera lidhur me shkrësën e kthim përgjigjes mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm mbi programin e Studimit të Ciklit të parë Bachelor në Psikologji në UNYT.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i Arsimit të Lartë Jopublik, Universiteti i “New York-ut” në Tiranë zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me statutin dhe rregulloren e tij të brendshme, hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore si VKM Nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave, dhe Vendimi Nr. 185, datë 25.08.2021 i Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018. Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore dhe bazë, si dhe atë të programit të studimit që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës, në linjë me interesat kombëtare. <b>Shtojcat:</b> <b>Statuti i UNYT</b> <b>Rregullore e UNYT</b> <b>Ligji i arsimit të lartë të RSH</b> <b>Vkm nr 879</b> <b>Vendim nr 185 i KM</b> <b>Rregullore e Fakultetit</b> <b>Rregullore e Departamentit</b>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Program i studimit Bachelor në Psikologji, i ofruar nga UNYT, është në përputhje me vlerat akademike, qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” <sup>6</sup> , të cilat janë pasqyruar në një sër dokumentash të rëndësishëm që rregullojnë mbarvajtjen e punës akademike, por jo vetëm, si statutin, rregulloren e njësisë kryesore, bazë, rregulloren e programit të studimit. Ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe paisjen e

<sup>6</sup> Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” [https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DIIE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DIIE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt).

	<p>diplomë referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve<sup>7</sup> sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve të shtetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Duke u mbështetur në planin strategjik të zhvillimit institucional si dhe në kërkimin strategjik të tregut, ky program është përpjekur të hartohet në frymën e kuadrit të ri ligjor duke shfrytëzuar hapësirat lidhur diversifikimin e ofertave formative. Programi i studimit Bachelor në “Psikologji”, është në përputhje me qëllimin dhe misionin e UNYT, strategjitë e UNYT dhe është integruar në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij, Departamentit të Psikologjisë. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve, ky program do të përbëjë një sfidë për njësinë dhe stafin lidhur me prespektivën e zhvillimit të tij në të ardhmen dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në avancimin e kërkimit shkencor në drejtim të problemeve psiko-sociale me të cilat ndeshet psikologu sot.</p> <p><b>Shtojcat</b>  <b>Plani strategjik i UNYT</b>  <b>Kërkimi strategjik i Tregut UNYT</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti i New York ka një përvojë pune prej mëse 20 vitesh dhe ka eksperiencë mbështetëse pune edhe nga Universiteti i Empire University i New York. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimit është Departamenti i Psikologjisë. Programi i ciklit të parë ofrohet në përputhje me shkresat e MASH, statutit të Universitetit, si dhe dokumenteve të tjera që i përkasin këtij programi. Ky program realizohet me 180 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, të ndarë në 6 semsetra, në gjuhën angleze, në përfundim, të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “Psikologji”. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmblyëse ku si pjesë e të cilit është provimi final ose punimi i temës së diplomës. Duke iu referuar kapaciteteve njerëzore në dispozicion të zhvillimit të programit të studimit mund të themi se Departamenti ka burime njerëzore, të cilët mund të plotësojnë deri diku nevojat e përmbushjes së programit të studimit, por këto mund të ishin edhe më të plota për të qënë në përputhje me kurrikulën e programit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor me njësinë bazë, Departamentin e Psikologjisë, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” duke qënë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Ky program realizohet me 180 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 3 vite akademike, të ndarë në 6 semsetra, në gjuhën angleze, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “Psikologji”. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime</p>

<sup>7</sup> Ligj Nr. 23/2018 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” [http://qsha.gov.al/infos/njesim\\_diplome/ligj\\_23-2018\\_10052018.pdf](http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf) 3.

	<p>përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është provimi final ose punimi i temës së diplomës, konform bazës ligjore në fuqi.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë ka burime njerëzore, edhe pse këto të fundit duhet të ishin më të plota në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.</p> <p>Departamenti në total ka staf me kohë të plotë me tituj e grada, por duhet të ishte më i plotë si staf për të realizuar ngarkesat mësimore për programin.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ duke iu referuar këtij standardi gjykon se në përgjithësi përmbushen kriteret që e përbëjnë këtë standart duke iu referuar prezencës së një sërë mekanizmash dhe dokumentash që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni konform akteve ligjore në fuqi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti i New York për të siguruar mbarëvajtjen e strukturave të saj një sërë njësish dhe zyresh me natyrë akademike dhe ndihmësakademike bashkërendojnë punën me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së ecurisë në të gjitha hallkat e saj. Dokumentat që rregullojnë këtë bashkëpunim janë Statuti dhe Rregullorja e Universitetit, rregullorja e njësive kryesore dhe bazë si dhe rregullorja e programit të studimit, të cilat ndihmojnë njësitë në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Gjithashtu rregullorja e sekretarisë mësimore; njësia e burimeve njerëzore; njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njësia bazë përmes strukturave të saj si koordinatori i departamentit, grupit mësimorë, drejtuesi i departamentit, monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësimor për këtë program studimi. Një sërë dokumentash e përligjin bashkëpunimin brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësive e personelit.</p> <p><b>Shtojcat</b>  <b>Statuti i Universitetit</b>  <b>Rregullorja e Universitetit</b>  <b>Rregullorja e njësive bazë</b>  <b>Rregullorja e Programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë</p>	<p>Në linjë me direktivat ndërkombëtare e kombëtare për profesionet e rregulluar dhe ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar<sup>8</sup>. Kjo gjë ka imponuar rregulla të qarta edhe për IAL-et publike e private lidhur me përshtatjen e programeve të studimit në linjë me rregullat në fuqi.</p>

<sup>8</sup> Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë



<p>vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për nevojat e procesit mësimor një sërë nismash janë ndërmarrë nga ana e institucionit me qëllim që të garantohet një mbarvajtja e veprimtarive të njëjësive të Universitetit të New York. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Universiteti i New York dhe të konfirmuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, por edhe nga student, evidentohet prania e një sërë marrëveshjes institucionale të lidhura me institucione brenda dhe jashtë vendit në funksion të realizimit të objektivave formuese në funksion të procesit mësimor. Vlen të theksohet edhe shfrytëzimin i këtyre marrëveshjeve për qëllime të praktikave profesionale, aktivitete të tjera me natyrë ekstrakurrikulare, takime pune dhe mundësive për mobilitet të stafit dhe studentëve. Në bazë të këtyre evidencave gjykohet se kjo klimë ka impakt pozitiv dhe në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.</p> <p>Që nga viti 2018 UNYT është pjesë e rrjetit të insitucioneve të MAARIF dhe ka lidhje me mbi 67 shtete të ndryshme, si dhe mbi 340 lidhje insitucionale edukimi.</p> <p><b>Shtojca</b>  <b>Plani Strategjik</b>  <b>MoU Aksion Plus</b>  <b>MoU Praktika</b>  <b>MoU Bashkia Tiranë</b>  <b>MoU Shërbimi social Shtetëror</b>  <b>Lista e Marrëveshjeve</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji” institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi. Këto marrëveshje me disa institucione kyçe për profilin e psikologut si Bashkia Tiranë, Shërbimi Social Shtetëror, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në kontekste të ndryshme në fushën e psikologjisë si ‘Aksion Plus’ Tiranë, krijojnë mundësi për studentët që të njohin kontekstin specifik të punës, por edhe të njohin më mirë rolin e psikologut.</p> <p><b>Shtojcat</b>  <b>Lista e MoU</b>  <b>Vizitë studimore në qendër Autizmi</b>  <b>Aktivitet me UP</b>  <b>Ardita Demaj ekstrakurrikulare</b>  <b>Marrëveshje bashkëpunimi Universiteti i Granada</b>  <b>Staf akademik i ftuar Ela Tollkuci</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit në dispozicion evidentohet se njësia bazë përmes strukturave të saj monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të programit të studimit përmes disa formave monitoruese në funksion të programit të studimit si në fund të vitit akademik drejtuesi i Departamentit i paraqet Dekanin Raportin Vjetor të Monitorimit si dhe një pasqyrë analitike për marrëveshjet vjetore të bashkëpunimit gjatë vitit akademik, pra analiza vjetore e departamentit, Manual ii sigurimit të cilësisë. Departamenti ka vënë në dispozicion një dokument që na lejon të vlerësojmë këtë kriter, bazuar në analizën e raportit të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit, mobilitetin e stafit dhe të studentëve në nivel institucional, me fokus në</p>

	mobilitetet midis IAL-ve. Por në materialet e vëna në dispozicion nuk e evidentojmë qartësisht këtë pikë. <b>Shtojcat</b> <b>Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ gjykon se kjo fushë pavarësisht hapësirave për përmirësim të cilat janë shprehur përmes kritereve të sipërpërmendura nga ana e vlersuesve të jashtëm, ka indikatorët e nevojshëm për të konsideruar këtë standard të përmbushur plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Përsa i përket organizimit të programit në lëndë e module mund të themi se elementët përbërës të strukturës së programit Bachelor në “Psikologji”<sup>9</sup> përpiqen të jenë konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,<sup>10</sup> duke ofruar programe studimi të organizuara në module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me Sistemin European të Trasferimit të Krediteve (ECTS) dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<sup>11, 12</sup>. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” ofruar nga Universiteti “New York” realizohet me 180 kredite (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga ana e studentit është 60 ECTS. Programi ofrohet në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, të ndarë në 6 semestra akademik, në gjuhën angleze, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “Psikologji”, dhe paisjen e diplomë referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve<sup>13</sup>. Format i diplomës ende nuk është konkluduar duke qenë se ky është akreditimi i parë i tij. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmblyëse, ku si pjesë e të cilit është punimi i temës së diplomës, konform bazës ligjore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” përgjithësisht është hartuar konform Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,<sup>14</sup> dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të</p>

<sup>9</sup> Shtojcat.1.9 Rregullore e Departamentit

<sup>10</sup>Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

[https://archive.org/stream/LIGJ802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJ802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt)(Aksesuar më 7-2023).

<sup>11</sup>VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 04-07-2023).

<sup>12</sup> Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYkx8ZnNobnxcDo3NzYxM2UeZkZkMEEIYjdi> (Aksesuar më 07-2023).

<sup>13</sup> Ligj Nr. 23/2018 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010. “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” [http://qsha.gov.al/infos/njesim\\_diplome/ligj\\_23-2018\\_10052018.pdf](http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf) (Aksesuar më 07-2023).

<sup>14</sup>Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”[https://archive.org/stream/LIGJ802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE\\_djvu.txt](https://archive.org/stream/LIGJ802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt)(Aksesuar më 7-2023).



	<p>të licensimit dhe akreditimit të programeve në fushën e psikologjisë. Përfshirja e njësive në këtë nisëm gjykojmë se mund të ketë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit të strukturës dhe përmbajtjes së këtij programi studimi. Programi i studimit Bachelor në Psikologji përmes moduleve dhe lëndëve synon të formojë shprehje dhe kompetenca në drejtim të vlerësimit dhe ndërhyrjes në kontekstin klinik por pak hapsira në drejtim të zhvillimit shkollor dhe ligjor. Kjo në një llojshmëri të gjerë rolesh profesionale si psikolog klinik në drejtim të ofrimit të shërbimeve në një sërë kontekstesh më vonë si qendra të shëndetit apo edhe kontekste të tjera si komunitet apo institucione publike. Përgjithësisht programi i studimit prezantohet i plotë me të gjitha zërat e nevojshëm të kërkuar nga ligji por ka vend për përmirësime brenda mundësive që edhe vetë ligji parashikon.</p> <p><b>Shtojca 1.1-1.2</b>  <b>Plani mësimor i Bachelor në psikologji</b>  <b>Sylabusët e lëndëve</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke iu referuar planit mësimor vihet re se janë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021, përgjithësisht duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite sipas përqindjes së detyrueshme. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 17.7% (32 ECTS);</li> <li>- Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 51.1% (92 ECTS);</li> <li>- Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 13.3% (24 ECTS);</li> <li>- Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10% (18 ECTS);</li> <li>- Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse</li> <li>- 4.4% (8 ECTS);</li> </ul> <p><b>Shtojca 1.2 Plani mësimor Bachelor në Psikologji</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës mësimore të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, lënda mësimore “Praktikë” është pjesë e kategorisë D- tipi i Lëndë Plotësuese, me 6 ECTS, 135 orë në total, realizohet në vitin e dytë të studimeve, të shtrisë përgjatë semestrit të dytë të vitit akademik. Sipas të dhënave (takimet me stafin dhe studentët) u mësua se praktika realizohet në terren me institucionet përkatëse, me të cilat UNYT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në funksion të mbarëvajtjes së këtij procesi. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit mund të përmendim disa institucione kyçe për profilin e psikologut.</p> <p><i>Gjithësesi do të sugjerohej që lënda e praktikës të ishte e vendosur në vitin e tretë të studimeve si dhe të ishte më e gjatë në shtrirje kohore pra një vit akademik për të t’i dhënë studentëve një kohë më të gjatë e plotë të njihen me institucione të shumëllojshme se çfarë bën e cila është praktika e psikologut të përgjithshëm. Vendosija e lëndës së Praktikës në vitin e tretë</i></p>

	<p><i>do të bënte që studenti pasi të kishte marrë njohuritë e duhura teorike t'i shihte ato praktikisht në vitin e tretë dhe jo anasjelltas.</i></p> <p><b>Plani mësimor i Bachelor në Psikologji</b>  <b>Syllabus Praktikë</b>  <b>Marrëveshjet e bashkëpunimit</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studimet në programin e ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” të ofruar nga UNYT mbështeten në 3 dokumente kryesore që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Plani mësimor</li> <li>b) Syllabuset e lëndëve mësimore</li> <li>c) Rregullorja e programit të studimit</li> </ul> <p>Programi është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike, dhe studentët duhet të kenë grumbulluar 180 ECTS në përfundim të studimeve që të mund të fitojnë një diplomë Bachelor në “Psikologji”. Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlersuar në kredite (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara nga studenti me kohë të plotë përgjatë një viti akademik është 60 ECTS. Tërësia e veprimtarive formuese gjendet e shprehur në Planin Mësimor, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilën parashtrihen në mënyrë të sintetizuar: emërtimi i programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve, tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave, kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas aktiviteteve formuese të saj (leksione/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, karakteristikat e tezës së diplomës. Pranimi i kandidatëve në programin e studimi të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” bëhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi dhe në Statutin e Universitetit “New York” në Tiranë. Miratimi i kuotave të pranimit për çdo program studimi bëhet me vendim senati sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku kriteri i pranimit për aplikim është nota mesatare 7.5 e studimeve të arsimit të mesëm të lartë, përcaktuar me vendimin të Këshillit të Ministrave sipas vitit përkatës<sup>20</sup>. Studentët me rezultate të mira përfitojnë bursa studimi, ka edhe kuota të veçanta por deri tani nuk ka student me aftësi ndryshe të regjistruar në këtë program studimi. Gjithashtu studentët kanë të drejtë për arsye të ndryshme të ngrijnë studimet nëse kanë problematika justifikuese personale ose shëndetësore. Në rregulloren e programit janë të përcaktuara edhe detyrimet e studentit për të ndjekur programin e studimit Bachelor në Psikologji. Gjithashtu vërehen edhe disa lloje bursash që studenti mund të përfitojë.</p> <p><b>Rregullorja e programit të studimit</b>  <b>Plani mësimor</b>  <b>Shkëmbim stafi Erasmus dhe Mevlana</b>  <b>Politika e bursave</b></p>

<sup>20</sup> Shtojca 2.3. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve.




<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë është me të njëjtën emërtesë dhe ka në përmbajtjen e tij lëndë module që synojnë të japin njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca në linjë me profilin përkatës. Duke iu referuar këtij profili ka një përputhje midis komponentëve kryesorë që e përbëjnë atë si në strukturë, përmbajtje dhe emërtimin e programit të studimit duke qenë përgjithësisht konform edhe fushës së kompetencave profesionale të programit. Bazuar në ndarjen e lëndëve mësimore që e përbëjnë këtë program studimi të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë kemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 17.7 % (32 ECTS);</li> <li>- Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 51.1 % (92 ECTS);</li> <li>- Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 13.3 % (24 ECTS);</li> <li>- Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (18 ECTS);</li> <li>- Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse</li> <li>- 4.4 % (8 ECTS)</li> </ul> <p>Përgjithësisht lëndët e fushës së psikologjisë zënë mbi 70% të peshës në këtë program duke dominuar njohuritë dhe dijet për profilin përkatës. Vlen të theksohet gjithsesi se një kujdes më i shtuar duhet të tregohet në lidhje me disa lëndë që i përkasin profilit shkollor e atij organizacional.</p> <p><i>Sugjerohen që disa lëndë të shtohen në program si:</i>  <i>Etika profesionale, Motivacion, Emocion, Psikologji shkollore, Sjellje organizacionale, Menaxhim i stresit, Aftësia e kufizuar dhe lëndë që janë më sekondare të eliminoheshin për të përfutur më shumë student nga njohuritë e fushës së psikologjisë.</i></p> <p><i>Këto do të realizonin edhe përafrimin më të madh të kësaj kurrikule programi me programe të tjera simotra me qëllim edhe që studenti të mund të kishte një fleksibilitet në lëvizje.</i></p> <p><b>Shtojca 1.2 Program i studimit Bachelor në psikologji</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti "New York" në Tiranë ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në fuqi për sa i përket mënyrës së regjistrimit të kodit përkatës për kodifikimet e lëndëve përkatëse dhe janë të pasqyruara në programin mësimor. Bazuar në përcaktimin e komponentëve që përbëjnë planin mësimorë të programit të studimit kemi të pranishëm edhe kodin e secilës lënde mësimore.</p> <p><b>Kodifikimet</b>  <b>Shtojca 1.17</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” ofruar nga UNYT është një program i ciklit të parë 3 vjeçar, i cili ofrohet nga Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti i Psikologjisë. Nuk ka partneritet me të tjera universitete.</p> <p><b>Shtojca 1.10</b>  <b>Rregullore e programit</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, duke u bazur në evidencat e mësipërme për çështjet e trajtuara në secilin kriter dhe duke marrë në konsideratë angazhimin e institucionit në</i></p>

	<i>drejtim të përmirësimit të tyre gjykon se ky standart bazuar në secilin prej kritereve që e përbëjnë, të vlerësohet si i përmbushur kryesisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë në UNYT, ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë. Mësohet nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe anëtarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit”. IAL-i Privat, “Universiteti i New York-ut Tiranë” ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në Psikologji nëpërmjet shërbimit në AMS.</p> <p>Njësia kryesore “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore” dhe njësia bazë “Departamenti i Psikologjisë”, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Psikologji” përmbush detyrimet ligjore në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore përbëhet nga këto departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Departamenti i Psikologjisë</b></li> <li>• Departamenti Drejtësisë</li> <li>• Departamenti i Shkencave Politike/ Marrëdhënieve Ndërkombëtare</li> </ul> <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore dhe njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, përgjithësisht përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Duke iu referuar CV të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform titujve dhe gradave, dhe pjesërisht përsa i përket fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat që grupi i vlersimit të jashtëm ka shqyrtuar, rezultojnë se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, ka</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



	<p>aktualisht për vitin akademik 2022-2023, 24 PAE dhe 22 PAK dhe Departamenti i Psikologjisë ka 9 (nëntë) anëtarë të brendshëm PAE në total, nga të cilët, 1 (një) me titullin Profesor i Asociuar, 6 me gradën shkencore Doktor i Shkencave në Psikologji dhe 2 (dy) anëtar me Master Shkencor si dhe 7 PAK. Një anëtar i Departamentit është aktualisht dhe Dekan. Të gjithë pedagogët janë të licensuar nga UP.</p> <p><b>Shtojcat 1.1; 1.16; 2.11</b></p> <p><b>Statuti i UNYT</b></p> <p><b>Organigrama</b></p> <p><b>Riorganizimi i Njësive të 2 Fakulteteve</b></p> <p><b>CV e stafik akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia kryesore “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore” dhe njësia bazë “Departamenti i Psikologjisë”, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Psikologji” përmbush detyrimet ligjore në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore përbëhet nga këto departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Departamenti i Psikologjisë</b></li> <li>• Departamenti Drejtësisë</li> <li>• Departamenti i Shkencave Politike/ Marrëdhënieve Ndërkombëtare</li> </ul> <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore dhe njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, përgjithësisht përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Duke iu referuar CV të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform titujve dhe gradave, dhe pjesërisht përsa i përket fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat që grupi i vlersimit të jashtëm ka shqyrtuar, rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, ka aktualisht për vitin akademik 2022-2023, 9 (nëntë) anëtarë të brendshëm PAK në total, nga të cilët, 1 (një) me titullin Profesor i Asociuar, 6 me gradën shkencore Doktor i Shkencave në Psikologji dhe 2 (dy) anëtar me Master Shkencor Një anëtar i Departamentit është aktualisht dhe Dekan. Të gjithë pedagogët janë të licensuar nga UP.</p> <p>Departamenti merr staf të jashtëm sipas nevojave të tij duke rishikuar nevojat çdo vit akademik. Stafi PAE i angazhuar për vitin akademik 22-23 është 7 anëtarë nga të cilët 2 janë me gradën shkencore doctor dhe 5 me Master shkencor.</p> <p><i>Referuar tab nr.1, të RVB Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 46 pedagogë, nga të cilët 22 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 13 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 Asistent Lektorë me Msc dhe 22 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 10 kanë gradën Dr./PhD, dhe 10 Asistent Lektorë me Msc.</i></p>




GVJ konstaton se departamenti i **Psikologjisë** për vitin akademik 2022-2023, ka **16 personel akademik** gjithsej, **9 pedagogë** me kohë të plotë dhe **7 pedagogë** me kohë të pjesshme.

Njësia bazë, **Departamenti i Psikologjisë**, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	-	1	1	1	-
Dr./PhD.	6	2	5	-	5	1
Msc.	2	5	1	-	1	-
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>1</b>

Duke bërë një analizë të të dhënave të stafit akademik të përfshirë në departament dhe të përzgjedhur nga departamenti si stafi akademik me kohë të plotë dhe me kontratë për vitet akademike 2020-2023 mund të themi se përgjithësisht departamenti përmbush detyrimet e tij sipas ligjeve në fuqi për mbulimin e programit me stafin e brendshëm dhe një përqindje më të vogël të programit me staf me kontratë.

Ndër vite nga 2020-2022 numri i stafit efektiv vërehet të mos ketë ndryshime në numër e përmbajtje, në vitin e fundit 2023 vihet re një rritje e stafit efektiv me shtimin e një personeli me gradën shkencore Doktor në Psikologji si dhe një personeli me gradën po shkencore Doktor, por jo në Psikologji dhe një Master shkencor.

*Do të sugjerohej që një shtim i personelit akademik t'i korrespondonte profesionalisht përputhshëmisë së specifikave të Departamentit të psikologjisë dhe jo një fushe tjetër të specialitetit, aq më tepër kur nevojat e lëndëve të departamentit lidhur me këtë specialitet nuk i kalojnë maksimumi 2 lëndë (Biologji Humane dhe Truri e Sjellja). Përftimi i departamentit me një staf efektiv me specialitetin Psikologji do të ishte më i arsyeshëm dhe i domosdoshëm dhe i përputhur me ligjin në fuqi mbi kompetencat dhe aftësitë e specializuara të anëtarëve të një Departamenti. Gjithashtu në departament si personel të brendshëm janë pjesë edhe staf i cili nuk është i specializuar për Psikologji por për gjuhë të huaj Angleze dhe ka mbaruar Master shkencor për mësues në gjuhën Angleze. Një personel i tillë nuk mund të jetë pjesë e stafit akademik efektiv në Departament pasi ul cilësinë e stafit mësimdhënës dhe nuk ka fushën e kompetencës në Psikologji.*

*Stafi i tillë akademik efektiv nevojitet të zëvendësohet me staf kompetent për fushën e emërimit që ka Departamenti dhe programin e studimit që ai drejton.*


	<p><i>Gjithashtu vërehet se disa lëndë që janë të profesionit si psh Psikologji ligjore lektrohen nga staf efektiv i Departamentit të Drejtësisë po të fakultetit të UNYT. Stafit që e lekturon këtë lëndë mban fushën e kompetencës në Jurisprudencë dhe Avokaturë. Kjo do të limitonte pjesën e informacionit të nevojshëm dhe të domosdoshëm që një psikolog duhet të ketë lidhur me njohuritë për lëndën e Psikologjisë ligjore apo çfarë bën një psikolog në fushën ligjore. Thënë këtë sugjerohet të rishikohet mbulimi i kësaj ngakese të lëndës nga Departamenti për t'ia besuar një stafi kompetent të fushës së psikologjisë.</i></p> <p>Departamenti ka përfshirë në vitin akademik 2022-2023 personel akademik me kontratë për të përmbushur nevojat e tij.</p> <p>Po të analizojmë ngarkesën e stafit akademik ndër vite do të vihet referuar tabelës nr 4 ngarkesës totale të stafit akademik të programit Bachelor në Psikologji vihet re që ata janë të ngarkuar me lëndë përgjithësisht me ngarkesa maksimale, por thuhet të gjithë mbajnë mbingarkesë deri në 50-250 orë mbi normën.</p> <p>Përsa i përket lëvizshmërisë së stafit akademik të programit Bachelor në Psikologji në 3 vitet e fundit vihen re lëvizje të vogla, larguar së fundmi 1 staf efektiv me gradën shkencore Doktor, por janë marrë në vitin 2022, 2 (dy) staf efektiv me gradën shkencore Doktor, një në Psikologji dhe një në Biologji. Nga bisedat me përgjegjës të Departamentit dhe me Dekanin e Fakultetit mësohet se ka vështirësi në gjetjen e stafit dhe afrimin e tij pranë UNYT për arsye të ndryshme por kryesisht për shkak të mësimdhënies në gjuhën angleze e cila perceptohet si një vështirësi shtesë për t'u impenjuar pranë këtij Departamenti/Fakulteti.</p> <p>Kështu, lëvizshmëria e stafit apo vështirësia për të gjetur staf të ri kompetent në fushë mbetet një sfidë për Departamentin dhe vijimësinë e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><b>Rregullore e universitetit</b>  <b>Rregullore e fakultetit</b>  <b>Rregullore e Departamentit</b>  <b>CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Psikologji</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore është organizuar në 3 departamente dhe një Institut studimor. Njësia bazë që ofron programin Bachelor në "Psikologji" është Departamenti i Psikologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë" sipas propozimit të përgjegjës të Departamentit miraton në rolin e koordinorit për njësinë bazë Bch në Psikologji. Koordinator i programit është drejtuesi i Departamentit dhe ai merret edhe me mbarëvajtjen e mësimdhënies ashtu edhe me rolin e kërkimit shkencor të stafit akademik. Ai koordinon punën e departamentit lidhur edhe me përshtatjen e aktiviteteve kryesore me qëllim synimet strategjike të Universitetit. Ky përgjegjës koordinator edhe vlerëson punën në tërësi të ardhur nga çdo pedagog në departament si dhe monitoron dhe vlerëson cilësinë e çdo pune nga ajo mësimdhënëse tek ajo e kërkimit shkencor.</p>

	<p>Ndër vite lidhur refruar tabelës nr 4 mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik në programin e studimit, koordinatori i programit të studimit është edhe përgjegjësi i Departamentit ka këtë ngarkesë mësimore:</p> <p>-në vitin akademik 2020-2021 ka ngarkesën mësimore prej 300 orësh mësimore (180 orë në Bch në Psikologji/120 orë në Msc);</p> <p>-në vitin akademik 2021-2022 ka ngarkesë totale prej 380 orë mësimore (215 orë në Bch në Psikologji/165 në Msc);</p> <p>-në vitin akademik 2022-2023 ka ngarkesën totale prej 290 orë mësimore (210 orë në Bch Psikologji/80 orë në Msc).</p> <p><i>GVJ sugjeron që ky koordinator të jetë një person tjetër i zgjedhur nga departamenti për të monitoruar mbarëvajtjen e punës së këtij programi studimi Bachelor në Psikologji për arsye se ky program studimi është i shtrirë në 6 semestra dhe ka ngarkesë të konsiderueshme të të gjithë mbarëvajtjes së tij akademike dhe mësimore e kërkimore dhe një përgjegjës departamenti do të ishte e pamundur të merrej edhe me këtë përgjegjësi madhore përveç shumë ngarkesave të tjera të tij si përgjegjës departamenti dhe për programe të tjera studimi që departamenti ofron si Masteri shkencor. Ndaj do të sugjerohej që kjo përgjegjësi për të mos u cënuar aspak t'i delegohej një anëtar tjetër të departamentit për të siguruar cilësinë e saj dhe lehtësuar përgjegjësinë nga kjo detyrë.</i></p> <p><b>Rregullore e universitetit</b>  <b>Rregullore e departamentit</b>  <b>Rregullore e programit të studimit</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Bazuar në informacionet e paraqitura në këtë standard GVJ gjykon se përgjithësisht janë të përbushura kriteret konform kërkesave ligjore në fuqi dhe në linjë me direktivat e manualit të sigurimit të cilësisë por lidhur me stafin e brendshëm mund të rishikohet përputhshmëria për të specifikuar fushën e profilit e psikologut.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia kryesore, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore dhe njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit, si dhe ndërveprojnë së bashku për të përbushur më së miri detyrimet ligjore që lidhen me ecurinë e tij si në rastin e miratimit të grupit të cilësisë në nivel departamenti, dhe miratimit të grupit të vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi. Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjës të departamentit dhe zyrat përkatëse të Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë apo zyrave ndihmës akademike, mësohet se protokollet e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit

	<p>të këtij programi studimi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal. Vlerësohet nga takimet se përgjegjësi i Departamentit është përgjegjësi kryesor dhe i drejtpërdrejtë për programin e studimit Bachelor në psikologji. Është ai që duhet të nxisë komunikimet konsultimet, organizojë punën si dhe ndan detyrat në departament.</p> <p><b>Statuti i UNYT</b>  <b>Rregullore e Fakultetit</b>  <b>Rregullore e Departamentit</b>  <b>Rregullore e programit të studimit</b>  <b>Njoftim për anëtarët e departamentit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë, Bachelor në “Psikologji” përgjithësisht është konform rregullores së programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij kjo dhe konform udhëzimeve të MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë. Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlersuar në kredite (ECTS) duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmblyëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 17.7% (32 ECTS);</li> <li>- Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 51.1 % (92 ECTS);</li> <li>- Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinore/Integruese 13.3 % (24 ECTS);</li> <li>- Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (18 ECTS);</li> <li>- Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmblyëse 8 % (4.4 ECTS)</li> </ul> <p>Bazuar në planin mësimor të programit të studimit rezultojnë se kurrikula e programit të studimit është e organizuar në lëndë, module, praktika, laboratore, orë të studimit individual, projekte etj, të cilat janë të shtrira në 3 vite akademike dhe të ndara në 2 semestra për çdo vit akademik. Përqindjet sipas tipologjive të lëndëve mësimore të përlogaritura bazuar në Planin mësimor 2022-2023, të cilat krahasuar me përcaktimet në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021, përgjithësisht janë konform tyre, dhe përgjatë viteve akademike ka një angazhim të UNYT për ta përafuar me standardet e kërkuara duke ruajtur masën e 20 % të lejuar.</p> <p><b>Shtojca 1.2 Plani mësimor i programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Universiteti “UNYT” nëpërmjet dokumentacionit që shoqëron bazën materiale të këtij programi studimi sic janë Rregullorja e Programit, Manualin e rekrutimit, Rregulloren e Fakultetit, etj përshkruan procedurat e procesit të rekrutimit, aplikimit, regjistrimit, transferimit dhe për aplikantët për një program të dytë studimi. Të gjitha procedurat që lidhen me këtë proces realizohen përmes Zyrës së Pranimit dhe Regjistrimit.</p> <p>Në rregulloren mësimore të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Psikologji” ka të specifikuar kriteret që duhet të plotësohen për t’u</p>

	<p>pranuar në programin e studimit. Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësive të saj monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit në këtë program studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e rregjistrimeve dhe transferimeve në UNYT.</p> <p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të aksesueshme lehtësisht edhe në faqen e tij zyrtare.</p> <p><b>Shtojca 1.4; 1.5; 1.15; 1.15.1; 1.15.2;1.15.3</b>  <b>Formë ekuivalence</b>  <b>Propozim transferimi</b>  <b>Rregullore e Fakultetit</b>  <b>Rregullore e programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p><i>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS. Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit të dëshmohet se komponentët mësimorë (lëndët /modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite, sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në tre vite dhe dy semestra për çdo vit akademik. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, si dhe dokumente të tjera.</i></p> <p><i>Nga kjo pikëpamje, programi studimit i marrë në vlerësim rezultoi në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021.</i></p> <p><b>Shtojca 1.10; 3.2</b>  <b>Rregullore e programit</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të përmirësimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Psikologji" duket se është objekt monitorimi nga njësia bazë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit të njësive bazë dhe nxitur nga</p>




	<p>anagazhimi me Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë drejtuar IAL-ve publike e private si një nevojë për unifikimin e programeve me standartet e EuroPsy, gjykohe me ndikim pozitiv këto nisma dhe konsiderohen si hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të programit të studimit që do të synojnë të lehtësojë mobilitetin e studentëve për nevoja studimi dhe punësimi në BE. Kjo kurrikul është një riorganizim i programit të mëhershëm të ofruar nga ky institucion dhe pas akreditimit të fundit është konkluduar në një riorganizim të tillë kurrikule. Vihen re përmirësime të dukshme të kësaj kurrikule krahasuar me të mëparshmen dhe ka disa përmirësime në nivel të sylabuseve të lëndëve ku çdo vit akademik ato përmirësohen dhe përditësohen me bibliografinë e nevojshme etj. Ky është akreditimi i parë i këtij riorganizimi.</p> <p><b>Shtojca 2.21</b> <b>Sylabuset e lëndëve të planprogramit</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar më vlerësimin e kriterëve lidhur me detajet, informacionin, strukturën dhe organizimin e objektivave formuese të programit Bachelor në "Psikologji", gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021.</p> <p>Programi mund të krijoj kushte të favorshme në drejtim të përfitimit të njohurive, aftësive, licensimit dhe punësimit në psikologji, pasi përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë të arrihet një profilizim që të jep mundësi të punosh brenda fushës së psikologjisë.</p> <p><i>Përgjithësisht vlerësohet se plan programi mësimor i programit Bachelor në Psikologji të jetë më i mirë dhe cilësor se ai i mëparshmi përpara riorganizimit dhe mund t'i ofrojë studentëve njohuri më të përgjithshme për t'i lejuar më pas studentët të zgjidhin mbi fushën e profilizimit të tyre. Edhe pse do të sugjerohej që disa lëndë të shtoheshin, disa të tjera të ishin të panevojshme për studentët si dhe të rishikoheshin disa vendndodhje lëndësh si më poshtë propozojmë:</i></p> <p><i>propozohen që disa lëndë të shtohen në planin mësimor për t'i dhënë njohuri të duhura studentëve për profilizimin e mëvonshëm në fushën e masterave si: lëndët Motivacion, Sjellje organizacionale, Menaxhim i stresit, Etikë profesionale, Emocion ose Inteligjencë emocionale, Aftësi e</i></p>

	<p><i>kufizuar, Psikologji shkollore. Sugjerohet që hapësira ekziston për faktin se disa njohuri aktuale në planprogramin aktual që studentët marrin në lëndët si Aplikime kompjuterike, Algjebër, Të ushqyerit njerëzor nuk vlerësohen të nevojshme përpara lëndëve të sugjeruar që janë munguese në planprogram. Një psikologu të ardhshëm do i nevojiten më tepër njohuri nga këto lëndë se nga lëndët e sipërcituara.</i></p> <p><i>Gjithashtu propozohet që disa lëndë mund të rishikohen lidhur me pozicionet e tyre në planprogramin aktual dhe të ndryshojnë si më poshtë :</i></p> <p><i>Lënda Hyrje në të mësuar dhe kognicion e parashikuar në vitin e parë sugjerohet të kalojë në vitin e dytë akademik. Është mjaft herët që studenti të jetë i gatshëm për të kuptuar njohuritë e kësaj lënde pa përfunduar lëndën e Psikologji e përgjithshme.</i></p> <p><i>Lënda Psikologji anormale sugjerohet të kalojë në vitin e tretë për të njëjtën arsye të sipërpërmendur, dhe nuk mund të jetë e dhënë paralelisht me lëndën e Zhvillimit human.</i></p> <p><i>Lënda Historia dhe Sistemet e psikologjisë sugjerohen të kalohen në vitin e parë akademik pasi është lëndë bazë dhe e përgjithshme.</i></p> <p><i>Lënda Psikologji ligjore sugjerohet si lëndë në vitin e dytë akademik pasi në vitin e tretë studentët kanë nevojë për njohuri më të thelluara në psikologji.</i></p> <p><i>Lënda metodat e kërkimit në Shkencat sociale të zhvillohej më herët në vitin e dytë për arsye se studentët duhet të jenë më herët të informuar për kërkimin shkencor në psikologji.</i></p> <p><i>Gjithashtu sugjerohet nga GVJ që përmbajtja e disa sylabuseve të rishikohet me qëllim që të mos kemi njohuri të mbivendosura të marra në dy lëndë të veçanta nga studentët: psh nga shqyrtimi i sylabuseve lëndët Psikologji klinike dhe lënda Teoritë e Këshillimit kanë përmbajtje të përbashkët dhe nevojitet të rishikohen për përplasje; si dhe lënda Psikologji klinike të riemërtohet Psikologji klinike dhe Psikoterapi përderisa përmban më shumë mënyrën e trajtimeve klinike në Psikologjinë klinike dhe trajtimin e rasteve klinike.</i></p> <p><i>Sugjerohet që edhe lënda Praktike të ishte e shtrirë përgjatë gjithë vitit akademik, mundësisht të tretë.</i></p> <p><b>Plani mësimor Bachelor në Psikologji</b></p> <p><b>Sylabuset lëndore</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Ky program përgjithësisht reflekton një koherencë me parashkimet e akteve ligjore referuar planit mësimor përsa i përket numrit të krediteve 180 ECTS, me 60 kredite për cdo vit akademik, duke respektuar ndarjen e ECTS me nga 30 ECTS në semestër, me kohëzgjatje normale në 3 vite akademike, tipologjia e lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregullores së UNYT. Shpërndarja e lëndëve në përgjithësi i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë, praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit në përgjithësi të japin mundësi për qartësi brenda fushës dhe thellim të</p>






njohurive dhe kompetencave praktike. Thkesohet nga GVJ që insitucioni dhe Departamenti kanë bërë përpjekje deri diku për të respektuar shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/ integruese, lëndë plotësuese.

Por për të siguruar një balancë të normalizuar, progressive dhe profesionale sugjerohen disa rekomandime:

*Gjithashtu propozohet që disa lëndë mund të rishikohen lidhur me pozicionet e tyre në planprogramin aktual dhe të ndryshojnë si më poshtë :*

*Lënda Hyrje në të mësuar dhe kognicion e parashikuar në vitin e parë sugjerohet të kalojë në vitin e dytë akademik. Është mjaft herët që studenti të jetë i gatshëm për të kuptuar njohuritë e kësaj lënde pa përfunduar lëndën e Psikologji e përgjithshme.*

*Lënda Psikologji anormale sugjerohet të kalojë në vitin e tretë për të njëjtën arsye të sipërpërmendur, dhe nuk mund të jetë e dhënë paralelisht me lëndën e Zhvillimit human.*

*Lënda Historia dhe Sistemet e psikologjisë sugjerohen të kalohen në vitin e parë akademik pasi është lëndë bazë dhe e përgjithshme.*

*Lënda Psikologji ligjore sugjerohet si lëndë në vitin e dytë akademik pasi në vitin e tretë studentët kanë nevojë për njohuri më të thelluara në psikologji.*

*Lënda metodat e kërkimit në Shkencat sociale të zhvillohej më herët në vitin e dytë për arsye se studentët duhet të jenë më herët të informuar për kërkimin shkencor në psikologji.*

*Gjithashtu sugjerohet nga GVJ që përmbajtja e disa sylabuseve të rishikohet me qëllim që të mos kemi njohuri të mbivendosura të marra në dy lëndë të veçanta nga studentët: psh nga shqyrtimi i sylabuseve lëndët Psikologji klinike dhe lënda Teoritë e Këshillimit kanë përmbajtje të përbashkët dhe nevojitet të rishikohen për përplasje; si dhe lënda Psikologji klinike të riemërtohet Psikologji klinike dhe Psikoterapi përderisa përmban më shumë mënyrën e trajtimeve klinike në Psikologjinë klinike dhe trajtimin e rasteve klinike.*

*Sugjerohet që edhe lënda Praktikë të ishte e shtrirë përgjatë gjithë vitit akademik, mundësisht të tretë.*

*Sugjerohet të shtohen disa kredite të lëndëve karakterizuese si Motivacion, Sjellje organizacionale, Menaxhim i stresit, Etikë profesionale, Emocione ose Inteligjencë emocionale, Aftësi e kufizuar, Psikologji shkollore.*

*Sugjerimet tona janë referuar edhe EuroPsy si module me qëllim që të krijojnë hapsirën e nevojshme për të zhvilluar njohuri të përgjithshme për fushën e psikologjisë.*

*Bazuar në evidencat e mësipërme gjykojmë se vijimi i punës në lidhje me përshtatjen e kurrikulës së programit me standartet ligjore dhe të cilësisë por edhe me ato ndërkombëtare (EuroPsy) kërkon një angazhim cilësor institucional.*

	<p><i>GVJ sugjeron hapa konkrete në drejtim të përmirësimit të kurrikulës së programit të studimit në linjë me standardet e cilësisë.</i></p> <p><b>Plani mësimor Bachelor në Psikologji</b>  <b>Syllabuset e lëndëve</b>  <b>CV e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Duke iu referuar këtij kriteri struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori- praktikë është deri diku në përputhje me profilin e programit Bachelor në “Psikologji”.</p> <p>Gjithashtu programi përfshin njohuri dhe shprehje profesionale që e ndihmojnë studentin në drejtim të zhvillimit të njohurive të përgjithshme në fushën e psikologjisë. Një element pozitiv në drejtim të përmbushjes së këtij kriteri është edhe ftesa që IAL-et publike e private në vend kanë marrë nga ana e Urdhrit të Psikologut lidhur me unifikimin e programeve të studimit në fushën e psikologjisë me standartet e EuroPsy.</p> <p><i>Sugjerimet e GVJ për vijimësinë lidhen me lëndën Praktikë që të shtrihet përgjatë një vitit akademik dhe të pozicionohet në vitin e tretë akademik të studimeve.</i></p> <p>Sugjerohet të shtohen disa kredite të lëndëve karakterizuese si <i>Motivacion, Sjellje organizacionale, Menaxhim i stresit, Etikë profesionale, Emocione ose Inteligjencë emocionale, Aftësi e kufizuar, Psikologji shkollore.</i></p> <p><i>Si dhe sugjerimet e sipërpërmendura lidhur me lëndë që mund të zëvendësohen në kurrikul si Aplikime kompjuterike, Algjebër, Të ushqyerit njerëzor nuk vlerësohen aq të nevojshme përpara lëndëve të sugjeruara më sipër dhe që janë munguese në planprogram. Një psikologu të ardhshëm do i nevojiten më tepër njohuri nga këto lëndë.</i></p> <p><b>Plani mësimor</b>  <b>Syllabuset lëndore</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në disa elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gjykojmë se programi i pasqyron ato si pjesë të tij. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimor, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlerësimin e dijeve dhe një sërë akvitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët. Ky program studimi ka një përpjekje në lidhje me elementët që synon të zhvillojë te studentët në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e psikologut. Bazuar në ngjashmëritë në emërtim në planin mësimor ky program lehtëson deri diku mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Departamenti ka organizuar gjithashtu mjaft aktivitete me synim rritjen e njohurive të studentëve lidhur me aplikimin e profesionit të psikologut.</p> <p><b>Plani mesimor i programit</b>  <b>Aktivitete me studentët</b>  <b>Staf akademik i ftuar</b>  <b>Guest Speaker</b>  <b>Ftesë nga EPPC</b></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar mund të parashtrijmë se programi i studimit Bachelor në “Psikologji” duhet të jetë gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe monitorimit me kujdes e miratimit të tyre nga njësi bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e Urdhrit të Psikologut lidhur me unifikimin e programeve të studimit në fushën e psikologjisë me standartet e EuroPsy, të cilat do të rrisin cilësinë dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë. Literatura e përdorur përgjithësisht është e 10 viteve të fundit me tekste në gjuhë të huaj. Duke iu referuar këtyre evidencave gjykojmë se syllabuset përgjithësisht përditësohen çdo fillim vitit akademik dhe i nënshtrohen monitorimit dhe miratimit të përgjegjësit të njësisë bazë.</p> <p><b>Shtojca 2.2.1</b> <b>Evidenca emailësh</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p><i>Bazuar në rregulloren e programit të studimit përcaktohet si qëllimi kryesor ofrimin i njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu programi synon të pajisë studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm. Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve duhet t’u japin mundësi studentëve për fitimin e shprehive shkencore dhe profesionale. Një sërë aktiviteteish të formimit teorik dhe praktik duhet të fokusohen në hapësirat e nevojshme për të përthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë psikologut të zhvillojë disa kompetenca profesionale të lidhura me procesin e vlerësimit të problemit dhe të ndërhyrjes psikologjike, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimor të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri kërkim angazhim të vazhdueshëm. Duke iu referuar disa çështjeve që kanë të bëjnë me lëndë të caktuar që mund të mos jenë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e këtij programi studimi si <i>Aplikime kompjuterike, Algjebër, Të ushqyerit njerëzor</i> apo me mungesën e disa lëndëve të rëndësishme të profesionit si “Psikologji shkollorë”, “Motivacion” dhe “Emocion”, lënda “Etikë profesionale” vlerësohet të jetë e domosdoshme për studentët, etj mundet që këto aspekte të rrezikojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale të përgjithshme të plota.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë që përmbajtja e programit të studimit të krijojë kushtet për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të nevojshme në linjë me profilin e psikologjisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe kritereve për licensimin e psikologëve sipas Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Nëse i referohemi planit mësimor kemi një ndarje midis veprimtarive formuese, të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij. Këto</p>




	<p>veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale gjithashtu mbështet deri diku nevojat e programit për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme përmes njohjes së terrenit të punës, <i>por kohëzgjatja e saj nevojitet të rishihet, për të siguruar studentë cilësore</i>. Referuar marrëveshjeve institucionale për praktikën profesionale, studentët duket të kenë mundësi për të përzgjedhur institucionet e praktikës në linjë me interesat e tyre kërkimore dhe profesional, që t'u shërbejnë nevojave të tyre për t'u qartësuar lidhur me profilet e ndryshme të psikologjisë në të ardhmen.</p> <p>Duke iu referuar përmbajtjes së programit, ai mundëson vijimin e studimeve në ciklin e dytë të studimeve por punësimi i tyre në këtë profil profesional duke qenë profesion i rregulluar kërkon më tepër kohë. Duke u bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar<sup>21</sup>. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Autoriteti kompetent është Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, si autoritet, i ngarkuar me akt ligjor apo nënligjor, si përgjegjës e rregullator për një apo më shumë profesione të rregulluara, institucion që monitoron dhe arbitron të drejtën e ushtrimit të profesionit të psikologut. Për të gjithë të diplomuarit në Bachelor Psikologji kërkohet edhe përfundimi i ciklit të dytë të studimeve me qëllim vijimin e procedurave për licesim dhe më pas punësimin e tyre. Pas përfundimit të dy cikleve të studimit, studentët dt kryejnë praktikën profesionale<sup>22</sup> nën supervizimin e një psikologu të licensuar dhe pas përmbylljes me sukses të saj të futet në provimin e shtetit, vetëm pas marrjes së provimit të shtetit kandidatët psikolog mund të përfitojnë licensën për ushtrimin e profesionit të psikologut në Republikën e Shqipërisë.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ gjykon se disa aspekteve u duhet dhënë një hapësirë më e madhe që lëndë të profilit dhe specialitetit të tilla si Psikologji shkollorë” dhe “Motivacion”; “Emocion/Inteligjencë emocionale” dhe “Etikë profesionale” dhe “Psikologji/sjellje Organizative” të parashikohen në kurrikul. Por edhe lëndë të formimit bazë që nuk lidhen me profilin e psikologjisë të zëvendësohen me lëndë të tjera bazë që përmbajtja e</i></p>

<sup>21</sup> Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

<sup>22</sup> Urdhër Nr. 418/2, datë 22.01.2018 MASR dhe Nr 574/1 datë 30.01.2018 MSHMS, i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. “Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në Republikën e Shqipërisë”

	<i>programit të studimit të krijojnë kushtet për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të nevojshme në linjë me profilin e psikologjisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor në “Psikologji” është Departamenti i Psikologjisë i cili konsultohet dhe mbështetet në përmirësimin e këtij program studimi dhe në përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës në strukturën e ngritur nga kjo njësi Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe NjSBC. Kjo praktikë konsiderohet me ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij program studimi, edhe pse nuk kuptohet sesi dhe në çfarë kushtesh do të shfrytëzohet nga njësia bazë. Duke u bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar si studimi i tregut të punës, mbetet disi i paqartë sesi do të përdoren këto elementë në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Nuk kemi evidenca të tjera në këtë drejtim për të gjykuar më gjatë mbi këtë kriter. Gjithsesi përmbajtja e këtij program studimi vjen për shkak të detyrimit të akreditimit të parë për t’ju përshtatur tregut të punës dhe ndryshimeve akademike të ligjit për t’u përshtatur me sistemin 3+2, Bachelor dhe Master më vonë. Edhe pse vlerësohet të jenë bërë përpjekje për të përmirësuar plan programin Bachelor në psikologji. Vlerësohet që përpjekjet janë duke u zhvilluar por pritet në të ardhmen të aplikohen në drejtim të përmirësimeve të vijueshme të kurrikulës përmes ngritjes së Trupit të Fakultetit Profesional çka është në process.</p> <p><b>Shtojca</b>  <b>2.9.2; Open session preparing students for carrier, Workshop on ethics</b>  <b>2.34; Evidencë mbi bordin e ekspertëve</b>  <b>5.12; Evidencë për laboratorin në UNYT</b>  <b>5.19; Punësimi i studentëve UNYT</b>  <b>5.20; Të dhëna mbi punësimin e studentëve Bch në Psikologji</b>  <b>5.29 Prezantime internshipi dhe mundësi punësimi për studentët</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë</p>	<p>Njësia bazë monitoron në vijimësi përshtypjet e studentëve të këtij programi studimi përmes rolit të koordinatorit të këtij programi studimi, përmes pyetësorëve për studentët dhe strukturave monitoruese, në të cilat studentët janë pjesë e tyre etj. Në takimet me drejtuesen e njëzisë bazë, GVJ u informua se njëzia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të procesit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat UNYT ka një marrëveshje</p>

<p>të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>përmes koordinatorit dhe drejtuesit të njësisë. Në funksion të përmirësimit të programit të studimit, Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe të Cilësisë (NJZHKC) në bashkëpunim me njësinë bazë realizon monitorim përmes pyetësorëve me student në lidhje me lëndën dhe pedagogët si dhe nga vlerësuesit e brendshëm dhe të jashtëm. Përmes Zyrës Alumni e Karrierës dhe Zyrës së pranimit të studentëve, institucioni ka marr një pozicion aktiv në drejtim të vijimit të zhvillimit të kompetencave të studentëve dhe ish-studentëve të tij, shfrytësimin e këtyre burimeve njerëzore për nevojat e veta institucionale. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Të gjitha këto struktura dhe nisma konsiderohen me ndikim pozitiv për mbështetjen e Alumnit. Gjithsesi nuk kemi evidenca që na lejojnë të vlerësojmë sesa merren në konsideratë sugjerimet e alumni në drejtim të përmirësimit të këtij program studimi pasi ky është edhe në proces riorganizimi.</p> <p><b>Shtojca 5.6 Alumni reunion</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur edhe më sipër në raport njësia bazë ka marrë angazhim për të përmirësuar në vijimësi këtë program studimi, kjo në linjë edhe me kërkesat e tregut të punës dhe të ndërkombëtarizimit të programeve për ti unifikuar me ato të vendeve të BE-së. Kjo si përgjigje e kërkesës së ardhur nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë drejtuar IAL-ve publike e private si një nevojë për unifikimin e programeve me standartet e EuroPsy, që mendojmë do të lehtësojë mobilitetin e studentëve për nevoja studimi dhe punësimi në BE dhe do të rrisë cilësinë në këtë program studimi. Gjithsesi duhet të evidentojmë se kërkohet një punë dhe angazhim i të gjitha palëve të përfshira në proces që të mund të realizohet konform pritshmërive dhe realisht të ndërmerren hapa në drejtim të unifikimit të programeve të studimit duke ndjekur standartet ndërkombëtare të licensimit dhe akreditimit të në fushën e psikologjisë.</p> <p><b>Shtojca 2.4; 2.7.1; 2.12; 3.7; 4.22; 5.1</b>  <b>Aktivitetet me studenët Health psychology course</b>  <b>Guest speaker të ndryshëm</b>  <b>Staf akademik i ftuar për Psikologjinë anormale</b>  <b>Lista e MoU</b>  <b>Lista e akademikëve të regjistruar si praktikantë dhe supervizorë</b>  <b>Psychology club activities</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në angazhimin formal dhe të shoqëruar me dokumentacionet përkatëse në lidhje me përmbushjen e kritereve të mësipërme gjykojmë se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies në UNYT përfshin një sërë formash interaktive me studentët si nga takimet me stafin akademik, takimet me studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare. Veprimtaritë e tjera ndihmëse si leksionet e hapura me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Me ndikim pozitiv në këtë drejtim është dhe përdorimi i sistemit të teknologjisë së informacionit nga stafi dhe studentët në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Student vlerësohet të jetë aktiv dhe të aplikojë dijet edhe në praktikë.</p> <p><b>Shtojcat</b></p> <p><b>2.2 UNYT Syllabuse Psikologji Shqip.pdf</b>  <b>2.4 UNYT Field Trip with Students of Health Psychology Course.pdf</b>  <b>2.6 UNYT Study visit @ Autism Center.pdf</b>  <b>2.7 UNYT Guest Speaker Ela Tollkuqi Ph.D.pdf</b>  <b>2.8 UNYT Ardita Demaj ekstrakurrikulare.pdf</b>  <b>2.22 Article of B.Lahi with bachelor students.pdf</b>  <b>3.1 UNYT Instructor's Handbook_ALB.pdf</b>  <b>6.9 UNYT STUDENT EVALUATION FORM.pdf</b>  <b>6.18 UNYT Teaching and Learning Strategy, Eng.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/ modulit me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies pa lënë mënjanë edhe lirinë akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><b>Shtojcat 3.3 dhe 3.4</b>  <b>Raporti vjetor i qendrës së këshillimit 2020-2021</b>  <b>Rregullore Qendra e Mbështetjes Akademike dhe Qendra e Këshillimit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, jo vetëm përmes strukturave monitoruese, por edhe përmes udhëzuesve për mësimdhënien sidomos programit për trajnim. Këto udhëzues synojnë përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie për stafin akademik të UNYT duke mundësuar përdorimin e metodave të</p>

	<p>shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Mbështetur në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe në syllabuset e lëndëve mësimore. Nga ana tjetër institucioni mbështet stafin akademik për të aplikuar në programin Erasmus + si dhe stafi trajnohet gjatë trajnimeve nga zyra e sigurimit të cilësisë përgjatë vitit akademik sin ë nivel Fakulteti ashtu edhe Departamenti.</p> <p><b>Shtojca</b>  <b>Training program of TMF AL dhe KS School Teachers</b>  <b>Mirëqenia te mësuesit dhe nxënësit</b>  <b>Teknikat e të nxëniet dhe menaxhimit të klasës në mësimdhënie</b>  <b>Erasmus Teaching Week internalization of Teaching</b>  <b>Instanbul Education Summit</b>  <b>Staff Training Tuscia</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Përsa i përket metodologjisë në mësimdhënie duke iu referuar sylabuseve, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme UNYT përgjithësisht krijon kushte për një të nxënë efektiv, kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës, profili i tyre përgjithësisht integrohet mirë me nevojat e programit të studimit dhe me rregullat e fushës së kompetencës së personave të angazhuar. Bazuar në udhëzuesin e mësimdhënies, por edhe mënyrës sesi janë hartuar syllabuset, për përgjithësi ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie si role-play, studim rastesh, fokus-grupe që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit. Këto forma i përshtaten mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri praktike mbi fushën e psikologjisë. Format dhe metodat e mësimdhënies e përdorura nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga pedagogu. Mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimit realizohet në një klimë positive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.</p> <p><b>Shtojcat</b>  <b>1.18 CV e lektorëve</b>  <b>2.36 Rregulloret e Dekanit</b>  <b>Shtyllat e kërkimit shkencor</b>  <b>Student candidat Gnomon</b>  <b>Peer evaluation template</b>  <b>Syllabuset lëndore</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e</p>	<p>Vlerësimi i këtij kriteri mbështetet në kërkesën e zyrës së zhvillimit, kurrikulës dhe cilësisë për përmirësimin e formave dhe metodave në mësimdhënie, ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë</p>



<p>metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>proces ka një përpjekje përmes rolit të koordinatorit të departamentit dhe komisionit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Edhe përgjegjësi i departamentit në çdo filim viti akademik rishikon sylabuset e semestrit dhe të vitit akademik dhe konsultohet me pedagogët për kërkesat që mund të kenë palët. Sylabuset miratohen nga përgjegjësi i Departamentit. Përfshirja e studentit në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatis gjatë dhënies së vlerësimit. Ekziston edhe Komisioni i Ankesave që këshilltari i çdo studentit mund t'ia përcjellë ankesën e studentit për lëndë a pedagogë të veçantë këtij komisioni në anonimatis të plotë për përmirësimin e diçkaje.</p> <p><b>Shtojca 3.12 Detyrat e pedagogëve udhëheqës gjatë semestrit</b>  <b>Rregullore e programit</b>  <b>Rregullore e Departamentit</b>  <b>Rregullore e Fakultetit</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, përmes Zyres së sigurimit të cilësisë që bashkëpunon me Dekanët e Fakultetit, Zyres Alumni dhe Karrierës, Koordinatorit të programit të studimit. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, në funksion të kësaj çështje është hartuar edhe rregullorja për standardet e cilësisë, edhe pse nuk ka evidence të qarta se si bashkërendohet kjo punë nëpër takime janë bërë disa herë pyetja e kësaj natyre. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Përmes raportit të vlerësimit të studentëve, i cili lejon të mbledhë një informacion të detajuar mbi një sërë aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel institucional, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlerësimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikatat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlerësim kryhet nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, i cili monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si Njësisë për Zhvillimin Kurrikulare dhe Cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitiv në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.</p>

	<b>Shtojca 2.35 Academic Seminars From Department of Psychology</b> <b>3.17 Instabil Education Summit</b> <b>3.17.3 Mobility Agreement Lituani</b> <b>3.17.2 Shkëmbim stafi Granada</b> <b>3.17.4 Staff training Tuscia</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Duke iu referuar këtij standardi përgjithësisht kemi një përmbushje të kriterve, dhe për sa më sipër vlerësohet se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive shkencore e profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit, sistemin e vlersimit të studentit, formatin e punimit të diplomës, apo provimit të formimit përfundimtar, etj. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin Google classroom, platforma elektronike që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët edhe përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p>Kryesisht vlerësimet e studentëve bëhen si më poshtë:</p> <p>Provimi i ndërmjetëm 30%</p> <p>40% provimi përfundimtar</p> <p>Projekti kërkimor 20%</p> <p>10% pjesëmarrja active.</p> <p>Studentët njihen me sylabusin e lëndës në fillim të vitit akademik dhe i njohin detyrimet e lëndës në fillim të saj.</p> <p><b>Biseda me studentët</b>  <b>Biseda me stafin akademik</b>  <b>Sylabuset e lëndëve</b>  <b>Rregullore e programit të studimit</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” në fillim të çdo semestri informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive nga pedagogu lektor i lëndës. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësimi më objektiv të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 34

<p>shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.</p> <p><b>Syllabuset e lëndëve</b>  <b>Dokumenti 3.8 Komunikimi me studentët mbi vlerësimin dhe provimin</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Mësohet dhe vlerësohet se studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Elementë kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike, projekti kërkimor dhe niveli i aktivizimit në seminare. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, projekti kërkimor, Përmirësimi, Diploma, për programin e studimit. <b>Syllabuset e lëndëve</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidenca të qarta përsa i përket vlerësimit dhe përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike nga ana e stafit duke përfshirë studentët në këtë proces. Por në takime u diskutua se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e udhëzimin e stafit akademik lidhur me procesin e mësimdhënies. Por edhe përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studentit, dhe formulari i vlerësimit të performancës nga njësia e zhvillimit kurrikular dhe sigurimit të cilësisë, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UNYT duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka ngritur Zyrën e Karrierës në funksion të rritjes së mundësive të studentëve që studiojnë në UNYT për punësimin e mëvonshëm të tyre. Por për këtë qëllim janë realizuar edhe aktivitete si workshope, konferenca, trajnime, mobilitete të stafit dhe studentëve duke u siguruar bashkëpunimin dhe përfshirje të vazhdueshme të partnerëve për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies të stafit akademik dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj. Në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura të cilat krijojnë një klimë bashkëpunimi dhe shkëmbimi përvojë. Zyra e karrierës fton profesionistë të ndryshëm për të organizuar vazhdimisht orë e prezantime të hapura për studentët e stafin me qëllim shtimin e dijeve dhe aftësive për punë. Kjo zyrë ka realizuar 2 aktivitete me Departamentin e Psikologjisë (me qendrën Aksion Puls dhe me institucionin arsimor World Academy Tirana).</p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në komentet dhe diskutimet e realizuara nga GVJ lidhur me kriteret e cituara mësipër gjykojmë se ky standard në tërësi nuk ka hapësira për sugjerime duke u konsideruar i <b>përbushur plotësisht</b>.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin Bachelor në “Psikologji” duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Mbështetur në procedurën e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit.</p> <p><b>Syllabuset e lëndëve</b>  <b>Rregullore e programit të studimit</b>  <b>Rregullore e Departamentit</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit përmes sekretimit të provimeve dhe platformat elektronike sidomos gjatë pandemisë Covid 19 u ngrit Qendra e provimeve. Udhëzimet ishin të qarta për këtë process.</p> <p>Mësohet gjatë takimeve me stafin dhe studentët se përveç platformës Turnitin për zbulimin e plagjiaturës së punimeve shkencore të studentëve, abuzimet kryesisht parandalohen edhe nga rregullat specifike si kamerat e hapura, etj. Dhe pyetjet kryesisht kanë qenë kritike me qëllim dhënien e argumenteve dhe arsyetimeve të domosdoshme.</p> <p>Aktualisht provimet realizohen në klasë dhe në prani të profesorit.</p> <p><b>Rregullore e programit të studimit</b></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p><b>Shtojca 3.15 Platforma e provimeve 2020</b></p> <p>Njësia bazë ka një procedurë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e afateve kohore që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Teza miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Shumatorja e pikëve të grumbulluara gjatë vitit dhe provimi përfundimtar konvertohet në notën e provimit.</p> <p>Praktikat profesionale, dhe mbrojta e diplomave apo provimi i formimit përfundimtar realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatit e çdo studenti. Ç'sekretimi i tezave të korigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën ç'sekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.</p> <p><b>Rregullore e programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen, bazuar edhe në Rregulloren e Departamentit çdo student ka të drejtë të konsultojë tezën, të kërkojë sqarim për notën, të kërkojë rivlerësim të notës përmes komisioneve të posacme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim. Studentët kur duan të shohin notën e kontrollojnë në sistemin Gnomon. Aty kërkojnë edhe sqarime për pikët e notën.</p> <p>Për projektet kërkimore student qartësohet në platformën Turnitin ku merr vlerësimin dhe argumentimin për vlerësimin e marrë.</p> <p><b>Shtojca 3.8</b>  <b>Komunikimi i studentëve mbi provimet</b>  <b>Shtojca 4.2</b>  <b>Akses i profesorëve në sistem</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse e UNYT dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave që lidhen me kushtet si moskopjimi, dënimi i plagjiaturës, mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mira për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Platforma Turnitin si dhe Kodi i nderit të studentit me të cilët studentët dhe stafi akademik njihen që në fillim të nënshkrimit të marrëveshjes së tyre me UNYT janë një garanci e mirë për të kontrolluar detyrat dhe çdo lloj forme mashtrimi në kërkimin shkencor. Kjo pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve. Në provime pedagogu kujdeset që studentët të rrinë larg njëri-</p>




	<p>tjetrit dhe të mos kenë mundësi kopjimi. Studentët që dorëzojnë një detyrë me një shkallë plagjaturë prej 25% ose më lart vlerësohen me notën F ose 0% të pikëve.</p> <p><b>Shtojca 3.2 Kodi i ndershmërisë së studentit</b> <b>Shtojca 3.9 Turnitin</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>UNYT disponon një procedurë të mirëfilltë për sa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimit nga ana e studentit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabusin e lëndës. Gjithashtu kontrolli i cilësisë realizon kontrole lidhur me transparencën në vlerësimin me notë duke monitoruar komponentët e caktuar të krahasimit të vlerësimit të realizuar nga stafi akademik për lëndë specifike.</p> <p><b>Rregullore e programit shtojca 1.10</b> <b>Syllabuset lëndore</b></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Institucioni respekton procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në sistemin elektronik që akseson me kodin e tij çdo student ose edhe përmes sekretarisë mesimore. Çdo student ka të drejtë të konsultojë tezën, të kërkojë sqarim për notën, të kërkojë rivlerësim të notës përmes komisioneve të posaçme që ngrihen nga njësi bazë për këtë qëllim pasi ka bërë një kërkesë zyrtare për rishikim të vlerësimit. Duke u bazuar te rregullorja e njësisë bazë por edhe te rregullorja e programit dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte.</p> <p><b>Shtojca 1.10 Rregullore e programit</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVI bazuar në sa diskutimet gjatë vizitave në institucion dhe dokumentacionin e dorëzuar dhe të referuar më sipër gjykojmë se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë të profileve interdisiplinare në kontekstin e fushës së psikologjisë. Kjo larmishmëri synon të zhvillojë aftësi dhe kompetenca në drejtim të rolit të psikologut bazuar në lëndët mësimore, literaturën e përdorur duke garantuar deri diku njohuri të thelluara që studentët i marrin në ciklin e parë të studimeve. Në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet që lidhen me fushën e psikologut dhe në një aftësim për të zhvilluar kompetenca profesionale te studentët, program i studimit duhet t’iu garantojë studentëve thellim njohurish dhe t’iu zhvillojë aftësi profesionale, gjë e cila bazuar në stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie<sup>23</sup>, syllabuseve<sup>24</sup> dhe literaturës së përdorur duhet të integrohen në mënyrë më të plotë që të përmbushet me sukses ky kriter.</p> <p><i>Si edhe është specifikuar më sipër lidhur me planin mësimor të këtij program GVJ sugjeron disa rekomandime për përmirësimin më të mirë të mundshëm të kurrikulës me qëllim aftësimin dhe zhvillimin e aftësive profesionale të përgjithshme dhe të veçanta të studentëve. Është e vërtetë që në krahasim me planprogramin 4 vjeçar të mëparshëm ky plan mësimor ka përmirësime të dukshme, por sugjerimet lidhen me shtimin e disa lëndëve të tjera dhe zëvendësimin e disa lëndëve aktuale jo të përshtatshme dhe nevojshme për një psikolog të ardhshëm.</i></p> <p><i>Sugjerimet e GVJ lidhen me lëndën Praktikë që të shtrihet përgjatë një vitit akademik dhe të pozicionohet në vitin e tretë akademik të studimeve.</i></p> <p><i>Sugjerohet të shtohen disa kredite të lëndëve karakterizuese si Motivacion, Sjellje organizacionale, Menaxhim i stresit, Etikë profesionale, Emocione ose Inteligjencë emocionale, Aftësi e kufizuar, Psikologji shkollore.</i></p> <p><i>Si dhe sugjerimet e sipërpërmendura lidhur me lëndë që mund të zëvendësohen në kurrikul si Aplikime kompjuterike, Algjebër, Të ushqyerit njerëzor nuk vlerësohen aq të nevojshme përpara lëndëve të sugjeruara më sipër dhe që janë munguese në planprogram. Një psikologu të ardhshëm do i nevojiten më tepër njohuri nga këto lëndë.</i></p> <p><i>Gjithashtu plotësimi i stafit akademik me staf profesionist dhe me kompetenca profesionale në fushën e psikologjisë do të ishte një ndihmë në aftësimin e mëtejshëm të studentëve dhe jo me staf efektiv profili i të cilëve nuk përkon me fushën e psikologjisë.</i></p> <p><b>Plani mësimor Bachelor në Psikologji</b>  <b>Syllabuset e lëndëve</b>  <b>CV e stafit akademik të programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane,</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” përmes lëndëve specifike të integruar si pjesë e kategorisë D, Lëndëve plotësuese përmes moduleve të teknologjisë së informacionit dhe gjuhës së huaj, specifikisht gjuhën turke, të cilat mundësojnë që studentët të zhvillojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme për përmbushjen e detyrave të ndryshme profesionale, të</p>

<sup>23</sup> Ev 33. CV e stafit akademik.

<sup>24</sup> Ev 2.2. Syllabuset e lëndëve

<p>sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>komunikimit dhe ndërveprimit duke përdorur njohuri dhe shprehje ndërdisiplinare. UNYT dhe njësia bazë për këtë program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në aspektin praktik përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online, apo portalit studentor. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit këto aktivitete ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim si angazhimi i stafit bashkë me studentët. Laboratori i teknologjisë si dhe fakti që studentët kanë akses dhe asistohen në përdorimin e sistemit elektronik të universitetit janë evidenca që studentët kanë mundësi në lidhje me këto zhvillime.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës përmes udhëzimeve të veçanta dhe vlerësimit të njohurive në përfundim të semestrit përkatës. Në vijimësi njësi të tjera si Departamenti dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë monitorojnë vijimësinë e realizimit të objektivave formative dhe aspekte të tjera përmes formave të ndryshme të marrjes së të dhënave me studentët në lidhje me lëndën dhe pedagogët. Raporti i punës semestrale analizohet nga ana e çdo pedagogu në përfundim të lëndës së tij duke u ndalur në në sërë aspektesh që kanë të bëjnë me mësimdhënien, mësimnxënien, të cilat më tej përmbledhen në analizën vjetore të departamentit çka ndahet edhe me anëtarët e tjerë të Departamentit, Dekanin e Fakultetit dhe zyrën e kontrollit të cilësisë.</p> <p><b>Shtojcat</b>  <b>6.19 Raporti semestral i semestrit të dytë/ pranverë 2021</b>  <b>6.19.1 Raporti semestral i semestrit të parë/ vjeshtës 2022</b>  <b>6.19.2 Raporti semestral i semestrit të dytë /pranverë 2022</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjejmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm japin njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë, të cilat përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve. Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore por edhe informacionit të marrë në institucion në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit Bachelor në "Psikologji", personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara në kontekstin e profilit të studimit. Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera kemi nisma me një sërë institucionesh brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga UNYT si konferenca, ëorkshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu, ka një klimë pozitive të ndërveprimit midis një pjese të stafit dhe studentëve për çështjet mësimore. Procesi i mësimdhënies bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimit kritik mbi</p>






	<p>çëshjtet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxëniet në tërësi.</p> <p><b>Shtojca 1.10 Rregullore e programit</b>  <b>Shtojca 2.2 Sylabuset e lëndëve</b>  <b>Shtojca 5.2 Shkëmbim stafi Erasmus dhe Mevlana</b>  <b>Shtojca 5.2.1 Lista e MoU, Mevlana dhe Erasmus +</b>  <b>5.31 Incoming students Hatice Balcan</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë në UNYT ka praktika të mira përsa i përket hapësirave që ka për të përfituar nga përfshirja në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që janë fituar nga institucioni, përfitimi nga mobiliteti i stafit dhe studentëve përmes projekteve të BE, eventet e ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si trajnime, konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar vendas apo të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari. Përmes krijimit të mundësisë për pjesëmarrje në konferencat që UNYT organizon pa pagesë për stafin e tij akademik krijohen mundësi për përfitimin e përvojave nga kolegë e të tjerëve që do të kenë impakt edhe në këtë program studimi. Gjithashtu një veprimtari e vlefshme janë ato me Erasmus +, etj., për realizimin e mobiliteti i stafit dhe studentëve të tij shihet si pozitive. Gjatë 3 viteve të fundit disa anëtarë të departamentit kanë mbajtur leksione të hapura si Prof asoc Cenko, Dr Lahi, Dr. Halimi.</p> <p><b>Shtojca 2.35 Seminar Akademik</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ duke vlerësuar sidomos në mënyrë specifike disa elementë të programit mësimor të këtij programi studimi gjithashtu edhe duke vlerësuar domosdoshmërinë e pasqyrimin të këtyre elementëve në planin mësimor si sugjerimet në lidhje me lëndën Praktike që të shtrihet përgjatë një vitit akademik dhe të pozicionohet në vitin e tretë akademik të studimeve apo përfshirjen në program të disa lëndëve të reja për të rritur njohuritë e studentëve si profesionistë të ardhshëm në fushën e Psikologjisë, duke pasur hapësira zëvendësimi lëndësh.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet</p>	<p>Duke u bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit Bachelor në “Psikologji” dhe mbi udhëzimin për punimin e temës së diplomës një student i përmbyll studimet e Bachelor me një projekt diplomimi dhe për këtë duhet të plotësojë disa kushte të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit si psh duhet të ketë grumbulluar 144 kredite, te ketë plotësuar gjithë provimet e vitit të parë, të ketë përfunduar lëndën e</p>

<p>pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Praktikës. Çdo student ka një pedagog supervisor për projektin e diplomës. Ndërkohë për vlerësimin e këtij punimi projekt diplome është supervisor ai që vlerëson këtë projekt. Në rregullore nuk ka as parashikueshmëri për provim përfundimtar.</p> <p><i>GVJ sugjeron se një përmbyllje e studimeve me një formë projekti diplomimi është gjë e mirë dhe vlerësohet të jetë ndihmuese për studentin, por vlerësimi i një punimi të tillë prej supervisorit të këtij projekti nuk është në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë duke ditur se çdo provim apo punim shkencor diplome duhet të mbrohet përpara një komisioni si dhe nga ana tjetër ka një konflikt interesi mes të udhëhequrit të një punimi projekt diplome dhe vlerësimit të vetë punës tënde. Kjo gjë nuk bën sens dhe nuk ndihmon as udhëheqësin dhe as vetë studentin për transparencë dhe shkallë kritike.</i></p> <p><b>Rregullore e programit Bachelor në psikologji</b>  <b>Plani mësimor Bachelor në psikologji</b>  <b>Shtojca 3.11 Rregullore e diplomimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Njësia bazë dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës sidomos supervisor i kësaj lënde. Përsa i përket realizimit të provimit të formimit studentët e këtij programi në përfundim të këtij cikli studimi, diplomohen në profilin e psikologjisë së përgjithshme pas mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Ekziston një rregullore e diplomës dhe projektit të graduimit të studentëve, por vlerësimi i saj lë për të dëshiruar pasi duhet të riorganizojë formën e vlerësimit kritik dhe cilësor të saj. Ngritja e një komisioni që vlerëson projektin e diplomës është domosdoshmëri dhe kërkesë ligjore. Ndaj GVJ sugjeron departamentin ta rishohë këtë rregullore dhe përfshijë edhe në të vlerësimin e paanshëm dhe shkencor të punimit të diplomës.</i></p> <p><b>Takime me stafin akademik</b>  <b>Rregullore e programit të studimit</b>  <b>Takime me studentët e programit</b>  <b>Shtojca 3.11 Rregullore e diplomimit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e këtij programi dhe planit mësimor testimi final nuk realizohet.</p> <p><i>Ekziston një rregullore e diplomës dhe projektit të graduimit të studentëve, por vlerësimi i saj lë për të dëshiruar pasi duhet të riorganizojë formën e vlerësimit kritik dhe cilësor të saj. Ngritja e një komisioni që vlerëson projektin e diplomës është domosdoshmëri dhe kërkesë ligjore. Ndaj GVJ sugjeron departamentin ta rishohë këtë rregullore dhe përfshijë edhe në të vlerësimin e paanshëm dhe shkencor të punimit të diplomës.</i></p> <p><b>Plani mësimor i programit të studimit</b>  <b>Rregullorja e programit të studimit</b>  <b>Shtojca 3.11 Rregullore e diplomimit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit studentët vihen në dijeni përgjatë semestrave akademike nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga asupervisor i projektit të Diplomës mbi rregullat e mbrojtjes së punimit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 42

<p>përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>të diplomës në përmbyllje të studimeve të këtij programi. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësi bazë, e cila ngarkon një supervisor për studentin dhe bashkë përgatitjen ngritjen e projektit empirik për Diplomën si një projektpropozim pranë njësisë bazë. Për studentit dhe pedagogun udhëheqës janë të detyrueshme seancat e konsultimit individuale përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit, si dhe të nënshkrimit nga pedagogu udhëheqës të punimit final para se të dorëzohet punimi. Udhëheqësi i diplomës/mbikqyrësi përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledhë, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor original dhe do të jetë ai që do të vlerësojë punimin shkencor.</p> <p><i>GVJ sugjeron që ky udhëheqës shkencor të jetë drejtuesi kryesor dhe mentori i studentit për çuarjen përpara të projektit të diplomimit, por nuk mund të jetë vlerësuesi kryesor dhe aq më pak i vetëm i këtij projekti. Arsyet janë të qarta, konflikti i interesit. Ngritja e komisionit të vlerësimit del domosdoshmëri.</i></p> <p><b>Shtojca 3.11</b>  <b>Rregullore e projektit të diplomës</b>  <b>2.2 Sylabusi i Temës së Diplomës</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jashtë institucionit, ai ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi. Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si seancat e konsultave individuale, konsultat me pedagogët e tjerë, aksesit në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka dhe salla e leximit.</p> <p><b>Shtojca 3.11</b>  <b>Rregullore e projektit të diplomës</b>  <b>2.2 Sylabusi i Temës së Diplomës</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e projektit të diplomës studentit vlerësohet me notë nga supervisorit i praktikës dhe që i korrespondon sistemit të vlerësimit me notë dhe germë të UNYT.</p> <p><i>Sërish GVJ sugjeron që ky udhëheqës shkencor të jetë drejtuesi kryesor dhe mentori i studentit për çuarjen përpara të projektit të diplomimit, por nuk mund të jetë vlerësuesi kryesor dhe aq më pak i vetëm i këtij projekti. Arsyet janë të qarta, konflikti i interesit. Ngritja e komisionit të vlerësimit del domosdoshmëri dhe është logjike. Sugjerohet të rishikohet rregullorja e departamentit, ajo e programit të studimit si dhe rregullorja e diplomimit për këtë çështje.</i></p> <p><b>2.2 Sylabusi i Temës së Diplomës</b></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është konform ligjeve dhe procedurave të Q.SH.A.-së për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave. Forma e paraqitjes së diplomës do të jetë përfundimtare sipas profilit dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve me marrjen e akreditimit të parë pasi është një riorganizim programi aktualisht. Në përfundim të studimeve, studentit do të pajiset me diplomën, listën notash dhe suplementin e diplomës në programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”. Kjo formë e paraqitjes së diplomës duhet të jetë konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim duhet të emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin, me të cilin programi ka marrë vendimin për hapjen, licensim dhe së fundmi për akreditim. Suplementi i diplomës do të jetë në gjuhët shqip dhe anglisht.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studentit, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Zyrat përgjegjëse për këto dokumente janë : Zyra e regjistrimit, zyra e sigurimit të cilësisë dhe Zyra e Çështjeve studentore. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Duke iu referuar të dhënave të evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar si dhe nga vizitat në insitucion, sidomos edhe nevojshmërisë e domosdoshmërisë së vlerësimit të projektit të diplomës nga komisioni përkatës në diplomimin e studentëve të këtij programi studimi, GVJ gjykon se kriteret e lidhura me standardine mësipërm <b>përbushen kryesisht.</b></i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR  
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin, proceduarat dhe vizitën në institucion, rezulton se UNYT ndjek dhe zbaton përmbushjen e kërkesave ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit dhe angazhimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Psikologji”.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Për vitin akademik 2020- 2021 gjithsej kanë dhënë mësim në këtë program studimi 8 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 3 PAK (62.5 % /37.5 %);</li> <li>Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 7 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 2 PAK (71.43 % / 28.57%);</li> <li>Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 5 PAK (68,75 % /31.25%);</li> </ol> <p>Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Për 2020-2021, 62.5% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37.5% janë Msc;</li> <li>Për 2021-2022, 100% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 71.4% janë PHd dhe DR;</li> <li>Për 2022-2023, 68.75 % e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 31.25% janë Msc.</li> </ul> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se vetëm mbi 80% e stafit është me të tre nivelet e formimit akademik në psikologji dhe përsa i përket drejtuesit të programit, i kanë të tre kualifikimet në psikologji.</p> <p><i>Si edhe sugjerimi në piken më sipër GVJ sugjeron që një shtim i personelit akademik t'i korrespondonte profesionalisht përputhshëmisë së specifikave të Departamentit të psikologjisë dhe jo një fushe tjetër të specialitetit, aq më tepër kur nevojat e lëndëve të departamentit lidhur me këtë specialitet nuk i kalojnë maksimumi 2 lëndë (Biologji Humane dhe Truri e Sjellja). Përfitim i departamentit me një staf efektiv me specialitetin</i></p>

	<p><i>Psikologji do të ishte më i arsyeshëm dhe i domosdoshëm dhe i përputhur me ligjin në fuqi mbi kompetencat dhe aftësitë e specializuara të anëtarëve të një Departamenti.</i></p> <p><i>Gjithashtu vihet re se në departament si personel të brendshëm janë pjesë edhe staf i cili nuk është i specializuar për Psikologji por për gjuhë të huaj Angleze dhe ka mbaruar Master shkencor për mësues në gjuhën Angleze. Një personel i tillë nuk mund të jetë pjesë e stafit akademik efektiv në Departament pasi ul cilësinë e stafit mësimdhënës dhe nuk ka fushën e kompetencës në Psikologji.</i></p> <p><i>Staf i tillë akademik efektiv nevojitet të zëvendësohet me staf kompetent për fushën e emërtimit që ka Departamenti dhe programin e studimit që ai drejton.</i></p> <p><b>2.37 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB.pdf</b></p>																					
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të pjesshme mbulon gjithsej 225 orë mësimore (19.48%) nga 1115 orë total në auditor dhe pjesa tjetër mbulohet nga personeli akademik me kohë plotë, i cili duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi (Vendimit Nr. 418, datë 10.5.2017) dhe një përlllogaritje e orëve në auditor rezulton se për këtë program 930 orë lektohen nga <b>PAE (80,52%)</b>. (Tabela 12.3, viti 2022-2023)</p> <p>Referuar Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, II, pika 1 “Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor në IAL”, specifikohet se orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë dhe me raste specifike ka të përcaktuar procedurën, ndërkohë nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezulton se PAE i angazhuar në këtë program mbulon orë mësimore që variojnë nga minimum 45 (Msc K.K) orë mësimore në maksimumin 360 (MSc C.C) orë mësimore (MSc C.C) duke mos e kaluar mbingarkesën e 200 orëve suplementare. Përsa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, ai mund të mbulojë ngarkesën vjetore 120 orë në auditor dhe nuk mund të ketë orë suplementare (pika 2 Udhëzimi 29, datë 10.09.2018), dhe në këtë program mësimor ka raste si Dr. E.F. (PAK) e cila jep 135 orë mësimore në auditor duke shkelur pikën 2 të Udhëzimit 29. (Tabela 4 për vitin akademik 2022 – 2023)</p> <table border="1" data-bbox="624 1518 1114 1960"> <thead> <tr> <th>Personel Akademik</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>B. L</td> <td>290</td> <td></td> </tr> <tr> <td>E. M</td> <td></td> <td>60</td> </tr> <tr> <td>M. H</td> <td></td> <td>45</td> </tr> <tr> <td>R. D</td> <td>240</td> <td></td> </tr> <tr> <td>K. K</td> <td>45</td> <td></td> </tr> <tr> <td>A. C</td> <td></td> <td>30</td> </tr> </tbody> </table>	Personel Akademik	PAE	PAK	B. L	290		E. M		60	M. H		45	R. D	240		K. K	45		A. C		30
Personel Akademik	PAE	PAK																				
B. L	290																					
E. M		60																				
M. H		45																				
R. D	240																					
K. K	45																					
A. C		30																				




B. J. H		66
P. R	295	
E. G	307	
E. C	265	
E. Gj	180	
E. F		135
I. N	250	
T. U	315	
C. C	360	
E. C	270	
K. S	225	
<b>Totali</b>	<b>3042</b>	<b>336</b>

Referuar Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, pika 6. "Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrare në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në 2 semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrare, ose 3 lëndë vjetore. Masivisht i gjithë stafi është me 6 lëndë semestrare, por gjenden pedagogë si Prof. Asoc. I.N. me 7 lëndë semestrare; Dr. B.L. me 7 lëndë semestrare dhe 2 projekte e tema diplomash; Dr.P.R. me 7 lëndë semestrare; Prof.Asoc.E.C me 6 lëndë semestrare 2 lëndë tmë diplome dhe 1 praktikë (Ref tabela 4)

Gjithashtu referuar këtij programi studimi janë ftuar edhe shumë profesorë dhe ekspertë të fushave të ndryshme të psikologjisë.

*GVJ gjykon që për një pjesë të PAE ngarkesa është e lartë, në shumë lëndë semestrare dhe në kufijtë e mbingarkesës ligjore, gjë e cila ndikon negativisht në cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e psikologëve profesionistë.*

### **2.37 Tabelat permbledhese per Aneks\_RVB.pdf**

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata paafat dhe është i punësuar pranë IAL prej vitesh. Nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik me kohë të pjesshme të angazhuar në mësimdhënien në këtë program, u onfirmua se dhe ata prej vitesh kishin marrëdhënie me UNYT. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë të reflektuara në Statutin e Universitetit, Kapitulli i Gjashtë "Personeli i Universitetit", neni 41 dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Institucioni nëpërmjet Këshillit të Fakultetit dhe

	<p>specifikisht Komisionit <i>Ad Hoc</i> ndjek në mënyrë rigoroz procedurat në bashkëpunim me Departamentet. Propozimi i kandidatëve në listën e shkurtuar të Komisionit <i>Ad Hoc</i> duhet të miratohet nga Rektori dhe Bordi i Administrimit për Drejtuesin e njësisë kryesore / Drejtuesin e njësisë bazë / zëvendës rektorin dhe pozicionin professor dhe për personelin tjetër akademik (Statusi i UNYT, neni 41). GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015, Kodin e Punës në RSH dhe aktet ligjore e normative në fuqi. Gjithashtu edhe Departamenti i burimeve njerëzore ka të standardizuar politikat dhe procedurat për qëndrueshmërinë dhe statusin e personelit.</p> <p>Nga vizita në institucion u konfirmua prezenca e kontratave të punës për personelin efektiv dhe atë të jashtëm të Departmentin e Psikologjisë, si dhe pagesa e rregullt e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.1.1 UNYT Organigrama.pdf</b>  <b>4.24 UNYT Politikat dhe Procedurat e Departamentit të Burimeve Njerëzore.pdf</b>  <b>4.25 UNYT Format i shpalljes së pozicionit.pdf</b>  <b>4.26.1 UNYT Lista e Dokumenteve për Akademik të Huaj.pdf</b>  <b>4.26.2 UNYT Lista e Dokumenteve PT Akademik.pdf</b>  <b>4.27 UNYT Anekset e Kontratave.pdf</b>  <b>4.28 NYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar.pdf .</b>  <b>4.28.1 UNYT Kontratë Pune me kohë të pjesshme.pdf</b>  <b>4.28.2 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësues dhe administrativ janë të evidentuara në Statusin e Institucionit, në rregulloren e Universitetit, Kreu III: Personeli i Universitetit, por edhe në dokumentin e përcaktimit të politikave të Zyrës së Burimeve Njerëzore. I gjithë procesi i rekrutimit dhe vlerësimit konform kriterëve të shpallura ndiqet dhe vlerësohet nga Komisioni Ad Hoc (komisioni i rekrutimit) pas evidentimit të nevojës për staf nga përgjegjësi i departamentit dhe miratimit nga Rektori i UNYT-së. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL ose në faqe të agjencive ndërkombëtare, sikundër dhe lehtësisht mund të evidentohet <a href="https://unyt.edu.al/ep-content/uploads/2023/06/Vacancies-2023-2024-Academic-Psychology_compressed.pdf">https://unyt.edu.al/ep-content/uploads/2023/06/Vacancies-2023-2024-Academic-Psychology_compressed.pdf</a>. Aplikimet bëhen me dokumentet përkatëse (originale ose të noterizuara) në adresën e publikuar në shpalljen e vendit të lirë të punës dhe shqyrtimi i palikimeve dhe renditaj e tyre bëhet nga një komision <i>Ad Hoc</i>. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga rektori. Zyra e Burimeve Njerëzore është zyrë përgjegjëse për koordinimin dhe sigurimin e procedurës së rekrutimit të personelit akademik, pas propozimit nga njësia bazë të nevojës për personel, këshilli i fakultetit i propozon Rektorit vëndin vakant dhe pas miratimit ai publikohet, gjithashtu Këshillimi i</p>



	<p>fakultetit ngre dhe komisionin <i>Ad Hoc</i> për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidaturës për personelit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme. Komisioni <i>Ad Hoc</i> propozon renditjen përfundimtare. Rektori miraton klasifikimin përfundimtar dhe shpall fituesin e procedurës. E njëta procedurë ndiqet edhe për rekrutimin e stafit të huaj.</p> <p>GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>4.24 UNYT Politikat dhe Procedurat e Departamentit të Burimeve Njerezore.pdf</b>  <b>2.4.3 UNYT Invitation of MSc Arela Carku in the Educational Psychology Course.pdf</b>  <b>4.25 UNYT Format i shpalljes së pozicionit.pdf</b>  <b>4.26.1 UNYT Lista e Dokumenteve për Akademik të Huaj.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UNYT siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera mësimore referuar rregullores së institucionit, sesioni C. Njësitë ndihmës akademike (fq 23) dhe strukturës organizative, sesioni D. Struktura administrative (fq 27). Strukturat e ngritura pranë IAL-së ndjekin procedura rigorozë dhe kryejnë detyra të tjera mbështetëse në përputhje me politikat pëekatëse të institucionit për të siguruar realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Në këtë universitet është ngritur dhe funksionin edhe Departamenti i shërbimeve mbështetëse, i cili është përgjegjës për sigurimin dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve mbështetëse të tilla si Marrëdhëniet me Klientin, Prokurimi, Mirëmbajtja, Menaxhimi i objektit, Siguria, etj. Politikat dhe procedurat e shërbimeve mbështetëse e ndihmojnë personelin për të menaxhuar mirëmbajtjen dhe funksionimin e përditshëm të ambienteve të UNYT. Stafit është i trajnuar që të përmbushë detyrat e tij administrative dhe mbështetëse edhe në efektet e emergjencave të ndryshme.</p> <p><b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit.pdf</b>  <b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.pdf</b>  <b>4.3 UNYT Departamenti i Shërbimeve Mbeshtetese- Politika dhe procedura.pdf</b>  <b>4.4 Akt miratim Main_Building Higjeno-Sanitar_2018.pdf</b>  <b>4.5.2 Fire Protection Certificate_2021-2026.pdf</b>  <b>4.6 Trajnim i brendshëm stafi_Ndihma e Shpejte.pdf</b>  <b>4.6.8 Prova Evakuim Shpetimi.pdf</b>  <b>4.6.10 Raport Vleresim Risku_UNYT_MainBuilding_2020.pdf</b>  <b>4.14 UNYT Manual of Information Security, Alb.pdf</b>  <b>4.17 UNYT IT Support Services, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të</p>	<p>UNYT, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Zyra Juridike mbledhin, ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit “Psikologji”, në përputhje me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 49




<p>angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të.</p>	<p>legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Secili anëtar i stafit, përfshirë këtu edhe personelin ndihmës dhe administrative, refruar edhe Kontratës së Punës, dakodëson mbi mënyrën e përdorimit të të dhënave personale. Referuar transparencës Zyra e Burimeve Njerëzore ka miratuar publikimin në ëeb e universitetit jetëshkrimet e personelit në faqen <a href="https://unyt.edu.al/index.php/faculty/">https://unyt.edu.al/index.php/faculty/</a> . Në kontratën e punës, në pikën 6. Të Dhënat Personale, saktësohen edhe detyrimet e palëve në raport me ruajen dhe përdorimin e këtyre të dhënave. Universiteti ka të miratuar edhe dokumentin për mbrojtjen e të dhënave (Evidenca 4.16)</p> <p>Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore; Ruajtja e të dhënave personale sansinohet edhe në nenin 76 të Rregullores së Universitetit.</p> <p>GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejti se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p><b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>3.5 UNYT Departmental engagement of lecturers in providing training for teachers.pdf</b>  <b>4.16 UNYT IT Data protection Policy, Eng.pdf</b>  <b>4.28 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar.pdf</b>  <b>4.28.1 UNYT Kontratë Pune me kohë te pjesshme.pdf</b>  <b>4.28.2 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga raporti i GVB vihemi në dijeni të egzistencës së një historiku Marrëveshesh Bashkëpunimi për zhvillimin e praktikës në institucione, UNYT dhe organizatave dhe institucioneve publike dhe private Brenda vendit dhe jashtë vendit. Mësimdhënia në këtë universitet është në anglisht, e cila lehtëson dhe bashkëpunimin jo vetëm ndërmjet stafeve por edhe ndërmjet studentëve, kjo edhe për procesin e praktikës profesionale apo për punimin e diplomës. Referuar raportit të GVB-së të institucionit gjendet një listë më marrëveshje, por në dokumentacion e vënë vënë në dispozicion nuk figurojnë marrëveshjet, ndërkohë që ka disa aktivitete të praktikave studentore. Kështu institucioni realizon edhe takime në terren dhe janë vënë në dispozicion të GVJ edhe dokumentacionet përkatëse për dokumentimin e udhëtimeve të tilla, si dhe vizita studimore në përmbushje të marrëveshjeve që ka me institucionet përkatëse.</p> <p>Nga faqja e web e universitetit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/related-links/">https://unyt.edu.al/index.php/related-links/</a> informohemi me një sër universitetesh, institucioneve, fondacione, njësi akademike ndërkombëtare me të cilat universiteti ka marrëdhënie në disa raste dhe binjakëzime. Gjithashtu bashkëpunimi universitar është evident edhe në fushën e projekteve dhe të kërkimeve <a href="https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/">https://unyt.edu.al/index.php/projects-research/</a> por nuk kemi të dhëna specifike për programin “Psikologji”.</p> <p><b>2.4 UNYT Field Trip with Students of Health Psychology Course.pdf</b></p>

	<p><b>2.4.1 UNYT Field Trip with Students of the Educational Psychology Course.pdf</b></p> <p><b>2.6 UNYT Study visit @ Autism Center.pdf</b></p> <p><b>2.6.1 UNYT Study Visit on Psychological Testing at the Municipality of Tirana.pdf</b></p> <p><b>2.6.1 UNYT Study Visit at the Institute of Public Health.pdf</b></p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për të njohur apo evidentuar personelin mbikqyrës në ambientet ku realizohet praktika profesionale e studentëve. Gjithashtu nuk gjenden as detyrimet përkatëse të këtij personeli në ndihmën ndaj studentëve për përbushjen e detyrimeve për plotësimin e praktikës profesionale, edhe dokumenti 5.35 I Internshipi nuk rezulton në dokumentet e vëna në dispozicion.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët, por edhe me stafion akademik konfirmoi se ata kryenin aktivitetet të ndryshme praktike, si dhe praktikën profesionale, ishin vendosur nëpër institucione dhe shprehnin vlerësimin për asistimet të tyre për realizimin e praktikave profesionale, si nga pedagogët, aktorët e tjerë të zyrave me studentët apo të zyrës për bashkëpunimin, por dhe nga institucionet ku ndiheshin të mirëpritur.</p> <p><b>2.33 UNYT Raport Vleresimi per praktiken Muberra Demircin.pdf</b></p> <p><b>2.33.1 Evaluation of the Internship ëork from the Job Supervisor_Klajna Pine.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e përshtatshëm akademik, në përputhje me programin "Psikolog". Sygjerohet që institucioni të dokumentojë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera të arsimit të lartë, përfaqësuesit e biznesit e kompanitë, si dhe të evidentohet personeli i departamentit të psikologjisë i cili është i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës, apo edhe për dhe veprimtari të tjera specifike sipas profilit përkatës të psikologut.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të rishihet ngarkesa e orëve në auditor, numri i lëndëve semestrare dhe mbingarkesa e stafit akademik</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi IV.2**

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UNYT e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe modulet përkatëse. Godina ku gjendet Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore dhe zhvillon mësimdhënien programi “Psikologji”, ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve që ka aktualisht. Sipërfaqja m<sup>2</sup>/për student është më shumë se 2.55 m<sup>2</sup>. Gjithashtu institucioni ka edhe Raport Analize Uji Nr. 1179 datë 12.10.2022 dhe Raporti i Vlerësimit të Rrezikut, datë 13.08.2020, Relacionit Arkitektonik, si dhe Akt-Miratim Higjeno-Sanitar Nr.1794, datë 07.11.1018.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme. Gjithashtu u konstatua që infrastruktura e UNYT krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.</p> <p><b>2.37 Tabelat përmbledhese per Aneks_RVB.pdf, Tabela 16, Tabela 17</b></p> <p><b>4.4 Akt miratim Main_Building Higjeno-Sanitar_2018.pdf</b></p> <p><b>4.5.2 Fire Protection Certificate_2021-2026.pdf</b></p> <p><b>4.8.1 Water Analysis Report_2022.pdf</b></p> <p><b>4.10 UNYT Agikons 11.03.2022_10.03.2023.pdf</b></p> <p><b>4.11 UNYT Main Building Technical Report.pdf</b></p> <p><b>4.12 UNYT Space and Facilities (1).pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga NYUT janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Institucioni siguron hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit. Mjediset mësimore, auditorët, janë të mirëpajisura me tabela dhe dërrasa dhe në çdo klasë ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si PC, videoprojektor, TV, kamera dixhitale dhe pajisje CD /DVD/VHS). Rrjeti i internetit është shtrirë në të gjithë mjediset e universitetit, në mjediset mësimore dhe në të gjitha mjediset e tjera rrethuese. Në institucion ndodhet dhe zyra e IT, e cila asiston me teknologjinë e informacionit në të gjithë rastet e nevojshme, por gjithashtu asiston dhe studentët me nevoja të veçanta dhe ushtron</p>




	<p>veprimtari sipas manualit përkatës. (Statuti, neni 52). Referuar manualit te politikave të kësaj zyre dhe instalimi i softëare duhet të jetë i realizuar dhe i monitoruar nga kjo zyrë si një element shtesë i sigurisë mbi informacionet që ky universitet aplikon. Në universitet funksion dhe sistemi ProProfs, i cili është një krijues kuizesh me mjete të zgjuara analize që e bëjnë atë ideal për mësuesit dhe studentët. Klasat dhe auditorët e NYUT janë të pajisura infrastrukturen e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies, sisteme që mundësojnë perditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor. Më shumë se 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave ku realizohet mësimi është me dritare, duke garantuar ndriçim natyror dhe ajrosje të mjaftueshme.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>4.14 UNYT Manual of Information Security, Alb.pdf</b>  <b>4.15 UNYT Softëare Installation Policy, Alb.pdf</b>  <b>4.16 UNYT IT Data protection Policy, Eng.pdf</b>  <b>4.17 UNYT IT Support Services, Eng.pdf</b>  <b>4.18 UNYT ProProof e-Exam Platform Invoice.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Profesioni i psikologut dhe programi i studimit i cili i referohet këtij profesioni prezantonë një fushë të shkencës të aplikuar dhe si e tillë ndikimi laboratorik nuk është aq i rëndësishëm sa ndikimi praktik, i cili këshillohet të realizohet nëpërmjet seminareve ose në mënyrë më të drejtpërdrejtë nëpërmjet praktikës profesionale në institucione. Nga analiza e programit mësimor rezulton e përfshirë praktika profesionale, edhe në formën e seminareve edhe në praktikën në institucione. ndërsa për përbushjen e objektivave formues të programit të studimit ofrohet një akses i pakushtëzuar në bibliotekën online dhe gjatë gjithë ditëve të janës, në orarin 08.00-20.00 biblioteka fizike e cila ka një gamë të gjërë titujsh specifik mbi psikologjinë në shqip dhe anglisht. Në mjediset e tjera të institucionit ka pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore, siç është klubi i psikologjisë, ku vetëm me anë të një kërkesë krijohen kushtet për realizimin e aktiviteteve të ndryshme studentore. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovozove, ë, kamera, interenti apo edhe dërrasat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit punonjës social.</p> <p><b>4.2 UNYT Event Form E-mail.JPG</b>  <b>4.2.1 UNYT Event Request Form Psychology Club.pdf</b></p>

	<b>4.9 UNYT Records Office Rules and Regulations, Alb.pdf</b> <b>4.12 UNYT Space and Facilities (1).pdf</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili ishte i pajisur me programet profesionale. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sër aplikacionesh dhe programesh teknologjike si Turnitin, SPSS, Jetstore, ESC apo dhe Office 365.  <b>4.2 UNYT Event Form E-mail.JPG</b> <b>4.9 UNYT Records Office Rules and Regulations, Alb.pdf</b> <b>4.14 UNYT Manual of Information Security, Alb.pdf</b> <b>4.15 UNYT Software Installation Policy, Alb.pdf</b> <b>4.16 UNYT IT Data protection Policy, Eng.pdf</b> <b>4.17 UNYT IT Support Services, Eng.pdf</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkluton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe fushës së studimit në punë sociale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Funksioni bibliotekës së këtij institucioni është i rregulluar dhe funksionon sipas përcaktimeve në statusin e universitetit (neni53) dhe në rregulloren e Universitetit (neni51). Referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës UNYT, ajo ka një fond fizik prej më shumë se 180 tekste të përshtatshme me programin specifik të psikologut. Gjithashtu anëtarësimi në libraritë online JSTOR dhe EMERALD garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, në gjuhën angleze, e cila është gjuhë e detyruar për programin Bachelor “Psikologji” në këtë universitet.  Evidentohet se literatura është kryesisht në anglisht, por gjenden dhe një mori titujsh në shqip, gjë e cila konsiderohet e plotësisht e përshtatshme për studentët. Nga vizita në institucion rezulton se numri i titujve në fushën e psikologjisë në bibliotekën e universitetit është e përshtatshme.  Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online <a href="https://library.unyt.edu.al/">https://library.unyt.edu.al/</a> . Bazuar në kërkesat e personelit akademik

	<p>fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>4.1 UNYT Lista e Literatures.pdf</b>  <b>2.37 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB.pdf, Tabela 16, Tabela 17</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në raportin e saj GVJ raportin se UNYT ka një linjë të veçantë financimi për bibliotekën, buxhet i cili është ndërmjet vlerave 15.00-20.200, por nuk ka specifikim për titujt apo për fondin dedikuar programit “Psikologji”. GVJ nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë për ta verifikuar procedurën se si njësia përgjegjëse garanton përditësime të literaturës dhe përzgjedhjen e botimeve të viteve të fundit mbi psikologjinë.</p> <p><i>GVJ sygjeron që në rregulloren dhe në politikat e Institucionit të përcaktohen procedurat për përditësimet e literaturës dhe aksesimin e saj nga studentët e programit psikologj.</i></p> <p><b>4.19 UNYT Library Policy and Procedures.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një bibliotekë qendrore në ambientet e saj, e cila u vizitua nga GVJ, gjatë vizitës së saj në Institucion. Biblioteka ishte me 2 ambiente, një për studimin e librave fizik dhe një mjedis për shfrytëzimin e bibliotekës on-line. GVJ konfirmoi që ambienti ishte i përshtatshëm me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Fondi i librave është i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët. Studentët kanë të drejtë të huazojnë libra dhe të përdorin shërbimet e bibliotekës si gjatë javësh, ashtu edhe gjatë fundjavës. Orarat për ditët e javës janë 9.00-21.30, të shtunën 9.00-17.00 dhe të dielën 9.00-18.00</p> <p>Biblioteka është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. Gjithashtu nga studentët e programit psikologji shfrytëzohet edhe për aktivitete ekstrakurrikulare.</p> <p><b>4.19 UNYT Library Policy and Procedures.pdf</b>  <b>2.7.4 UNYT Book lovers_Kleita Vaso.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar fondit të librave sipas evidencave të prezantuara ai është mose i mjaftueshëm duke ju referuar këtu edhe listës së bibliotekës online, dhe gjykojmë për një fond fizik të mjaftueshëm e të përshtatshëm për modulet e programit psikologji. Biblioteka vepron mbi një sistem shërbimi automatik dhe bashkëkohor, siç është sistemi LibrarySoft dhe organizimi i punës dhe ndarja dhe kategorizimi, katalogimi dhe koleksionimi bazohet në klasifikimin e bibliotekës së kongresit. Nga konsultimi i listave të fondit të librave në shqip, të vëna në dispozicion gjatë vizitës në institucion ka shumë libra të nevojshme dhe shumë të lidhura me programin e studimit psikologji. Nga takimi me studentët ata na konfirmuan se literatura e detyrueshme e lëndës, por dhe materiale të tjera shtesë ju viheshin në dispozicion nëpërmjet platformave dixhitale të ndërveprimit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 55




	<p><b>2.37 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB.pdf, Tabela 17</b></p> <p><b>4.19 UNYT Library Policy and Procedures.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>NYUT ka krijuar të gjithë kushtet për shfrytëzimin e barabartë e pa pagesë për studentët dhe stafin akademik në bibliotekat online, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme në të gjithë mjediset e institucionit. Abonimet online të këtij institucioni mundësojnë qasje në literaturën bashkëkohore të fushës së psikologjisë, dhe duke qënë se mësimi në këtë universitet është në gjuhën angleze nuk ka kufizime mbi gjuhën e literaturës. IAL vë në dispozicion të studentëve edhe një katalog elektronik <a href="https://library.unyt.edu.al/">https://library.unyt.edu.al/</a> i cili është lehtësisht i aksesueshëm. Lista e E-Books/Journals and Databases e aksesueshme nga faja kryesore e universiteti nëpërmjet adresës <a href="https://unyt.edu.al/index.php/facilities/">https://unyt.edu.al/index.php/facilities/</a> është: Jstore, World Bank, Cambridge Journals Online, Emerald, E-Library [World Bank], WDI [World Development Indicators], GDF [Global Development Finance], WOERC [World Open Educational Resources Congress], Search for a Book [UNYT Library Database], McGraë Hill e-Library [The McGraw Hill Online Library] dhe Empire State College [Empire State College Online Library].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Aktualisht biblioteka është e organizuar në 2 mjedise, ku përveç mjedisit për përdorim të fondit fizik, gjendet dhe mjedisi me 12 kompjutera dhe me pajisje elektronike dhe akses në internet wireles, e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online. gjithashtu priteri i vënë në dispozicion të studentëve ju mundëson printim të drejtpërdrejtë të materialeve online. Fondi i bibliotekës është i gjithi digjitalizuar dhe abonimi në disa nga libraritë më të njohura online mundëson shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe stafin akademik. Në këtë universitet studentët mund të konsultojnë gjithashtu personelin e saj nëpërmjet Contact us: <a href="mailto:library@unyt.edu.al">library@unyt.edu.al</a></p> <p><b>4.13 UNYT Library Facilities.pdf</b></p> <p><b>4.19 UNYT Library Policy and Procedures.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e këtij universiteti ofron orare shërbimi si gjatë javës, por edhe në fundjave, duke iu përgjigjur nevojave, kërkesave si dhe duke ju përshtatur maksimalisht ritmit studentor. Oraret e punës së bibliotekës gjenden të publikuara në faqen <a href="https://unyt.edu.al/index.php/facilities/">https://unyt.edu.al/index.php/facilities/</a>. Të gjithë të interesuarit mundet gjithashtu që të vihen në kontakt me punonjësit e bibliotekës dhe të kërkojnë shërbime dhe infoemacione edhe më të specializuar në Contact us: <a href="mailto:library@unyt.edu.al">library@unyt.edu.al</a></p> <p>Orarat për ditët e javës janë 9.00-21.30, të shtunën 9.00-17.00 dhe të dielën 9.00-18.00</p> <p>GVB gjatë vizitës në institucion konfirmon se oraret e shërbimit të Bibliotekës janë të afishuara në hyrje të saj.</p> <p><b>4.13 UNYT Library Facilities.pdf</b></p> <p><b>4.19 UNYT Library Policy and Procedures.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit</p>	<p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL nuk gjendet ndonjë raport nga vetë biblioteka apo nga njësitë përgjegjëse të programit "Psikologji" mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 56



<p>fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në raportin e GVB gjenden të dhëna mbi shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët, shfrytëzimi i sallave të studimit, por jo specifikisht nga studentët e programit “Psikologji”.</p> <p>GVJ sygjeron që në analizat e punës së Departamentit të merret në konsideratë është mënyra e përzgjedhjes së titujve të rinj për përditësimin e binliotekës si dhe të analizohet efektshmëria e pasurimit të fondit fizik dhe atij online, për programin “Psikologji”, duke evidentuar edhe kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p> <p><i>Nuk gjenden raporte të tjera analitike mbi efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online.</i></p> <p><b>4.19 UNYT Library Policy and Procedures.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se programi i studimit “psikologji” vë në përdorim të studentëve dhe të stafit akademik literaturën e nevojshme, të përditësuar e cila lehtëson procesim mësimdhënës. Gjithatë edhe dhe mjediset dhe programet dixhitale të përdorimit të bibliotekës online janë lehtësht të përdorshme. Për të matur dhe vlerësuar efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online GVJ sygjeron që të krijohet një praktikë në departament për vlerësimin e përzgjedhjes së titujve të rinj të librave dhe analizën e efektshmërisë së tyre, për të garantuar një literaturë sa më ndihmuese për performancën.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit institucioni përdor sistemin GNOMON, i cili është një platformë elektronike nëpërmjet të cilës krijohen, ruhen, përditësohen dhe fshihen të dhëna për studentët e regjistruar në këtë universitet. Në këtë program departamentet ndihmëse (sekretari, financë, etj) kanë akses të limituar sipas profilizimit të informacionit. Edhe vetë studentët në rregulloren e universitetit (neni 64) informohen edhe për administrimin e kartelës së studentit, apo dhe të drejtat dhe përgjegjësitë (neni 71 dhe 72).</p> <p>Sistemi është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Çdo student regjistrohet në këtë universitet nëpërmjet portalit U-Albania, ku ati për sistemin e brendshëm</p>




	<p>të menaxhimit të informacionit konsiderohet kandidat student dhe më tej nëpërmjet Zyrës së Çështjeve të Studentëve dhe Zyrës së Financën ai finalizon regjistrimin në sistemin GNOMON, duke marrë kredencialet e plota. Nëpërmjet këtij sistemi studentët mund të aksesojë në llogarinë personale të tij të dhënat akademike dhe të dhëna të tjera sensitive, siç janë ato financiare, po ashtu dhe stafi akademik ka akses vetëm në të dhënat akademike, duke ofruar mundësi përdorni të dhënash vetëm për përmbushjen e funksioneve.</p> <p>Sistemi ofron informacione të ndryshme për vijueshmërinë e vitit aktual akademik.</p> <p><b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>4.23 UNYT Student candidate Gnomon.png</b>  <b>4.20.1 UNYT E-Gnomon student access.png</b>  <b>4.20 UNYT Platforma Gnomon.png</b>  <b>4.20.2 UNYT Gnomon access.png</b>  <b>4.20.3 UNYT Gnomon student search.png</b>  <b>4.20.4 UNYT Individual Student Search.png</b>  <b>4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin.png</b>  <b>4.20.6 UNYT Regjistrimi i Studentit ne kurset e Semestrit.png</b>  <b>4.21 UNYT Access i profesoreve.png</b>  <b>5.4 UNYT Rregullore e Sekretarise Mesimore, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar statutit të universitetit dhe rregullores së tij, administrimi i informacionit menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit.</p> <p>Ky informacion ruhet në formën hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit, siç janë: Departamenti, Fakulteti, Universiteti, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria mësimore dhe një sër Zyrash të tjera të cilat secila sipas funksionit është e mandatuar të menaxhojë, monitorojë, krijoj apo auditoj aktivitete të ndryshme të personelit akademik, ndihmës akademik administrativ apo dhe të tjera veprimtari jashtë universiteti.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>5.4 UNYT Rregullore e Sekretarise Mesimore, Alb.pdf</b></p> <p>Institucioni zbaton me rigorozitet detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që lindin nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 dhe gjithë akteteve të tjera ligjore mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve të sektorit privat.</p> <p>Sistemi GNOMON siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin informatik GNOMON.</p> <p><b>4.29 UNYT Adresa elektronike per secilin student.jpg</b>  <b>4.21 UNYT Access i profesoreve.png</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të</p>	<p>Zyra e IT është përgjegjëse për ruajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në këtë sektor (Statuti, neni 52). Kjo zyrë ofron kredencialet e përdornit të sistemit të menaxhimit për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 58




<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>të gjithë stafin dhe studentët e universtit. Platforma ka të integruara dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve nëpërmjet e-mail, Canvas, McGraw ose drejtpërdrejtë.</p> <p>Konstatohet se sistemi mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve si dhe informimin online. Studentët, pedagogët, por edhe stafi ndihmës akademik mund të identifikohen në sistemin GNOMON duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit kodeve të vëna në dispozicion dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive.</p> <p>Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacion dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me punën, sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës. GVJ nga vizita në institucion dhe takimet me stafin akademik dhe studentët e konfirmuan shkëmbimin në kohë reale të informacioneve dhe të njoftimeve që realizoheshin nëpërmjet sistemeve të menaxhimit dixhital.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>4.20 UNYT Platforma Gnomon.png</b>  <b>4.20.1 UNYT E-Gnomon student access.png</b>  <b>4.20.2 UNYT Gnomon access.png</b>  <b>4.20.3 UNYT Gnomon student search.png</b>  <b>4.21 UNYT Access i profesoreve.png</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit GNOMON siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta. të dhënat me më tepër frekuencë janë listat emërore të studentëve, raportimet statistikore mbi kurset, notat, por dhe të dhëna të tjera si planprogramet dhe frekuentimet. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht gjatë takimit me studentë konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuara sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafin akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. Sistemi i menaxhimit u siguron atyre informacione të përditësuara.</p> <p><b>4.20 UNYT Platforma Gnomon.png</b>  <b>4.20.1 UNYT E-Gnomon student access.png</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja e internetit të UNYT paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentë.</p> <p>Kjo faqe është lehtësisht e aksesueshme <a href="https://unyt.edu.al/#">https://unyt.edu.al/#</a>, dhe programi i studimit “Psikologji”, gjithashtu ka faqen e vet të internetit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/psychology/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/psychology/</a>.</p> <p>Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm në të dy gjuhët (shqip dhe anglisht).</p> <p>Universiteti jep informacion të dedikuar për studentët e tij dhe jetën akademike, por i kushton vëmendje dhe jetës sociale, kulturore dhe zhvillimore rinore nëpërmjet faqes së dedikuar</p>

	<a href="https://unyt.edu.al/index.php/category/student/">https://unyt.edu.al/index.php/category/student/</a>			
	Gjatë vizitës GVJ konstatoi se informacionet e publikuara në faqen e internetit ishin të përdorshme e të nevojshme për studentët.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konfirmon se UNYT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional GNOMON dhe e ka vënë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për të gjithë universitetin, ashtu dhe për programin e studimit "Psikologji".			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ në dokumentacionin e prezantuar në Dosjen e Vetëvlerësimit na informon se institucioni realizon analiza të kosto efektivitetit si dhe disponon pasqyra financiare me të ardhurat dhe shpenzimet (<b>Raporti GBV, fq 44 ku referohet shtojca 4.33, 4.33.1, 4.35</b>), por GVJ nuk gjeti një raport financiar të kostove të njësisë bazë për programin të studimit "Psikologji". Në DVV gjenden të dhëna mbi financimet e universitetit, (jo në mënyrë specifike për programin e studimit "Psikologji), ku rezultoi se:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Të ardhurat nga:</th> <th>Viti 2019</th> <th>Viti 2020</th> <th>Viti 2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Grantet për kërkimin dhe kontratat</td> <td>11,615,328</td> <td>7,787,558</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Tarifa për dhe gjatë shkollimit</td> <td>275,042,210</td> <td>242,558,806</td> <td>209,059,738</td> </tr> <tr> <td>Aktivite tregëtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)</td> <td></td> <td></td> <td>18,418</td> </tr> <tr> <td><b>Shuma</b></td> <td><b>286,657,539</b></td> <td><b>250,346,364</b></td> <td><b>209,078,156</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që drejtoria ekonomike ka mundësi të nxjerrë konstat për çdo njësi bazë pasi disponon të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>Nuk gjenden të dhëna mbi zërat të cilat financohen nga a-Buxheti i shtetit (Granti për mësimdhënie; Granti konkurrues; Granti për kërkimin shkencor); b-Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi. c-Të ardhurat e vetë institucionit (Pagesat e studentëve për arsimim; Financimet nga Fondacioni; Të</p>	Të ardhurat nga:	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Grantet për kërkimin dhe kontratat	11,615,328	7,787,558		Tarifa për dhe gjatë shkollimit	275,042,210	242,558,806	209,059,738	Aktivite tregëtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)			18,418	<b>Shuma</b>	<b>286,657,539</b>	<b>250,346,364</b>	<b>209,078,156</b>
Të ardhurat nga:	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021																		
Grantet për kërkimin dhe kontratat	11,615,328	7,787,558																			
Tarifa për dhe gjatë shkollimit	275,042,210	242,558,806	209,059,738																		
Aktivite tregëtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)			18,418																		
<b>Shuma</b>	<b>286,657,539</b>	<b>250,346,364</b>	<b>209,078,156</b>																		

	<p>ardhurat për shërbimet e kryera; Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta), të paktën një cikël të plotë studimi</p> <p><i>Nuk u evidentuan raporte financiare të kostove të Departamentit për programin e studimit "Psikologji" dhe as planet për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për një cikël të plotë studimi; edhe pse jemi në vitin e fundit të ciklit të studimit.</i></p> <p><b>2.37 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB.pdf Tabela 18</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit nuk gjendet plani i dedikuar financimit të programit "Psikologji", as ai i njësisë bazë. Institucioni në raportin e hartuar nga ai vetë evidenton Procedurën e Buxhetimit dhe komunikimin për buxhetimin (shtojcat 4.31, 4.31.1, 4.34, 4.35) por asnjë nga këto dokumenta nuk u arrit të gjendej në Dosjen e Vetëvlerësimit. Kriteri kërkon që të ketë një plan financimi nga njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit "Psikologji" me të dhënat specifike mbi financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë; GVJ nuk gjeti as planin e financimit dhe as informacionet e nevojshme.</p> <p>Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit "Psikologji" do të këshillojmë që njësisë bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësisë bazë, sipas frymës së ligjit.</p> <p><i>Nuk u evidentuan planet e financimit të Departamentit për programin e studimit "Psikologji" me të dhënat përkatëse financiare në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><b>2.37 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB.pdf Tabela 18</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në raportin e saj GVB na informon mbi realizimin e dy auditimeve, të brendshme dhe të jashtme, por në dokumentacionin i cili është pjesë e Dosjes së Vetëvlerësimit mungojnë raportet audituese (shtojca 4.30, 4.33, 4.33.1)</p> <p><i>Nuk u evidentuan raporte auditimi mbi gjendjen e financimit apo mbi efektivitetin financiar.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nuk u evidentuan të dhëna mbi fatin nëse ka raportime mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës, dhe as të dhëna mbi mënyrën se si bëhet raportimi. Edhe evidencat e pretenduara nga institucioni mbi këtë kritet mungojnë. (shtojca 4.33, 4.33.1)</p> <p><i>Nuk u evidentuan raporte specifike mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës për programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e</p>	<p><i>Institucioni deklaron mbështetjen e vazhdueshme, sidomos në vitet e fundit nga Fondacioni, i cili i ka dhënë siguri për zhvillimin e programeve të studimit dhe sigurisht për atë "Psikologji", por evidencat të cilat duhet të mbështesin këtë</i></p>

<p>programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p><i>kriter mungojë. Ndaj për GVJ-në është e pamundur të konkludojë për garancinë mbi ecurinë normale të këtij programi.</i></p> <p><i>Mungojnë të dhënat për koston e studimit në këtë program, mbi bazën e të cilave të sigurohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria për këtë program. Edhe mundësitë për përmirësimin e situatës dhe të nevojzve financiare të programit nuk mund të mbështeteiten në evidenca nga njësia bazë. Mungojnë gjithashtu planet konkrete për ndërhyrje të posaçme mbi mundësitë e diversifikimit të financimit të programit.</i></p> <p><i>Mbështetja financiare dhe garantimi qëndrueshëm i mbështetjes vlerësojmë të jetë shumë i rëndësishëm, veçanërisht përsa i përket numrit të ulët të studentëve të këtij programi, dhe kërkesës në rritje për përfishirjen në këtë program të stafit akademik në drejtimin psikologji dhe më arritje sa më të larta akademike për të garantuar edhe cilësisë në formimin akademik të studentëve.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Duke iu referuar këtij standardi përgjithësisht nuk kemi një përbushje të kriterve, kryesisht nw garantimin financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, dhe për sa më sipër vlerësohet se ky standard <b>nuk përbushet.</b></i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
			<p>X</p>	

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>




## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UNYT ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Veçori e këtij universiteti për programin bachelor është dhe mbrojtja e gjuhës angleze, pasi mësimi zhvillohet në këtë gjuhë. Edhe këtë vit ashtu si dhe çdo vit Senati miraton kalendarin për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në këtë institucion, kjo edhe referuar nenit 62 të rregullores mbi kushtet e pranimit, regjistrimit dhe matrikullimit të studentëve. Në nenin 69 të të njëjtës rregullore përcaktohen mënyra e pezullimit dhe rifillimit të studimeve. Pra aktet rregullatore të institucionit rregullojnë statusin e student nga hyrja dhe regjistrimi në institucion deri te diplomimi. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për regjistrimet në këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së miratuara nga MAS nëpërmjet sistemit U-Albania sipas kalendarit të miratuar nga RASH. Me regjistrimin dhe fitimin e statusit studenta ata pajisen me kartën e studentit!</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me vetë studentët dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UNYT nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Respektohen detyrimet ligjore mbi regjistrimin, dhe trajtimin e drejtë e të barabartë të kandidatëve për studentë, me një procedurë transparente, por dhe të vetë studentëve. Studentët gëzojnë të drejtën e ankimit për të gjithë rastet që ata pretendojnë se ka shkelje të të drejtave dhe këtë mund të bëjnë lehtësisht edhe nëpërmjet formularit mbi ankimimin <a href="https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/">https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/</a> , i cili është online.</p> <p>Ky universitet është kujdesur që të jetë miqësor dhe lehtësisht i aksesueshëm edhe për studentët (dhe jo vetëm) të cilët kanë nevoja të veçanta duke lehtësuar rrugëkalimet por dhe duke nxitur dhe mundësuar një jedis multikulturor dhe të gjithëpranueshëm, kjo falë dhe numrit të lartë të studentëve të cilët vijnë nga shtete të tjera.</p> <p>Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në nenin 71 “Të drejtat e studentëve”; në nenin 74 “Liritë e anëtarësimit”; nenin 75 “Pjesëmarrja e studentëve në qeverisjen akademike” të Rregullores së universtetit, por</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 63

	<p>dhe në shumë nene të tjera të cilët rregullojnë aspekte të veçanta të të drejtave të studenëve. Në nenin 60 të statutit rregullohet ngrita dhe funksionimi i Qendrës së Këshillimit të Studentëve, e cila ndërmjet të tjerave ndihmon në krijimin e një mjedisi universitar të favorshëm për zhvillimin e qëndryshëm akademik e personal të studentëve.</p> <p><b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>3.4 UNYT Rules and Regulations Academic Support Center and Counselling Center, Alb.pdf</b>  <b>4.7 UNYT Code of Ethics.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni bashkëpunon me QSHA-në në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse dhe miraton renditjen e studentëve të cilët kanë aplikuar për programin e studimit "Psikologji". Për shkak se institucioni është pjesë e një rrjeti shumë të gjërë universitetesh dhe kolegjeshtë të huaja ai mundëson edhe pranime apo transferime të studentëve të huaj, dhe në nenin 65 të Statutit evidentohet mënyra e ngrites së komisionit <i>Ad-Hoc</i>, në nivel Departamenti i pranimeve dhe transferimeve; edhe në nenin 68 të Rregullores së Universitetit evidentohet puna e këtij komisioni në nivel Departamenti.</p> <p>GVB na informon për vendim Senali nr.89, datë 27.01.2023 mbi kriteret e pranimit, por vendimi nuk u arrit të gjendet në dokumentacionin bashkëshoqërues të aplikimit dhe as në faqen web të UNYT edhe pse publikimi i tyre është një kriter dhe tregues transparence.</p> <p><i>GVJ nuk konfirmon dot kohën dhe mënyrën se si hartohen kriteret për pranimet në programin "Psikologji", nëse janë hartuar përpara fillimit të vitit akademik dhe janë publikuar në faqen web të UNYT.</i></p> <p><i>GVJ sygjeron që kuadri rregullator mbi pranimet, transferimet apo dhe proceset e tjera të punës të cilët lidhen drejtpërdrejt me programin "Psikologji" dhe me studentët të jenë pjesë e rregullores së Departamentiit dhe të programit, dhe këto të jenë të publikuara në faqen eeb të UNYT.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ mbështetur në studimin e faqes web të UNYT, dhe konkretisht në <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/</a> konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe janë transparente, lehtësisht të aksesueshme nga publiku dhe të kuptueshme (Statuti, Kapitulli i Nëntë "Studentët dhe të Dhënat mbi Studentët").</p> <p>Edhe procedurat për përparimin e studentëve janë të kuptueshme edhe nga informacionet online edhe informacionet specifike që ju vihen në dispozicion nga titullarët, kjo e konfirmuar edhe nga vizita në institucion, gjithashtu aka kanë informacione mbi kalendarin e organizimit të vitit akademik edhe me sezonet përkatëse të provimit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/">https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/</a>.</p>






	<p>Edhe procedurat e transferimit (info në web <a href="https://unyt.edu.al/index.php/transfer/">https://unyt.edu.al/index.php/transfer/</a> ), njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe ato të diplomimit (neni 70) janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit dhe në Statutin e tij (Kapitulli i Nëntë). Gjendet gjithashtu në ëeb edhe informacion i detajuar mbi dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes që qëndrimin të studentët e huaj <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/documents-needed-for-resident-permit/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/documents-needed-for-resident-permit/</a></p> <p>Nga vizita në Sekretarinë Mësimore amë nga afër edhe procedurën e çregjistrimit të studentëve në programin BA “Psikologji”:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti 2020-2021 – 9 studentë; 1 çregjistrim (2 nga trojet)</li> <li>- Viti 2021-2022 – 11 studentë; 1 çregjistrim</li> <li>- Viti 2022-2023 – 12 studentë; 1 çregjistrim</li> </ul> <p>Të gjitha informacionet e referuara për pranimin, procedurat dhe dokumentat e regjistrimit, tarifat, bursat dhe transferimin e studimeve janë të publikuara në faqen e internetit; si dhe gjenden të sanksionuara edhe në Aktet ligjore e nënligjore gjithashtu të publikuara në faqen ëeb të UNYT.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit.pdf</b>  <b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.pdf</b>  <b>1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Psikologji.pdf</b>  <b>4.7 UNYT Code of Ethics.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL konfirmoi se organizimi i ditëve të informimit për maturanët e shkollave të mesme realizohej konform një plani dhe në faqen ëeb kishte edhe një hapësirë dedikuar ditëve të informimit dhe kalendarit përkatës të takimeve me maturanët dhe në faqen ëeb gjenden dhe tarifat e shkollimit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/tuition-fees/">https://unyt.edu.al/index.php/tuition-fees/</a></p> <p>Gjithashtu maturanët mund të shfaqin interes për programet e studimit edhe nëpërmjet faqes <a href="https://unyt.edu.al/index.php/apply-online/">https://unyt.edu.al/index.php/apply-online/</a> ose dhe ftohen në kampus dhe marrin informacion të detajuar për fakultetin dhe për programe specifike të studimit, edhe për programin Bachelor “Psikologji”. UNYT përdort të gjithë linjat dhe kanalet e komunikimit për informimin e publikut dhe të të interesuarve brenda dhe jashtë vendi, në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimin dhe kërkesat për t'u regjistruar.</p> <p>Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet. Kriteret dhe kërkesat publikohen në faqen e internetit të Universitetit. <a href="https://unyt.edu.al/#">https://unyt.edu.al/#</a></p> <p>UNYT është një institucion privat i arsimit të lartë por ai është gjithashtu pjesë e një rrjeti shumë të konsoliduar baskëunëtorësh nga të cilët ka mundësuar dhe ofrimin e bursave të studimit të cilat sipas një politike dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 65




	<p>sipas kritereve iu akordoheshin studentëve. Nga takimi me studentët ata na konfirmuar se në % të caktuara (10%-100%) gati të gjithë të pranishmit në takimin ishin mbajtës burse dhe për këtë ka dhe raportime periodike.</p> <p><b>5.21 UNYT YTB Raporti per Studente 2021-2022.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pjesë e vendimit UNYT është dhe vëmendësimi mbi kuotat e veçanta dhe kriteret përkatëse mbi përzgjedhjen e kandidatëve aplikantë të cilët vijnë nga kategori të veçanta, pakicat kombëtare apo dhe shtresat e marginalizuara, dhe për këtë aplikohen të njëjta kritere si ato të përcaktuara nga Ministria e Arsimit në Udhëzimin nr.17, datë 30.07.2019. Institucioni favorizon dhe përkrah me bursa deri në masën 100 % studentët ekselentë me anë të konkursit për burat, konkurs i cili publikohet me anë të të gjithë mejteve të komunikimit që institucioni ka në dispozicion dhe informacioni mbi të gjendet dhe në faqen eeb të universitetit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/scholarship-policy/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/scholarship-policy/</a>. Gjithashtu edhe informacioni mbi procedurat e pranimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci specifikisht gjenden edhe në adresën elektronike <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/</a></p> <p><b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2020-2021.pdf</b>  <b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2021-2022.pdf</b>  <b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2022-2023.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Çdo vit nxirret një Urdhër i Përbashkët i Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar në të cilën miratohet kalendari i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në IAL-të për vitin përkatës, në të cilën kudes i tregohet dhe kandidatëve nga trojet dhe atyre me diplomë të huaj të shkollës së mesme, të cilin UNYT Tirana ndjek dhe zbaton dhe aktualisht në programin “PSikologji” studiojnë studentë nga trojet (2 studentë oër vitin akademik 2020-2021)</p> <p>UNYT në faqen e vet të web <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/</a> ka publikuar edhe procedurat për pranimet e studentëve ndërkombëtarë si dhe dokumentacionin përkatës të cilin aplikantët duhet të dorëzojnë për të përfunduar procesin e aplikimit. Sigurisht që e gjithë procedura është konform udhëzimeve të MAS dhe kriteret i dërgohen për dijeni edhe QSHA-së dhe portalit U-Albania <a href="https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=36">https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=36</a> . Në këtë universitet studiojnë shumë student të huaj, dhe në programin “Psikologji” studiojnë gjithashtu studentë të huaj të cilët ose janë transferuar ose janë pjesë e mobiliteteve studentire të programeve e projekteve të aplikuara në këtë univeritet. Gjuha e huaj e studimit të këtë program dhe mjedisi mikpritës favorizojnë lehtësimin e lëvizjes së studentëve.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u njoh nga afër edhe me dokumentacionin shoqërues të një studenti të huaj.</p> <p><b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2020-2021.pdf</b></p>




	<p><b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2021-2022.pdf</b>  <b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2022-2023.pdf</b></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në web e UNYT <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/scholarship-policy/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/scholarship-policy/</a>, por dhe në dokumentacionin bashkëshoqërues të vënë në dispozicion të GVJ informohemi mbi lloje të ndryshme të bursave që Universiteti i Nju Jorkut Tirana ofron si</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bursat e provimit të bursave deri në 100%</li> <li>- Bursat e mesatares së shkollës së mesme deri në 100%</li> <li>- Bursat për arritje të veçanta për studentë të suksesshëm në art, sport dhe shkencë deri në 100%</li> <li>- Bursat për vëllezërit e motrat, bursat e stafit, bursat për të diplomuarit, bursat e projekteve, bursat e studentëve në vazhdim, bursat për studentët e transferuar dhe lloje të ndryshme zbritjesh.</li> </ul> <p>Për studentët të cilët i përkisnin shtresave në nevojë të shoqërisë, specifikisht statusit PAK, Jetimë, apo të familjeve të cilat vijnë nga Skema e Ndihmës Ekonomike nuk kishte politika specifike të ndihmës. Në rregulloren e programit të studimit ka një seksion (fq.11) i cili përcakton tarifat e shkollimit dhe bursat.</p> <p><b>1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Psikologji.pdf, Sesioni D.</b>  <b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2020-2021.pdf</b>  <b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2021-2022.pdf</b>  <b>5.5 UNYT Politika e Bursave 2022-2023.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ ndjek dhe zbaton politika të qarta e transparente mbi procedurat e pranimit, përzgjedhjes dhe përparimit të studentëve të programit "Psikologji". Gjithashtu edhe transferimi i studimeve, njohja e studimeve në një program tjetër vlerësimi i dijeve dhe diplomimi ishin procedura të njohura dhe transparente për këtë program studimi. Universiteti i Nju Jorkut Tirana (UNYT) i themelur që në vitin 2002 si universiteti i parë privat në Shqipëri mund të shohë mundësinë e konsiderimit të këtij programi studimi si një program me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit, duke mundësuar edhe hartimin e politikave të ndihmës apo të mbështetjes me bursa për studentët e shtresave në nevojë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 67

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit, në rregulloren e fakultetit dhe më specifikisht në rregulloren e programit të studimit. Në faqen web dhe në aktet rregullative të universitetit gjendet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, detyrimet akademike të çdo viti dhe informacione mbi kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Sesioni F i rregullores së programit përcakton detyrimet e studentit mbi llojin e lëndëve që duhet të marrë një një semestër, limitin minimal dhe maksimal të krediteve, mënyrën e regjistrimit të lëndëve, lëndët verore dhe fazën e diplomimit (neni 30).</p> <p>Për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës dhe studimit të studentëve të UNYT-së, për të monitoruar përparimin e studentëve, pas regjistrimit, studentëve u caktohet një këshilltar fakulteti i cili është i ngarkuar të mbështesë këshilltarët e tij/saj gjatë studimeve të tyre. <a href="https://unyt.edu.al/index.php/academic-support-center/">https://unyt.edu.al/index.php/academic-support-center/</a></p> <p>GVJ konfirmion se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.</p> <p><b>1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Psikologji.pdf</b>  <b>4.20.2 UNYT Gnomon access.png</b>  <b>4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin.png</b>  <b>5.23 UNYT List of Advisers.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Zyra e çështjeve Studentore (SAO) (neni 46 i Rregullores së UNYT) nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me studentët ju ofton atyre jo vetëm informacion mbi kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, por i asiston ata dhe për procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit. Këto procedura mund të aksesohen nga studentët në faqen e institucionit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/transfer/">https://unyt.edu.al/index.php/transfer/</a></p> <p>Vlerësimi për të përcaktuar dhënien e krediteve të transferimit të Universitetit është një proces shumëfaktorial i drejtuar fillimisht nga një vlerësim i burimit institucional dhe cilësisë arsimore të punës së kursit siç dëshmohet nga akreditimi kombëtar, rajonal ose profesional i mbajtur nga institucioni fillestar. Duke qenë se një kurs transferues është përcaktuar të jetë i përshtatshëm për vlerësim sipas standardeve dhe duke pasur parasysh se një student ka demonstruar performancë të pranueshme në kurs, kriteret në lidhje me natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe krahasueshmërinë e kursit do të zbatohen për të përcaktuar pranueshmërinë e kursit për kreditimin e transferimit të Universitetit. Në nenin 48 të Rregullores së programit të studimit përcaktohet dhe mënyra e marrjes së lëndëve nga universtete të tjera ku një faktor i rëndësishëm për vlerësimin me notë të studentit për një lëndë të kryer jashtë UNYT është Zyra e Marrëdhënieve me jashtë dhe miratimi i këshilluesit akademik, pas vendimit të Këshillit të Fakultetit, por specifikisht si mund të aplikohet kjo për programin “Psikologji” nuk ka rregulla të</p>




	<p>formalizuara. Këshillohet edhe miratimi i rregullore së organizimit dhe funksionimit të komisionit <i>ad-hoc</i>.</p> <p>Në nenin 65 të Statusit të universitetit informohemi për Komisionin e Pranimeve dhe Transferimeve i cili operon në nivel Departamenti, i cili është komision <i>Ad-Hoc</i> i cili është një hallkë shumë e rëndësishme e vendimmarrjes mbi transferimet, por në rregulloren e Departamentit në nenin 8 të saj “Pranimi i studentëve të transferuar” dhe në nenin 9 “Procedura e Komisionit për transferimin e studentëve”, informohemi mbi komisionin në nivel departamenti <i>ad-hoc</i>, por jo për numrin e anëtarëve të tij dhe procedurën e emërimit nga Këshilli i Fakultetit. Informohemi nga kuadri rregullator se kërkesa e studentëve për transferim kreditesh rishikohet nga komisioni <i>ad-hoc</i> dhe aprovohet nga dekani përkatës, por nuk asnjë të dhënë specifike për vendimmarren,</p> <p><i>GVB mendon se nëse është në nivel departamenti duhet të jetë përgjegjësi e përgjegjësit të departamentit organizimi i këtij komisioni dhe udhëzimet të cilat përcaktojnë procedurat engritjes dhe funksionit të tij duhet gjithashtu të jene specifike për këtë program studimi. GVB sygjeron që ky komision të marre vëmendje të shtuar rregullative në rregulloren e departamentit dhe të specifikohen kriteret për transferim.</i></p> <p><i>Përsa i përket procesit të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, njohur ndryshe edhe si procesi i ekuivalentimit sygjerojmë që institucioni të ketë të evidentuar gjithashtu dhe kriteret e procedurat e njohjeve specifikisht për programin “Psikologji”.</i></p> <p><b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit te Psikologjise.pdf</b>  <b>5.22.1 UNYT Shkembim Stafi - Granada.pdf</b>  <b>5.31 UNYT Incoming Students Aydanur Harmanci.pdf</b>  <b>5.31 UNYT Incoming Students Hatice Balkan.pdf</b>  <b>5.9 UNYT Email komunikimi IRO.pdf</b>  <b>1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Psikologji.pdf</b>  <b>1.15 UNYT TRANSFER EVALUATION FORM - Kristi Shehu.pdf</b>  <b>1.15.1 UNYT Transfer Proposal Alesia Mato.pdf</b>  <b>1.15.2 UNYT Transfer Proposal Kristi Shehu.pdf</b>  <b>1.15.3 UNYT Transfer Proposal Artemida Ceca.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes në mësim, vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloren e Departamentit të Psikologjisë, në sesionin D. Neni 23 “Provimet”, pika e. vlerësimi për secilë lëndë bëhet sipas raportit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 40 % vlerësimi përfundimtar</li> <li>- 30% provimi i ndërmjetëm</li> <li>- 20 % komponentë të jerë</li> <li>- 10 % pjesëmarrje aktive.</li> </ul>




	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive gjithashtu gjendet edhe në aktet e tjera rregullatime të studimeve në UNYT si dhe në syllabusin e çdo lënde ku studentët njihen edhe me mënyrën specifike të vlerësimit në çdo lëndë.</p> <p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që me regjistrimin në universitet studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Ky informim është i vijueshëm edhe gjatë lëndëve të veçanta, gjithashtu ata konfirmojnë se edhe procesi i adresimit të shqetësimeve të ndryshme mbi vlerësimin ishte shumë i qartë për ta dhe mënyra e ankimimit mbi vlerësimin ishte gjithashtu lehtësisht e aksesueshme</p> <p><b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit të Psikologjise.pdf</b>  <b>1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Psikologji.pdf</b>  <b>6.4.2 Programi i lendes.pdf</b>  <b>3.1 UNYT Instructor's Handbook_ALB.pdf</b>  <b>6.4.3 UNYT Exam.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në të gjithë kuadron rregullator të UNYT.. Për të mbështetur studentët, institucioni ka përgatitur një udhëzues specifik mbi procesin e punimit të diplomës dhe një udhëzues për provimin përfundimtar si një rregullore të posaçme (Evidenca 3.11).</p> <p>Në rregulloren e Departamentit, në neni 30 (Faza e Diplomimit), në atë të programit evidentohen kushtet kur ndodh diplomimi dhe sigurisht që i gjithë informacioni ju është vënë në dispozicion studentëve dhe ata ishin në dijeni të mënyrës së diplomimit, kjo e konfirmuar edhe nga takimi i realizuar ndërmjet tyre dhe GVJ-së.</p> <p><b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit.pdf</b>  <b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit të Psikologjise.pdf</b>  <b>1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Psikologji.pdf</b>  <b>3.1 UNYT Instructor's Handbook_ALB.pdf</b>  <b>3.12 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës, Alb.pdf</b>  <b>3.11 UNYT Graduation Project Regulation.pdf</b>  <b>2.2.1 UNYT Evidence e komunikimit me ane të emailit të dergimit të sillabeve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike UNYT publikon në faqen e vet ëeb të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët e ardhshëm, duke ju dedikuar një adresë të posaçme studentëve të huaj <a href="https://unyt.edu.al/index.php/international-relations-office/">https://unyt.edu.al/index.php/international-relations-office/</a> dhe pastaj gjithashtu edhe për studentët e tjerë ka në kalendar të dedikuar aktivitetëve promovuese e informuese.</p> <p>Në web e këtij universteti ka informacione të plota për të gjithë mundësitë e studimit ose dhe të punësimit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/unyt-media/">https://unyt.edu.al/index.php/unyt-media/</a></p>




	<p>si dhe gjenden broshura e fletë infomative, të cilat përveçse hard copy gjenden dhe online.</p> <p>Universiteti mban lidhje me studentët dhe për më tepër ai organizon edhe konkursin e bursave, ku aka kanë mundësi të informohen paraprakisht për programin “Psikologji”.</p> <p>Zyra e çështjeve studentore është përgjegjëse për gjithë këtë proces dhe ajo mund të kontaktohet lehtësisht nga çdo i interesuar nëpërmjet <a href="https://unyt.edu.al/index.php/student-affairs-office/">https://unyt.edu.al/index.php/student-affairs-office/</a></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konfirmon se UNIYT ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit psikolog të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në diplomim, sygjerohet që të qartësohen dhe të standardizohen procedurat e ekuivalentimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe tipologjinë e diplomave (pasi ky universitet ofron mundësinë edhe të diplomimit nga universitete të huaja duke marrë edhe American Bachelor’s Degree nga Empire State College bachelor’s degree) kohëzgjatjen e programit të studimeve, listën e programeve dhe të lëndëve, tarifat e studimit, si dhe parakushtet e lëndëve gjenden në faqen eeb të universitetit për programin Psikologji (<a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/psychology/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/psychology/</a> ). Gjithashtu ata mund të marrin një kopje hard të dosjes së programit pranë zyrave të çështjeve studentore në ambientet e universitetit.</p> <p>Studentët që pranohen në programin e studimit informohen paraprakisht gjatë fazës së aplikimeve <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/</a> , por edhe gjatë javës së parë mbi kërkesat dhe kriteret universitare, kohëzgjatjen maksimale të periudhës së studimeve; ndërsa informimet mbi detyrimet akademike dhe periudhën e provimeve gjenden në faqen e internetit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/">https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/</a> .</p> <p>Informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen web të institucionit. Në dispozicion të</p>

	<p>studentëve është numri i telefonit WhatsApp: +355 69 408 9203, si dhe adresa e email <a href="mailto:international@unyt.edu.al">international@unyt.edu.al</a></p> <p>GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, iu konfirmua që studentët ishin njohur që ditën e parë me mjediset, rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me lëndët, regjistrimet, orarin dhe provimet, regjistrimi për provime dhe notat përkatëse <a href="https://unyt.edu.al/index.php/my-unyt/">https://unyt.edu.al/index.php/my-unyt/</a> pasi ka një hapësirë personale në eeb me të gjithë të dhënat e studentit mbi studimet në këtë universitet (<a href="http://cgnomon.unyt.edu.al/?">http://cgnomon.unyt.edu.al/?</a>).</p> <p>Karakteristikë për këtë universitet është se për çdo student caktohet një këshillues akademik, i cili është jesë e stafit të departamentit dhe lehtëson procesin e rezultateve të studentit. Këshilluesi ka kontakte të rregullta edhe me zyrën e çështjeve studentore duke informuar dhe përditësuar me informacione si dhe duke udhëzuar me këshillat e nevojshme.</p> <p>Në faqen e internetit të universitetit publikohet orari mësimor dhe i provimeve (kalendari), dhe materiale mësimore mbi lëndë të ndryshme (përmes sistemit Egnomon).</p> <p>Informacion i detajuar për çdo lëndë ju jepet edhe nga pedagogu i lëndës nëpërmjet komunikimit me e-mail ose dhe formatin hard-copy.</p> <p>GVJ nga konstatimi i sistemit të menaxhimit konfirmoi se informacioni ju përcillej studentëve dhe kishin akses dhe mbështetje për çdo kërkesë edhe ekstra kurrikulare.</p> <p><b>5.23 UNYT List of Advisers.pdf</b>  <b>3.8 UNYT Communication to students on their assessment in exams.pdf</b>  <b>4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin.png</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Mundësitë e punësimit janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët e këtij universiteti nëpërmjet faqes së internetit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/job-gate/">https://unyt.edu.al/index.php/job-gate/</a>, të cilat menaxhohen nga Zyra e Karrierës <a href="https://unyt.edu.al/index.php/career-service-office/">https://unyt.edu.al/index.php/career-service-office/</a>. Universitetit për garantimin e praktikave profesionale dhe të punësimit të studentëve mbështetet edhe në rrjetin e organizatave bashkëpunuese. Kjo zyrë organizon workshope, trajnime, seminare, këshillime të drejtpërdrejta me studentët si edhe Panairin e Karrierës, <a href="https://unyt.edu.al/index.php/career-service-office/#careerfair">https://unyt.edu.al/index.php/career-service-office/#careerfair</a> me anë të të cilit ndihmon studentët të arrijnë qëllimet e tyre të karrierës si në aspektin afatshkurtër edhe në atë afatgjatë. Aktivitetet e zyrës janë zhvilluar edhe online gjatë periudhës së pandemisë duke garantuar mbështetje të vazhdueshme studentore. Misioni i kësaj zyre është të asistojë dhe të pregatisë studentët për jetën edhe pas diplomimi jo vetëm orientimi drejt punësimit.</p>



	<p>Nga takimi që GVJ pati me studentët rezultoi se ata kishin informacione mbi studimet e tregut të punës, si dhe ishin orientuar drejt mundësive të punësimit dhe tregut të punës, por më shumë ishin të interesuar për vijueshmërinë e studimeve. ata kishin vendosur bashkëpunime me organizata të ndryshme ku realizonin praktikat dhe kishte dhe nga ana të cilët kishin pasur mundësinë të ndryshonin organizatë dhe ishin lehtësuar në këtë proces nga stafi i universitetit.</p> <p><b>5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrieres, Alb.pdf</b>  <b>5.14.6 UNYT Career Fair 2022.jpg</b>  <b>5.16 UNYT Career Office Action plan.pdf</b>  <b>5.14 UNYT_CareerFair_Agenda.png</b>  <b>5.1 UNYT Lista e MoU.pdf</b>  <b>5.13 UNYT Career Centre workshop.pdf</b>  <b>5.12.2 UNYT Workshop on Employment_PËC.pdf</b>  <b>5.14 UNYT e-Career Fair 2020.pdf</b>  <b>5.14.5 UNYT Career Fair Main Poster Social Media.png</b>  <b>5.20 UNYT Bachelor Students Empliment Data.pdf</b>  <b>2.9 UNYT Open session preparing students for the UNYT Career Fair.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor afishohet në sistemin e menaxhimit të informacionit të përdorur nga universiteti dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.</p> <p>Gjatë takimeve dhe seancave orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. Zyra e çështjeve studentore <a href="https://unyt.edu.al/index.php/student-affairs-office/">https://unyt.edu.al/index.php/student-affairs-office/</a>, këshilluesit akademik <a href="https://unyt.edu.al/index.php/academic-support-center/">https://unyt.edu.al/index.php/academic-support-center/</a>, por dhe stafi akademik dhe të gjithë zyrat e tjera administrative janë në shërbim të studentëve për të gjithë shërbimet që ofrojnë dhe për mundësitë e ndihmës gjatë studimeve.</p> <p>Gjatë takimeve në institucion GVJ konfirmon se informacioni që ju vihej në dispozicion ishte i plotë e shterues.</p> <p><b>4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin.png</b>  <b>4.20.1 UNYT E-Gnomon student access.png</b>  <b>2.2.1 UNYT Evidence e komunikimit me ane te emailit te dergimit te sillabeve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Çdo pedagog ofron komunikimin si nëpërmjet sistemit E-Gnomon, e-mail-it me studentët, por edhe gjatë taimeve fizike në lidhje me programin e studimit. Ky informacion është lehtësisht i arritshëm dhe studentët mund ta aksesojnë sistemin e informacionit ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë. Studentët mund të futem me email-in e tyre në sistem nëpërmjet portalit të studentëve, ku gjejnë të gjithë informacionin. Studentët mund të aksesojnë sistemin dhe nga jashtë institucionit nëpërmjet kodit të përdoruesit dhe fjalëkalimit duke pasur kështu një</p>

	<p>Ilogari të personalizuar për ndërveprimin institucional. Sistemi menaxhon dhe arkivon të dhënat.</p> <p>GVJ gjatë takimit me studentët konstaton se ata kishin informacione paraprake mbi programin e studimit edhe për vitin në vijim, kishin informacione mbi syllabuset e çdo lënde, të cilat ju viheshin në dispozicion nga pedagogët e lëndëve dhe nga këshilluesit akademik.</p> <p><b>4.20 UNYT Platforma Gnomon.png</b>  <b>4.20.1 UNYT E-Gnomon student access.png</b>  <b>4.20.2 UNYT Gnomon access.png</b>  <b>4.20.3 UNYT Gnomon student search.png</b>  <b>4.20.4 UNYT Individual Student Search.png</b>  <b>4.20.5 UNYT Lidhja e studenteve me plan-programin.png</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konfirmon se universiteti kishte krijuar gjithë strukturën e nevojshme dhe kishte mundur që studentët të ishin të informuar mbi strukturën akademike dhe objektivat e programit, kishin informacion të plotë e të hollësishëm për strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, studimeve mbi proceset akredituese dhe tregun dhe mundësitë e punësimit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti disponon, administron, përpunon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit "Psikologji". Programi akreditohet për herë të parë pas riorganizimit dhe nuk ka asnjë të diplomuar, por disponohen të dhëna specifike për çdo student, edhe për çregjistrimet dhe transferimet. Referuar plotësisht të detyrimeve ligjore, por edhe matjes së performancës institucioni çdo vit akademik, edhe me ndihmën e sistemit të menaxhimit të të dhënave, administron të dhënat e studentëve për të gjithë programet e studimit, edhe për këtë program.</p> <p>GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kuotat e miratuara. Ndërkohë mesatarja në hyrje për vitin akademik për të tre vitet e fundit akademike është:</p>

	<table border="1"> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>8.46</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>7.48</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>9.20</td> </tr> </table>	Viti akademik	Nota mesatare në hyrje	2020-2021	8.46	2021-2022	7.48	2022-2023	9.20					
Viti akademik	Nota mesatare në hyrje													
2020-2021	8.46													
2021-2022	7.48													
2022-2023	9.20													
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika për numrin e të regjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve, transferimeve dhe çrregjistrimeve etj. Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimeve psikologji për 3 vitet akademike është 30 studentë, nga të cilët vetëm 1 student është transferuar. Këto të dhëna janë në administruara si në formatin hard, me gjithë procedurat përkatëse në Sekretarinë mësimore, por edhe në formatin soft në programin e menaxhimit të të dhënave. Të dhënat gëzojnë mbrojtje dhe ruhen në Sekretarinë e Universiteti në mënyrë konfidenciale. Një pjesë e të dhënave janë pjesë edhe e analizës së universitetit dhe nuk ka të dhëna për publikim të raportit vjetor.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për vitet e fundit akademike ishte:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>9</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>11</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>9</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Përdorimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave mundëson që të gjenerohen jo vetëm të dhëna rutinë si listat emërore të studentëve, vlerësimet përkatëse, por edhe statistika të ndryshme të cilat shërbejnë si për raportimet e ndryshme që universiteti realizon për institucionet publike si MAS; ASCAL, QSHA, por dhe për analizat e ecurisë së programeve dhe departamenteve përkatëse.</p>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	2020-2021	9	-	2021-2022	11	-	2022-2023	9	1	<p>Gjatë vizitës në institucion u vërejtën se sekretaria mësimore administronte, rregjistrin themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejtë asnjë pasaktësi.</p> <p><b>2.37 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB.pdf</b>  <b>1.14 UNYT Dokumenti i Performancës 2021-05.10.2021.pdf</b>  <b>5.4 UNYT Rregullore e Sekretarise Mesimore, Alb.pdf</b></p>
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar												
2020-2021	9	-												
2021-2022	11	-												
2022-2023	9	1												
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet online dhe është i aksesueshëm</p>													

<p>sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik që disponon mund të printojë listën e notave për studentët e vet. Sekretaria lehtësisht mund të llogaritë mesataren për çdo semestër dhe mesataren e përgjithshme, e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi performancën e studentëve. Edhe mënyra e hedhjes së të dhënave në sistem, ruajtjes, e transmetimit dhe e përpunimit të tyre është e kufizuar edhe sipas llojit të informacionit edhe sipas përgjegjësisë dhe pozicionit të nënpunësit. kështu Departamenti hedh në sistem të dhënat e vlerësimit të studentëve por përpunimin e tyre e bën sekretaria.</p> <p>Sektori i IT është përgjegjës për mirëfunksionimin e sistemit dhe ruajtjes e të dhënave sipas rregulloreve përkatëse të punës që ky universitet ka miratuar. Manuali i Sigurisë së Sistemit Gnomon është gjithashtu një instrument cili i garanton universitetit sigurinë e të dhënave të studentëve dhe lehtësinë në verifikimin e përdorimit të të dhënave nga personat e autorizuar.</p> <p><b>5.4 UNYT Rregullore e Sekretarise Mesimore, Alb.pdf</b>  <b>4.17 UNYT IT Support Services, Alb.pdf</b>  <b>4.14 UNYT Manual of Information Security, Alb.pdf</b>  <b>4.15 UNYT Softëare Installation Policy, Alb.pdf</b>  <b>4.20 UNYT Platforma Gnomon.png</b>  <b>4.21.1 UNYT Hedhja e mungesave.png</b>  <b>4.21.2 UNYT Hedhja e notave.png</b>  <b>4.21 UNYT Access i profesoreve.png</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njërive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të rregjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.</p> <p>Universiteti edhe për të rritur performancëv e vet, por edhe për të garantuar cilësi të lartë shërbimi për programin e studimit Psikologji” duhet të realizojë kontrole periodike të përvitshme (të paktën 3 të tilla për periudhën e akreditimit) pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), në bazë të të culave ne të mund të njiheshim mbi vlerësimin dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët e degës Psikologji, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Në raportin e GVB vihemi në dijeni për një raport auditimi të brendshëm, i cili nuk rezulton në dokumentacionet shoqëruese të dosjes së aplikimit.</p> <p><b>5.4 UNYT Rregullore e Sekretarise Mesimore, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë duhet të bëjë një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje gjë e cila nuk na është mndësuar, por të dhënat statistikore mbi mesataren janë lehtësisht të</p>

<p>dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>aksesueshme nga sistemi i menaxhimit. Në këtë raport analitik duhet të reflektohen edhe masat e marra për përmirësimin e treguesve kryesisht ato të cilat lidhen me cilësinë e studimeve dhe formimit akademik , por edhe të punësimit të studentëve. Gjenden lehtësisht objektivat e Departamentit për vitet përkatëse, por nuk gjenden raporte analitike vjetore, specifikisht mbi profilin psikolog.</p> <p><i>GVJ nuk aksesoi analizat vjetore mbi profilin psikolog.</i></p> <p><b>1.12 UNYT Annual Departmental Objectives 2020-2021.pdf</b>  <b>1.12.1 UNYT Annual Departmental Objectives 2021-2022.pdf</b>  <b>14 UNYT Dokumenti i Performancës 2021-05.10.2021.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave dhe sekretaria mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit “Psikolog”. Të dhënat ruhen edhe në rregjistra të posaçëm nga pranimit dhe rregjistrimi, transferimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre, por nuk ka të dhëna të punësimit të tyre, pasi ende nuk kemi të diplomuar për këtë program. Do të sygjeronim që në aktet rregullative të Departamentit të shihej mundësia e normimit të analizave vjetore për secilin program studimi, për të vlerësuar përbushjen e objektivave të formimit të studentëve, posaçërisht në programin Psikologji, për të konfirmuar përputhshmërinë e kualifikimit akademik me kërkesat e tregut të punësimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Standardi V.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Statuti i UNYT, në nenin 70, “Pjesëmarrja e studentëve në qeverisjen akademike”, garantohet pjesëmarrje nëpërmjet Këshillit të Studentëve në formulimin e politikave të institucionit; edhe në nenin 71 rregullohet funksionimi i Këshillit të Studentëve. Gjithashtu në Rregulloren e Fakultetit në nenin 27, Komisioni Disiplinor i Ankesave , pika b, informohemi se komisioni për të shmangur konfliktet e mundshme ka në përbërjen e tij edhe një student të emëruar nga Përgjegjësi i Unionit Studentor. Në Rregulloren e Universitetit, në nenin 75, normohet pjesëmarrja e studentëve në Qeverisjen Akademike, organ i cili merret me zhvillimin e veprimtrive dhe aktiviteteve studentore dhe koordionon përfundimin e studentëve në organet drejtuese të Universitetit. Edhe Rregullorja e Departamentit të Psikologjisë, në nenin 41 rregullon</p>

	<p>përshirjen e studentëve në komision disiplinor. Edhe në Rregulloren për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë, në nenin 4 përcaktohet përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, ku në pikën 2 përcaktohet se një aëtar komisioni është përfaqësues i studentëve.</p> <p>UNYT ka të sanksionuar përfshirjen eudentëve në hallkat vendimarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët pjesëmarrës në takimi kishin informacione mbi përfaqësimin e tyre dhe aktivitetet e unionit studentor <a href="https://unyt.edu.al/index.php/student-union/">https://unyt.edu.al/index.php/student-union/</a>.</p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute</a></p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit.pdf</b>  <b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit te Psikologjise.pdf</b>  <b>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershem te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ konfirmon se përfshirja e studentëve mundësohet nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë për vlerësimin e procesit akademik, i cili është një proces që kryhet në mënyrë të pavarur nga secili pedagog në fund të semestrit; por nuk ka evidenca mbi përfshirjen e studentëve në vendim marrje apo konkretisht mbi procesin akademik, ndaj këshillohet krijimi i praktikave sa më përfshirëse të studentëve në të gjithë proceset akademike e mësimdhënëse dhe përfshirja e tyre në sa më shumë grupe pune ku ata mund të prezantojnë qëndrimet e tyre; si dhe të ndërjegjsohen mbi efektin në vendimarrje.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit "Psikologji" është riorganizuar duke mbajtur parasysh kërkesat ligjore dhe rekomandimet e ekspertëve dhe institucioneve akademike si dhe të ASCAL dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Ka praktikë shumë të mirë dhe të standardituar dhe periodike mbi vlerësimin e pedagogëve , por jo një praktike konkrete për përmirësimin e programit të studimit "Psikologji".</p> <p><i>Nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to Mund të këshillohet përfshirja e studentëve në mbledhje të përbashkëta në</i></p>




	<p>departament duke garantuar kështu edhe kointributin e tyre në të gjithë proceset akademike e mësimdhënëse si dhe duke ofruar një model që reflekton sugjerimet e kointributin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre.</p> <p><b>6.9 UNYT STUDENT EVALUATION FORM.pdf</b>  <b>6.9.1 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Spring 2021.pdf</b>  <b>6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Fall 2022.pdf</b>  <b>6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022.pdf</b>  <b>6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Secilit profesor).JPG</b>  <b>6.9.4 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Rektor, Dekan, Shef Departamenti).JPG</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja mbi studimet universitare dhe provimet, si dhe udhëzimi mbi provimet mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton përcaktimit e procedurës që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast. Ky universitet nëpërmjet zyrës së marrdhënieve me studentët, nëpërmjet këshilltarit të studentëve dhe me anë të ankimimit iu mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve e rishikimit të rezultatit.</p> <p>GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë.</p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/">https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/</a></p> <p><b>Shënime gjatë vizitës në institucion</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se institucioni kishte ndërtuar kuadrin rregullator për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, por nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës nuk u evidentuan raste kur ata të ishin të përfshirë në procesin e hartimit, miratimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit "Psikologji". Këshillohet krijimi i praktikave sa më përfshirëse të studentëve në të gjithë proceset akademike e mësimdhënëse dhe përfshirja e tyre në sa më shumë grupe pune ku ata mund të prezantojnë qëndrimet e tyre; si dhe të ndërgjegjësohen mbi efektin në vendimmarrje si një mundësi për përmirësimin e programit të studimit dhe rritjes së cilësisë së burimeve të shërbimeve në dispozicion.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në strukturën e tij UNYT ka krijuar njësi dhe zyra të dedikuara, të cilat ju sigurojnë studentëve mbështetjen e nevojshme akademike. Institucioni ka vënë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat nevojshme të studentëve për të pasur sukses në universitet (Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p>Gjithashtu studentët mund të informohen edhe nëpërmjet përdorimit të faqes Web të institucionit dhe të kontaktojnë atë nëpërmjet adresës elektronike <a href="https://unyt.edu.al/index.php/contact/">https://unyt.edu.al/index.php/contact/</a></p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.7 Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit.pdf</b>  <b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.pdf</b>  <b>4.3 UNYT Departamenti i Shërbimeve Mbeshtetese- Politika dhe procedura.pdf</b>  <b>Shënime gjatë vizitës në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, por ka në dispozicion edhe një sistem menaxhimi (E-Gnomon) i cili është në dispozicion të çdo studenti. Informacioni lehtësisht i aksesueshëm është dhe në ëeb e institucionit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/my-unyt/">https://unyt.edu.al/index.php/my-unyt/</a>. Gjatë periudhës së rekrutimit dhe regjistrimit të studentëve në këtë universitet, si dhe në javën e parë të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit. Pranë këtij institucioni funksionon Zyra e çështjeve të studentëve e cila është njësi kryesore përgjegjëse për informimin e studentëve; gjithashtu edhe këshilluesi akademik ofron këshillimin e nevojshëm për të gjithë shqetësimet e studentëve lidhur me procesin mësimor. Studentët pjesë e takimit i konfirmuar GVJ se gjatë gjithë periudhës së marrëdhënieve me universitetin studentët ndihen të asistuar në të gjithë aspektet studentore, dhe jo vetëm në ato akademike. UNYT ofronte një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e tyre</p> <p>Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi asistimin e tyre përgjatë procesit mësimor me të gjithë çështjet që lidhen me programin e studimit në "Psikolog".</p>



	<p><b>4.20.1 UNYT E-Gnomon student access.png</b>  <b>3.1 UNYT Instructor's Handbook_ALB.pdf</b>  <b>4.22 UNYT Rregullore Dekani i Studenteve Alb.pdf</b>  <b>5.10 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës gjatë semestrit akademik, Alb.pdf</b>  <b>3.4 UNYT Rules and Regulations Academic Support Center and Counselling Center, Alb.pdf</b>  <b>Shënime gjatë vizitës në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe veçanërisht takimi me përfaqësues të Zyrës së çështjeve studentore dhe Sektorit të Këshillimit të Karrierës, GVJ u informua që zyrat ofronin shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen.</p> <p>Zyra e Karrierës e UNYT mundëson zhvillimin personal të studentëve nëpërmjet leksioneve dhe trajnimeve rreth karrierës, nxjerrjen në pah të mundësive të zhvillimit të karrierës, ndërthurjen e aftësive dhe vlerave dhe lehtësimin e kalimit nga akademia në tregun e punës me anë të bashkëpunimeve e partneriteteve me organizata të ndryshme.</p> <p>Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për aktivizimin e potencialeve të tyre, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve dhe organizatave të ndryshme.</p> <p><b>3.4 UNYT Rules and Regulations Academic Support Center and Counselling Center, Alb.pdf</b>  <b>5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrieres, Alb.pdf</b>  <b>5.2.2 UNYT Lista e Marreveshjeve.pdf</b>  <b>5.16 UNYT Career Office Action plan.pdf</b>  <b>Shënime gjatë vizitës në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni në UNYT ka si detyrë dhe gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo disponon një bazë të dhënash mbi studentët e diplomuar në këtë institucion, e cila përfshihet edhe në Dokumentin e Performancës së Universitetit.</p> <p>GVJ konfirmon që zyra ka mundësi dhe ka realizuar vrojtme me studentët e diplomuar të këtij universiteti, jo të programit i cili akreditohet, ka në dispozicion staf të mjaftueshëm i cili mund të realizojë një gjurmim të tillë edhe për programin Psikologji.</p> <p>Mungojnë evidencat specifike nga Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit për studentët e programit psikologji, të cilët nuk janë diplomuar ende, nuk ka të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre.</p> <p><b>5.29 UNYT Career Debates and students' exposure toëards the labor market.pdf</b>  <b>5.19 UNYT Punesimi i studenteve.pdf</b>  <b>5.20 UNYT Bachelor Students Emplyment Data.pdf</b>  <b>Shënime gjatë vizitës në institucion</b></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi se procedurat për asistimin e studentëve janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit dhe Zyra e Karrierës është duke vijuar punën, për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Ajo është letësisht e arritshme nga studentët dhe ka ndërveprime të vijueshme me ta. Për studentët e programit "Psikologji", të cilët ende nuk janë diplomuar, rezultojnë të ketë të disponueshme mekanizma për asistimin në tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UNYT ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit.</p> <p>Nën objektivin – Ekselencë në mësimdhënie dhe përqaftimi i epokës së re të edukimit ky universitet ka miratuar dhe Strategjinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit (2020-2025), me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie në të tre nivelet: në nivelin institucional, në nivel programi dhe në atë individual.</p> <p>Statuti parashikon ngritjen e komisioneve të përhershme siç është (neni 32) Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit; Njësia e Sigurimit të Cilësisë (neni 33). Këtë vit (2023) ky institucion ka miratuar edhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë i cili prezanton parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë për miratimin dhe vlerësimin e kurseve, programeve, njësive dhe partneriteteve të UNYT.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UNYT ka ngritur struktura dhe miratuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë në RSH" dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>6.18 UNYT Strategjia e mesimdhënies, mesimnxënies dhe metodave te vleresimit, Alb.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual per Sigurimin e Brendshem te Cilesise.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b>  <b>6.9 UNYT STUDENT EVALUATION FORM.pdf</b>  <b>6.9.4 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Rektor, Dekan, Shef Departamenti).JPG</b>  <b>6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Secilit profesor).JPG</b>  <i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në zbatim të statutit të universitetit, institucioni e ka ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili kryesohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit zgjidhet nga Senati Akademik dhe është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike. Funkcionet e këtij komisioni rregullohen me anë të manualit të Garantimit të Cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të</p>

	<p>Lartë. KoGaSC përbëhet nga 5 (pesë) deri në 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e komisionit kanë një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje (Neni 32, Statuti UNYT).</p> <p>Gjithashtu në UNYT është ngritur dhe funksionon edhe Njësia e Sigurimit të cilësisë (Neni 33, Statuti UNYT), e cila periodikisht vlerëson rezultatet e vperimareve mësimore dhe kërkimore-shkencore. Kjo njësi në fund të çdo semestri (ose para sezonit të provimeve) organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.</p> <p>Përveç vlerësimit të njësive dhe nëpërmjet pyetësorve, një instrument tjetër që përdoret nga kjo njësi është dhe procesi i vlerësimit nga kolegët si një mjet efikas për të ndikuar dhe rritur aftësitë mësimdhënëse.</p> <p>GVJ konstaton se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur dhe është duke ushtruar funksionet e tij.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.pdf</b>  <b>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershem te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.2 UNYT Quality Assurance Annual Report, Eng. 2020-2021.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b>  <b>6.4 UNYT UNYT Peer Evaluation Template.pdf</b>  <b>6.6.1 UNYT Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.9.4 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Rektor, Dekan, Shef Departamenti).JPG</b>  <b>6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Secilit profesor).JPG</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Referuar arteve rregullative të institucionit rezulton se studentët janë pjesë e komisioneve të përhershme institucionale (Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve, Neni 32, Statuti UNYT), por edhe në aktivitetet e fakultetit, ata përfaqësohen. GVJ kontaktoi me Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultet dhe me studentin pjesë të tij. Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të performancës garantohej nëpërmjet pyetësorëve të studentëve për matjen e performancës por edhe me anë të peticionit akademik, sigurisht dhe me anë të kontakteve të drejtpërdrejta që ata kanë me këshilltarët e tyre akademik apo me zyrën e çështjeve studentore apo dhe me vetë pedagogët e lëndëve.</p> <p>Nga takimi që realizoi GVJ me studentët konfirmoi se vlerësimi i dijeve dhe ankimeve mbi të realizohej sipas përcaktimeve të rregullores së fakultetit, dhe formati i peticionit ishte lehtësisht i aksesueshëm.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b></p>




	<p><b>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilësisë, Alb.pdf</b></p> <p><b>6.13 UNYT ACADEMIC PETITION LEGAL FRAMEËORK AND PROCEDURE.pdf</b></p> <p><b>6.14 UNYT Academic Petition Form.pdf</b></p> <p><b>6.13 UNYT ACADEMIC PETITION LEGAL FRAMEËORK AND PROCEDURE.pdf</b></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Komisioni përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe NJSC referuar metodologjisë së vlerësimit, instrumenteve matëse dhe instrumenteve të vlerësimit, monitoron progresin dhe suksesin e cilësisë së mësimdhënies. IAL i është nënshtruar vlerësimit institucional dhe me Vendim të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Nr. 61, datë 18.12.2020 ka marrë vlerësim pozitiv maksimal me 6 vite. Gjenden të publikuara dhe raportet e vlerësimeve të jashtme të cilave ju është nënshtruar universiteti <a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fc17a337-53fb">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fc17a337-53fb</a>.</p> <p>Në faqen web <a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute</a> informohemi mbi bazën ligjore dhe rregullat për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë por jo për raportet periodike të institucionit.</p> <p>Të dhënat grumbullohen, përpunohen nga NJSBC dhe bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit si dhe pjese e raportit vjetor të monitorimit të programit “Psikologji”, si dhe ky raport ju dërgohet me email të interesuarve pjesë e departamentit.</p> <p>Këshillohet që të dhënat e pyetësorit për performancën të publikohen me qëllim arritjen e një audience më të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet.</p> <p><b>6.6 UNYT Formular i Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b></p> <p><b>6.6.1 UNYT Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b></p> <p><b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b></p> <p><b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve UNYT vlerëson edhe performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon dhe përmirëson ato duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentët dhe alumni, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxëniet. Programi “Psikologji” që i është nënshtruar procesit të akreditimit është riorganizuar si rezultat i rekomandimeve të komisionit të mëparshëm mbi këtë program. Zhvillimi i personelit akademik është në fokus të drejtuesve të institucionit dhe në çdo viti akademik bëhet vlerësimi i performacës së tyre nga drejtuesit pas vlerësimit që secili prej tyre i bën vetes në përmbushje të objektivave të përcaktuara në fillim të vitit. Nuk u gjentën dokumente që të vërtetonin mënyrën e akordimit të fondit për mbështetje shkencore (konferenca, botime) për stafin</p>




	<p>akademik. Këshillohet që këto praktika të jenë transparente, të përcaktohen zërat e rendësishëm dhe mënyrat e përfitimit të financimit nga stafi akademik i programit “Psikologji”.</p> <p><b>6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022.pdf</b>  <b>6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form.pdf</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni ka të përcaktuar qartë politikë në nivel institucional dhe në nivel të fakulteteve për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ka hartuar e udhëzohet në punën e tij nga udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të monitorimit. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë e programit “Psikologji” dhe për të promovuar cilësinë e mësimdhënies.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UNYT në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, ka organizuar dhe ka miratuar mënyrën e funksionimit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Statuti NYUT, Neni 33), i cili ndër përgjegjësitë e tjera ka dhe menaxhimin e procesit të matjes së performancës, nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve institucionalë, takimeve, këshillimeve dhe mjeteve të tjera për të rritur performancën. Prezenca e strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë nuk gjendet vetëm në arktet rregullative por dhe në organigramën e institucionit. Në aktet rregullative të institucionit është dhe Plani Strategjik i UNYT, i cili shërben si një udhëzues i brendshëm për përmbushjen e misionit dhe rritjen e cilësisë në këtë institucion Gjithashtu parashikimet ligjore mandatojnë Departamentin si njësi përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit të ndërtojë struktura dhe në këtë institucion funksionin NJBC. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse, dhe GVJ ka evidentuar një sër raportesh dhe vlerësimesh si për stafin akademik dhe për për cilësinë e programit BA në “Psikologji”.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.1.1 UNYT Organigrama.pdf</b>  <b>1.6 UNYT Strategic Plan 2020-2025, Alb.pdf</b>  <b>6.2 UNYT Quality Assurance Annual Report, Eng. 2020-2021.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b></p>

	<b>6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Secilit profesor).JPG</b>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Egzistenca e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, referuar edhe strategjisë së UNYT, mundëson që prej më shumë se 20 vjetësh ky institucion të ndjekë dhe zbatojë praktikat më të mira ndërkombëtare, kjo falë dhe bashkëpunimeve të shumta, me qëllim garantimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve që institucioni ofron.</p> <p>Sistemi është i përbërë nga dy njësitë e tij kryesore që janë Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit (Statuti UNYT, Neni 32) dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (neni 33). Puna e këtyre njësive mbështetet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë (2023), i cili udhëzon mbi procedurat dhe hapat që duhet të ndiqen për sigurimin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së UNYT.</p> <p>Në mënyrë që procesi i sigurimit të cilësisë të jetë kompleks dhe tërësor në të është e parashikuar përfshirja e të gjithë aktorëve të cilët janë përfitues dhe ofrues të shërbimeve të këtij institucioni. Kështu është standartizuar procedura pëe përfshirjen e studentëve, jo vetëm si përfaqësues në komision por dhe si vlerësues të pedagogëve të tyre dhe të mënyrës se si janë të organizuara programet e studimit nga pedagogët, cilësinë e metodologjisë së mësimdhënies, literaturën dhe të gjithë elementët të cilët ndikojnë në rritjen e cilësisë. Në fund të çdo lënde studentët duhet të plotësojnë pyetësonin, i cili administrohet nga koordinatori i NJSB-së, i cili pas përpunimit të të dhënave, i bën me dije fakulteteve përkatëse rezultatet.</p> <p>Vlerësimet mbi stafin akademik realizohen në 4 dimensione</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i Studentëve</li> <li>2. Vlerësimi nga Kolegët</li> <li>3. Vlerësimi i Performancës Individuale</li> <li>4. Vlerësimi i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit.</li> </ol> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve janë pjesë e Raportit Vjetor të Departamentit.</p> <p>Me Vendimin Nr.Prot.9.9.2023, datë 02.02.2023, Rektori i UNYT, ka vendosur të emëroj edhe ekstert të jashtëm për të kontribuar në proceset e akreditimit.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>1.12.1 UNYT Annual Departmental Objectives 2021-2022.pdf</b>  <b>1.14 UNYT Dokumenti i Performancës 2021-05.10.2021.pdf</b>  <b>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershem te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual per Sigurimin e Brendshem te Cilesise.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b>  <b>6.4 UNYT UNYT Peer Evaluation Template.pdf</b></p>




	<p><b>6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtem.pdf</b>  <b>6.6 UNYT Formular i Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.16 UNYT Plan Vjetor NjsBC.pdf</b>  <b>6.9 UNYT STUDENT EVALUATION FORM.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka përdorur të gjithë instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Kështu për të përfituar sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë, institucioni me Vendimin Nr. 61, datë 18.12.2022 për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, është akredituar për një periudhë 6 vjeçare. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të institucionit është 17.12.2026 (aksesuar në faqen web të institucionit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions</a>).</p> <p>Edhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë së institucionit por edhe në punën e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në atë të NJSC periodikisht aplikohen dhe përditësohen instrumentet për të siguruar tregues të vlefshëm për matjesn e cilësisë. Gjithashtu institucioni harton dhe vlerësime analitike të cilat promovojnë praktikatat e mira të cilat ndikojnë në cilësinë e institucionit, si dhe ofrojnë një mundësi shumë të mirë për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit BA “Psikologji”</p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fc17a337-53fb">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fc17a337-53fb</a></p> <p><b>6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.16 UNYT Plan Vjetor NjsBC.pdf</b>  <b>1.14 UNYT Dokumenti i Performancës 2021-05.10.2021.pdf</b>  <b>6.18 UNYT Strategjia e mesimdhënies, mesimnxënies dhe metodave te vlerësimit, Alb.pdf</b>  <b>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual per Sigurimin e Brendshëm te Cilesise.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b>  <b>6.6 UNYT Formular i Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor një sër treguesish të cilët janë efektiv për pasqyrimin e situatës dhe për evidentimin e problematikave në procesin e mësimdhënies dhe në atë të kërkimit. Raportet e deritanishme të vëna në dispozicion nga institucioni nuk nuk janë të fokusuara në pasqyrimin e arritjeve dhe të dobësive të programit specifik “Psikologji”, edhe pse ky aspekt do të ishte shumë i rëndësishëm pasi programi në fjalën është riorganizuar nga ai i mëparshmi; pra institucioni e ka tashmë praktikën mbi bazën e të cilës të mund të bëj promovime nxitëse për këtë program studimi. Nga analiza e raportit të vlerësimit të brendshëm institucional evidentohet se rezultatet e pyetësorëve me studentët janë një instrument që përdoren në funksion të përmirësimit të mësimdhënies. Rezultatet e</p>






	këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe iu paraqiten të gjithë strukturave përkatëse duke nisur nga departamentet deri në Senatën Akademik.			
	<b>6.6.1 UNYT Raportit Vjetor të Monitorimit.pdf</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se UNYT ka hartuar dhe ka zbatuar politika e procedura të posaçme për sigurimin e cilësisë në kuadër të strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Për të garantuar dhe rritur maksimalisht sigurimin e cilësisë së programit "Psikologji" këshillohet që në të ardhmen raportet të jenë analitike dhe të orientuara specifikisht drejt cilësisë së këtij programi me analiza mbi arritjet dhe pikat e dobta për të bërë kështu promovime sa më të duhura për programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë (Neni 25, Departamenti) Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore, në varësi të llojit të institucion. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare (pika 10, Neni 25, Ligji 80/2015).</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe organizimit të Departamentit nuk u njohëm me ndonjë njësi (grup pune) të posaçëm për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, apo rishikimin e programit të studimit "Psikologji". Rezultojnë përcaktimi i objektivave të Departamentit, por jo ato specifike për programin "Psikologji", në mënyrë që të shërbejnë si një bazë mbi të cilën të shqyrtohen realizimi e arritjet, por pse jo dhe pikat e dobta. nga shqyrtimi i dokumentacionit u evidentua vetëm një raport monitorimi për vitin 2020-2021.</p> <p><i>GVJ këshillon që vlerësimet dhe mbikëqyrja e programit "Psikologji" të jetë periodike si një mekanizëm i domosdoshëm për akreditimin e tij.</i></p>

	<p><i>Departamenti në këtë analizë duhet të demonstrojë mënyrën se si i ka përmbushur detyrimet ligjore për programin e studimi</i></p> <p><b>1.12 UNYT Annual Departmental Objectives 2020-2021.pdf</b>  <b>1.12.1 UNYT Annual Departmental Objectives 2021-2022.pdf</b>  <b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raporti i monitorimit (vetëm për 1 vit), i cili është pjesë e dosjes së akreditimit, analizon të dy programet BA dhe MSC në “Psikologji” dhe në të nuk ka sesione apo rubrika ku të evidentohen rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimi i praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. Në raportim e GVB vihemi në dijeni se raporti hartohet mbi bazën e të dhënave të siguruara nga pyetësorët e studentëve, por në të nuk ka të reflektuara të dhënat dhe përfundimet e këtyre pyetësorëve dhe si janë adresuar problematikat që ata kanë ngritur, dhe si kjo përmirëson cilësinë.</p> <p>Po në raportin e vet GVB evidenton bashkëpunimin engushtë të NJSBC-së me drejtuesin e departamentit; por as në raportin e NJSBC-së nuk ka vlerësime specifike për programin “Psikologji”, të cilat të kenë gjetur pasqyrim në raportin e monitorimit të departamentit.</p> <p>GVJ mbështetur në sa më sipër konstaton se një raport është i pamjaftueshëm për të siguruar një vlerësim sa më holistik dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundësohet analiza periodike konform kritereve të akreditimit..</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për të realizuar vlerësimin e programit “Psikologji” institucioni ka aplikuar disa metoda të drejtpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, të hartimit dhe korrigjimit të provime, vetëvlerësimin e pedagogëve, rishikimi i programit në tërësi nga procesi i akreditimit, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese.</p> <p>IAL gjithashtu aplikon instrumente të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e programit dhe konkretisht pyetësorin për vlerësimin e lëndës dhe pyetësorin me studentët. Kështu vlerësimi i pedagogëve bëhet në fund të çdo semestri. Departamenti përgatit raport mbështetur në rezultatet e anketimit.</p> <p><b>6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form.pdf</b>  <b>6.9.5 UNYT E-mail per Vlerësimin e Pedagogëve nga Studentet (Secilit profesor).JPG</b>  <b>6.9.4 UNYT E-mail per Vlerësimin e Pedagogëve nga Studentet (Rektor, Dekan, Shef Departamenti).JPG</b>  <b>6.9.1 UNYT Vlerësimet e Pedagogëve nga studentet - Spring 2021.pdf</b>  <b>6.9.2 UNYT Vlerësimet e Pedagogëve nga studentet - Fall 2022.pdf</b>  <b>6.9.2 UNYT Vlerësimet e Pedagogëve te rinj - Fall 2022.pdf</b></p>

	<p><b>1.1 UNYT STUDENT EVALUATION FORM.pdf</b>  <b>6.6 UNYT Formular i Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.4.1 UNYT Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.4 UNYT UNYT Peer Evaluation Template.pdf</b>  <b>6.2 UNYT Quality Assurance Annual Report, Eng. 2020-2021.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b>  <b>1.12 NYT Annual Departmental Objectives 2020-2021.pdf</b>  <b>1.12.1 UNYT Annual Departmental Objectives 2021-2022.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>IAL gjithashtu institucionin nuk përdor vetëm instrumenta të drejtpërdrejtë për të vlerësuar cilësinë e programit si pyetësorin për vlerësimin e lëndës dhe pyetësorin me studentët, por dhe instrumente të ndryshme indirekte, që përfshijnë studentët, të diplomuarit e programit, alumnit, stafin akademik dhe atë administrativ dhe bashkëpunëtorët e ndryshëm.</p> <p>Për këtë program studimi ende nuk ka të dhëna nga studentë të diplomuar pasi programi është i riorganizuar dhe ende nuk ka studentë të diplomuar.</p> <p>Në vitin 2022 studentët e këtij programi kanë qënë pjesë e sondazhit kombëtar të studentëve të organizuar nga ASCAL të dhënat e të cilit janë një metodë tërthore për të matur kënaqësinë studentore në lidhje me cilësinë në arsimin e lartë.</p> <p>Gjithashtu kontaktet e vijueshme me studentët, mendimet dhe qëndrimet që ata i prezantojnë këshilluesve të tyre, apo informacionet të cilat vijnë nga organizatat partnere që institucioni bashkëpunon, apo ku studentët realizojnë praktikën mësimore, vizitat në librari, etj, janë një tregues tjetër shumë i mirë i cili ndihmon institucionin në vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> <p><b>5.1 UNYT Lista e MoU.pdf</b>  <b>5.2.2 UNYT Lista e Marreveshjeve.pdf</b>  <b>5.14 UNYT_CareerFair_Agenda.png</b>  <b>5.14 UNYT e-Career Fair 2020.pdf</b>  <b>5.15 UNYT Alumni.pdf</b>  <b>5.18 UNYT Feedback nga kompanite per punesimin e studenteve.pdf</b>  <b>5.14.3 UNYT Keynote Speaker Sinan Dilek.png</b>  <b>6.15 UNYT Sondazhi Kombetar i Studenteve Ascal.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë ka organizuar njësitë dhe ka sanksionuar monitorimin dhe vlerësimin përmes njësitë të posaçme, por ende nuk kemi raporte analitike në mënyrë periodike për programin e studimit "Psikologji", për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Kjo merre dhe më tërër rëndësi tashmë kur ky është një profesion i rregulluar. GVJ nxit strukturat e ngritura në nivel fakulteti dhe departamentin të vlerësojë programin në mënyrë holistike duke integruar të dhënat nga burimet e drejtpërdrejta dhe ato sekondare për të vlerësuar dijet akademike dhe kompetencat e situara nga ky program, si një mundësi shumë e mirë e garantimit të cilësisë së tij.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në UNYT është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Funksionet e këtij komisioni rregullohen me anë të manualit të Garantimit të Cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) deri në 7 (shtatë) anëtarë, me mandat 2 (dy) vjeçar. (Neni 32, Statuti UNYT).</p> <p>Gjithashtu për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit funksionon dhe Njësia e Sigurimit të cilësisë (Neni 33, Statuti UNYT), e cila vlerëson rezultatet e veprimarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Institucioni zbaton parashikimet e manualit të sigurimit të cilësisë për të garantuar përmirësimet e duhura.</p> <p>Përveç aktorëve të brendshëm institucioni ka parashikuar dhe ka garantuar në procedurat e tij dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm brendshme të cilësisë për të ndikuar në përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur dhe është duke ushtruar funksionet e tij.</p> <p><b>1.2 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë.pdf</b>  <b>6.3 UNYT Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë, Alb.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore për Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Alb.pdf</b>  <b>6.2 UNYT Quality Assurance Annual Report, Eng. 2020-2021.pdf</b>  <b>6.2.1 UNYT Quality Assurance Annual Report 2021-2022.pdf</b>  <b>6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon që strukturat që shërbejnë për sigurimin e brendshëm të cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Kështu Senati ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm të sigurimit të</p>

<p>së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>standardeve të cilësisë të instucionit dhe programeve të studimit. Gjithashtu UNYT ka miratuar rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, mandati i antarëve në komision, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë.</p> <p>GVJ konstaton që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><b>6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.pdf</b>  <b>6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershem te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise, Alb.pdf</b>  <b>6.16 UNYT Plan Vjetor NjSBC.pdf</b>  <b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesor, si njësi përgjegjëse në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit është e parashikuar të përfshihet në disa nivele. Në rregulloren e Departamentit, neni 5, pika h. është funksion i përgjegjësit të departamentit të kryejë një procedurë të vlerësimit periodik të performancës së personelit akademik në bazë të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe motivimit të vazhdueshëm. Vetë personeli akademik përveç vlerësimit nga drejtuesit vlerësohet nga kolegët dhe nga studentët për çdo lëndë në përfundim të saj si dhe vetëvlerësohet me antë të vlerësimit të performancës. Në rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, garantohej përfshirja e Dekanit (neni 4, pika d) si përgjegjës për koordinimin e programeve akademike duke vlerësuar dhe rishikuar kurrikulën e fakultetit, në përputhje me nevojat e tregut dhe standardet e akreditimit të programeve. Gjithashtu garantohej përfshirja e anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit pasi ata janë pjesë e takimeve dhe mbledhjeve, ose edhe pjesë e marrjes së mendimeve me anë të plotësimi të pyetësorve. Edhe zyrtarët përkatës referuar funksioneve dhe përgjegjësi që kanë janë suportive dhe janë të përfshira në mënyrë integrale në garantimin e cilësisë. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga tre anëtarë, një është ekspert i jashtëm dhe dy janë staf administrativ (neni 4).</p> <p><b>1.9 UNYT Rregullore e Departamentit te Psikologjise.pdf</b>  <b>1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit.pdf</b>  <b>6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form.pdf</b>  <b>6.9 UNYT STUDENT EVALUATION FORM.pdf</b>  <b>6.3 UNYT UNYT Peer Evaluation Template.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të</p>	<p>GVJ konstatoi se edhe referuar <i>Neni 4</i> të Rregullores së njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë kjo është një strukturë me autonomi operative dhe aksesin e nevojshëm në të dhënat e institucionit për qëllime</p>

<p>respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>të realizimit të funksioneve të saj. Anëtarët e saj zgjidhen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik. Referuar eksperiencës së deritanishme, nga aplikimi drejt dhe saktë i procedurave të vlerësimit të brendshëm, por dhe nga integriteti i aktorëve të cilët janë përfshirë në këtë process në asnjë rast nuk është vërejtur akt diskriminues apo pabarazie ndaj studentëve apo personelit.</p> <p>Institucioni ka hartuar politika dhe ka garantuar respektimin e procedurave të cilat janë tërësisht etikem konfidenciale dhe respektuese ndaj aktorëve të përfshirë në process.</p> <p><b>1.1 UNYT Statuti i Miratuar.pdf</b>  <b>6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise, Alb.pdf</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit, dhe shënimeve të mbajtura nga GVJ gjatë vizitës në institucion konstatohet se, UNYT ka bërë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet përfshirjes në njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe asistimit në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. Për shkak të karakteristikave të programit “Psikologji” do këshillojmë që eksperti të ishte ekspert i fushës së psikologjisë si një garant për dhënien e mendimeve mbi cilësinë e programit dhe përmirësimin e cilësisë së tij.</p> <p><b>6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtem.pdf</b>  <i>Takime gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni i arsimit të lartë ka përfshirë njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit “Psikologji” dhe ka informuar palët e interesuara në lidhje me rezultatet e tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>


<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për</p>	<p>Në kuadër të garantimit të transparencës UNYT në web e institucionit ka të publikuar misionin, vizionin <a href="https://unyt.edu.al/index.php/mission-vision-and-values/">https://unyt.edu.al/index.php/mission-vision-and-values/</a>, politikat, strategjinë dhe kuadrin ligjor (<a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute</a>) Vendimet nr. 61; Nr.25 dhe Nr.10 të ASCAL (<a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions</a>) si dhe veprimtaritë në kuadër të</p>




<p>studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/</a> për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Në faqen e ëeb të internetit të institucionit(<a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/</a>) gjenden të publikuara informacione të cilat lidhen me organizimin dhe me anëtarët e komisionit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe mënyra se si mund të kontaktohet ky komision, por nuk u mundësua gjetja e dokumenteve publike mbi politikën e cilësisë dhe ajo që është më e rëndësishmja mbi raportet e vlerësimit të brendshëm (përmendim që raportet e sigurimit të jashtëm të cilësisë, ai institucional dhe si dhe raportet për ato programe studimi që janë vlerësuar nga ASCAL gjenden lehtësisht).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni nën hapësirën e dokumenteve zyrtarë ka të publikuara statutin, Rregulloret dhe Rregullat e vetë institucionit, si dhe Kodin e Etikës dhe si dhe Raportin Vjetor të Sigurisë së Cilësisë për vitin akademik 2021-2022 <a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute</a>.</p> <p>GVJ sygjoron të publikohen vlerësimet e dedikuara programit të studimit “Psikologji” dhe këto të jenë periodike si dhe të publikohet legjislacioni për të dhënat personale, sigurisht të dhënat e rapoortit të publikuar të respektojnë lirinë dhe etikën akademike, kështu aktorët e interesuar kanë mundësi të njihen me këto raporte.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Departamenti ka Objektiva në formatin e planit të masave por pa informacione nëse ato janë pjesë e ndonjë raporti vlerësimi, apo nëse janë qëllime të cilat kanë dalë nga përmirësimi i dobësive të evidentuara në vlerësime të mëparshme. Në dokumentacionin që shoqëron raportin nuk mundësuam ndonjë një plan masash për adresimin e pikave të dobta të vlerësimeve të programit Bachelor të studimit “Psikologji”. Në raportin e vet institucioni na informon mbi projekt buxhetet e hartuara nja njësitë me atë të të cilave mbulpohen nevojat akademike dhe operationale të departamenteve (cit.Shtojca 4-31) por një dokument i tillë nuk u gjend në Dosjen e Vetëvlerësimit të institucionit.</p> <p>Në raportein e monitorimit (fq.9) gjendet dhe plan veprimi mbi 5 objektiva dhe personat përgjegjës për plotësimin e tyre, por nuk janë produkt i ndonjë analize me mangësitë apo dobësitë e programit të studimit “Psikologji”; janë më tepër plan veprimi i departamentit.</p> <p><b>1.12 UNYT Annual Departmental Objectives 2020-2021.pdf</b>  <b>1.12.1 UNYT Annual Departmental Objectives 2021-2022.pdf</b>  <b>6.6.1 UNYT Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që</p>

<p>në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Departamenti ka një raport monitorimi për periudhën 2020-2021 por është e pamjaftueshme që mbi këtë dokument të mund të gjykohet mbi vlerësimin e cilësisë për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit dhe mbi efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit.</p> <p><b>6.6.1 UNYT Raportit Vjetor te Monitorimit.pdf</b>  <b>6.6.2 UNYT E-mail dergimi Raporti Vjetor i Monitorimit.pdf</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Informimi i stafit për proceset e vlerësimit;</li> <li>- Trajtime të ndryshme për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë</li> <li>- Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit;</li> <li>- Përfshirja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e performancës;</li> <li>- Përfshirja e studentëve në sondazhin kombëtar të studentëve</li> </ul> <p><b>6.17 UNYT Quality Assurance Training.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ rekomandon që krahas raporteve të NJSBC, vetë Departamenti duhet të hartojë raporte vjetore të posaçme për të gjithë aktivitetin e tij, ku të evidentojë instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar. Gjithashtu të gjithë nismat e Departamentit, politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit "Psikologji", duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i New York-ut në Tiranë**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Përfshirja e studentit në projekte të ndryshme duke stimuluar jetën sociale në UNYT dhe duke e shndërruar në faktor motimi për to.
3. Abonimi në bibliotekat online dhe platformat elektronike në funksion të procesit të mësimdhënies.
4. Klima pozitive në komunikimin midis stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi.
5. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik dhe studentët, përmes Erasmus +

**Pika të dobëta:**

1. Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji vlen të përditësohet, riorganizohet dhe plotësohet me lëndë të tjera të nevojshme për të përmbushur njohuritë e nevojshme për studentët. Si dhe disa lëndë në këtë kurrikul gjykohe të mos jenë të nevojshme duke i zënë hapësirën lëndëve të tjera të domosdoshme. **(Standardi 2.3 dhe Standardi 2.4).**
2. Mungesën e kapaciteteve dhe burimeve të duhura njerëzore për të realizuar programin e studimit për disa lëndë mësimore nga titullarë të kategorisë “Doktor” si dhe nga personel akademik i profilizuar dhe profesionalizuar për lëndët përkatëse. **(Standardi 2.2, kriteri 2,3)**
3. Mungesë e koordinatorit të programit të studimit Bachelor në psikologji si e përcakton edhe nevoja në ligjin e Arsimit të Lartë. **(Standardi 2.2, kriteri 3)**
4. Vlerësimi në përmbyllje të studimeve të studentit në këtë cikël studimit është i konfliktual dhe jo objektiv. **(Standardi 3.5)**
5. Mbingarkesa e pedagogëve në mësimdhënie pasi kjo ndikon ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies. **(Standardi 4.1, kriteri 2)**

## Rekomandime:

1. Përmirësimi i kurrikulës së programit të studimit është një pikë e mundshme për t'u përmirësuar pasi ligji i arsimit të lartë lejon hapësirën e përmirësimit të tij në çdo fillim viti akademik në masën 20%. Edhe pse kjo procedurë kërkon një proces të konsiderueshëm kohor për të realizuar këtë përmirësim, e rëndësishme është mundësia e realizimit dhe fillimi në kohën e duhur.
2. Përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për hartimin e syllabuseve mësimore, titullarë të lëndëve dhe moduleve duhet t'i përkasin kategorisë "Doktor" si dhe siç e kërkon ligji dhe shtimi i stafit të profesionalizuar dhe profilizuar në mësimdhënien përkatëse mund të jetë e realizueshme përmes vijjesisë së rekrutimeve pavarësisht vështirësië së referuar. Tregu vazhdimisht është në lëvizje dhe me produkte mobile dhe kjo mundëson edhe gjetjen e vazhdueshme të stafit të profilizuar si dhe gjetjes së mënyrave motivuese për mbajtjen e tij.
3. Pasja e një koordinatori është e mundur për t'u siguruar nga personeli akademik që lejon në këtë program studimi. Mjafton që ky koordinator të mos ketë mbingarkesë të tepërt për të siguruar efektivitetin e tij në këtë proces koordinimi.
4. Rishikimi i rregullores së këtij programi studimi dhe përputhshmëria e tij me Ligjin e arsimit të lartë përta i përket çështjes së vlerësimit të studentit në përmbyllje të studimeve të ciklit të parë Bachelor përmes një provimi ose teze diplome përpara një komisioni vlerësimi.
5. Mbingarkesa e pedagogëve automatikisht do të lehtësohet përmes shtimit të stafit akademik në departament.

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle "Bachelor" in "Psychology", of the Institution of Higher Education, University of New York, Tirana, Albania**

**Strengths and affirmations:**

1. The institution in terms of the involvement of academic staff and students in national and international projects undertook good practices.
2. Involvement of the student in various project, stimulating the social life at UNYT and turning it into a motivation factor for them.
3. Subscription to online libraries and electronic platforms in the function of the teaching process.
4. Positive climate in communication between academic staff and students of this study program.
5. Encouraging exchanges in higher education for academic staff and students, through Erasmus +

**Weaknesses:**

1. The curriculum of the first cycle study program Bachelor in Psychology is worth updating, reorganizing and supplementing with other necessary subjects to fulfill the necessary knowledge for students. As well as some subjects in this curriculum are judged not to be necessary, occupying the space of other necessary subjects. **(Standard 2.3 dhe Standard 2.4).**
2. The lack of adequate capacities and human resources to carry out the study program for some teaching subjects by holders of the "Doctor" category as well as by profiled and professionalized academic personnel for the relevant subjects. **(Standard 2.2, criterion 2,3)**
3. Absence of the coordinator of the Bachelor's study program in psychology, as determined by the need in the law of Higher Education. **(Standard 2.2, criterion 3)**
4. The final evaluation of the student's studies in this study cycle is conflicting and not objective. **(Standard 3.5)**
5. Overload of lecturers in teaching as this significantly affects the quality of teaching. **(Standardi 4.1, criterion 2)**

**Recommendation:**

1. The improvement of the curriculum of the study program is a possible point to improve since the law of higher education allows the scope of its improvement at the beginning of each academic year to the extent of 20%. Although this procedure requires a considerable process of time to realize this improvement, it is important to be able to do it and start at the right time.
2. The selection of the academic staff engaged in this study program for the design of teaching syllabi, subjects and modules must belong to the "Doctor" category as required by law and the addition of professionalized and profiled staff in the relevant teaching can be feasible through the succession of recruitments despite the difficulty referred to. The market is constantly on the move with mobile products and this enables the constant finding of profiled staff as well as finding motivating ways to keep them.
3. Having a coordinator is possible to be provided by the academic staff that lectures in this study program. It is enough that this coordinator is not overloaded to ensure its effectiveness in this coordination process.
4. Revision of the regulation of this study program and its compliance with the Higher Education Law regarding the issue of student evaluation at the conclusion of the first cycle Bachelor's studies through an exam or diploma thesis before an evaluation committee.
5. The overload of lecturers will automatically be eased through the addition of academic staff in the department.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X